

**HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ATË TË UNIONIT
EVROPIAN NË FUSHËN E INVESTIMIT TË KAPITALIT TË HUAJ**

**Dorëzuar: Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale**

**Në përmbushje të detyrimeve të programit të doktoraturës në Shkenca Juridike, profili
Biznesor, për marrjen e gradës shkencore**

“Doktor”

Numri i fjalëve: 54.683

PhC. Candidate

Vjollca Salihu

Udhëheqës shkencor

Prof.Asoc.Dr. Andon Kume

Tiranë,

Janar 2021

DEKLARATA E AUTORËSISË

Ky material nuk është prezantuar më parë në këtë institucion dhe as në ndonjë institucion tjetër të ngjashëm me të. Mënyra e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave të këtij punimi është krejtësisht origjinale dhe objektive.

Emri dhe Mbiemri

Firma

Data

ABSTRAKT

Investimet e huaja luajnë një rol crucial në rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të një vendi!

E arsyet e investimeve të huaja janë të shumta! Duke e shtruar çështjen nga dy konceptualizimet alternative të ndikimit të IHD-ve, vlen të theksohet se: IHD-të udhëheqin të kuptuarit dhe kontributin e tyre në shtimin neto të inputeve që investitorët e huaj mund të sjellin në një mjedis të brendshëm, dhe njëherit theksojnë potencialisht ndikimin që investitorët e huaj mund të kenë në ekonominë e brendshme që janë stërbushur me papërsosmëritë e tregut! Ndoshta versioni më i përhapur i konceptimit të dobishëm fillon me një përshkrim të stilizuar se si IHD-të mund të ndihmojnë vendin nikoqir. Efektet në vendet pritëse janë të rëndësishme si për nga shumëllojshmëria e tyre ashtu dhe për nga rëndësia ekonomike, politike dhe sociale që ato gjenerojnë. IHD-të sjellin kapitalin e nevojshëm, rrisin produktivitetin e ekonomisë nëpërmjet transferimit të njohurive dhe teknologjisë, ndikojnë në hapjen e tregjeve të reja për tregti, rrisin konkurrueshmërinë e ekonomisë, ndikojnë në reduktimin e deficitit të llogarive korente, rrisin punësimin dhe mbi të gjitha ndikojnë në mirëqenien e popullsisë. Shikuar nga prizimi i rëndësisë së ndikimit të investimit të kapitalit të huaj për vendin pritës dhe atë të origjinës qëllimi kryesor i këtij studimi doktorate është përcaktuar të analizojë përputhshmërinë e legjislacionit të investimeve të huaja të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian, për të theksuar më tej rëndësinë e gjyqësorit dhe zbatimin e ligjit si faktorë influencues të thithjes së investimeve të huaja në rastin e Kosovës. Nëpërmjet analizës përshkruese, krahasuese dhe analitike, elaborohen në mes tjerash korniza ligjore mbi investimet e Huaja Direkte në Kosovë në krahasim me BE-në, agjencionet kryesore dhe marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare për mëbshtetjen e IHD-ve, trendet e IHD-ve ndër vite në Kosovë në komparacion me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shtetet e reja anëtare të Bashkimit Evropian si dhe agregatët kryesor makroekonomik, përfshirë këtu: rritjen e normës së popullsisë dhe rritjen e produktit të brendshëm bruto, për kokë banori. Punimi vjen me disa konkluzione dhe rekomandime, më konkretisht duhet të potencohet që përthithja e investimeve të huaja kërkon politika dhe strategji të përcaktuara mirë, përmirësime të vazhdueshme në kuadrin ligjor dhe institucional, stabilitet politik dhe rritje ekonomike të qëndrueshme, gjithashtu përmirësim dhe modernizim të infrastrukturës, si dhe përmirësime në klimën për mjedisin e biznesit dhe investimeve.

Fjalët kyçe: Legjislacioni i IHD-ve Kosovë - BE, përcaktuesit e IHD-ve, avantazhet e IHD,

zhvillimi institucional, integrimi global ekonomik.

ABSTRACT

Foreign investment plays a crucial role in sustainable economic growth and development. The reasons for Foreign Investment are numerous, however the issue raised by the two alternative conceptualizations of the impact of FDI is worth noting that FDI leads their understanding and contribution to the net increase of inputs that foreign investors can bring to a domestic environment and the second potentially highlights the impact that foreign investors may have on domestic economies that are self-inflicted with no market perfection. Perhaps the most prevalent version of useful conception begins with a stylized description of how FDI can help the host country. The effects on host countries are significant both in terms of their diversity and the economic, political and social importance they generate. FDI brings the necessary capital, increases the productivity of the economy through the transfer of knowledge and technology, affects the opening of new markets for trade, increases the competitiveness of the economy, reduces the current account deficit, increases employment and above all affects in the welfare of the population. Seen from the perspective of the importance of the impact of foreign capital investment on the host and country of origin, the main purpose of this doctoral study is to analyze the compatibility of Kosovo's foreign investment legislation with that of the European Union to further emphasize the importance of the judiciary and law enforcement as influential factors in attracting foreign investment in the case of Kosovo. Through descriptive, comparative and analytical analysis are elaborated, among others, the legal framework on Foreign Direct Investment in Kosovo in comparison with the EU, Major Agencies and various international agreements for FDI support, FDI trends over the years in Kosovo in comparison with the countries of the Western Balkans and the new member states of the European Union as well as the main macroeconomic aggregates including growth, population growth and growth of Gross Domestic Product per capita. The paper comes with some conclusions and recommendations, concretely the absorption of these investments requires well-defined policies and strategies, continuous improvements in the legal and institutional framework, political stability and sustainable economic growth, improvement and modernization of infrastructure, as well as improvements in the climate for the environment. business and investment.

Keywords: Kosovo - EU FDI legislation, FDI determinants, FDI advantages, institutional development, global economic integration

FALËNDERIME

Gjatë gjithë këtij rrugëtimi, aspak të lehtë por goxha të rëndësishëm, shpreh falënderime të sinqerta për Prof. dr. Adrian Civicin, Presidentin e Universitetit Evropian si dhe për mentorin tim Dr. Hemion Braho, për literaturën, ndihmën dhe këshillat e tij të pakursyera gjatë gjithë kohës deri në finalizim të temës.

Falënderime të përzemërta i shpreh familjes sime dhe bashkëshortit, të cilët në çdo moment më kanë mbështetur dhe përkrahur gjatë studimeve të mia të deritashme.

Pa mbështetjen e tyre, ky punim nuk do të ishte i mundur!

Fëmijëve: Orsiola & Orjon

LISTA E SHKURTIMEVE

IHD - Investimet e huaja direkte

LV - Letra me vlerë

BERZH - Banka Evropiane për Rimëkëmbje dhe Zhvillim

RSFJ - Republika Federative Socialiste e Jugosllavisë

BE - Bashkimi Evropian

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

UNCTAD - United Nations Conference on Trade and Development, (Konferenca e parë e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin)

MIGA - Multilateral Investment Guarantee Agency (Agjencioni Multilateral për Sigurinë e Investimeve)

OPIC - Overseas Private Investment Corporation, (Korporata e Jashtme për Investime Private)

KIESA - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë,

AIDA - Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

OECD – The Organisation for Economic Co-operation and Development (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim)

CEFTA - Central European Free Trade Agreement, (Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore)

BQK - Banka Qëndrore e Kosovës

TIMS – Trade Information Management System, (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Tregtisë)

DTI- Direct Trade Input (Shtytja e Drejtpërdrejtë e Tregtisë)

KFOR – North Atlantic Treaty Organization, (Organizate Traktatit të Atlantikut Verior)

UNHCR - United Nations High Commissioner for Refugees, (Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë)

OJQ – Organizata Joqeveritare

AKM - Agjencia Kosovare e Mirëbesimit

GATT- General Agreement Tariffs and Trade Process (Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë)

UNKTAD – United Nations Conference on Trade and Development (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin)

PBB - Produkti i Brendshëm Bruto

PËRMBAJTJA

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	2
ABSTRAKT	3
ABSTRACT	4
LISTA E SHKURTIMEVE.....	6
LISTA E TABELAVE	11
LISTA E FIGURAVE	11
LISTA E GRAFIKËVE.....	11
KAPITULLI I.....	12
Hyrje	12
Qëllimi i punimit.....	15
Objektivat e ngritura në studim	16
Pyetjet kërkimore dhe hipotezat.....	16
Metodologjia e hulumtimit	17
Çështjet terminologjike.....	18
Struktura e punimit doktoral.....	20
Kufizimet e punimit.....	21
KAPITULLI II.....	23
SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	23
Definicione mbi investimet dhe investimet e Huaja Direkte	23
Definicione mbi Investimet e Huaja Direkte	23
2.3. Teoritë e Investimeve të Huaja Direkte	24
Teoria e Ciklit të Prodhimit sipas Vernon	24
Teoria e normave të këmbimit në tregjet e papërsosura të kapitalit.....	25
2.3.3. Teoria eklektike sipas Dunning.....	25
Rëndësia ekonomike e Investimeve të Huaja Direkte	27
Kanalet nëpërmjet të cilave IHD-të ndikojnë në ekonominë pritëse.....	28
Figura 1. Kanalet e ndikimit të Investimeve të Huaja Direkte	29
2.6. Arsyet e investitorëve të huaj për të investuar në një vend potencial pritës.....	30
2.7 Kosova në rrugën drejt tërheqjes së Investimeve të Huaja Direkte	31
KAPITULLI III	35

	ANALIZË KOMPARATIVE E LEGJISLACIONIT MBI INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË DHE BASHKIMIN EVROPIAN.....	35
	Interpretimi i ligjit të IHD-ve në rastin e Kosovës.....	35
220)	Korniza Ligjore – Ligji për Investimet e Huaja Direkte në Kosovë (Ligji nr.04 / L - 36	
Kosovës	Korniza Ligjore – Ligji Nr. 05/L - 079 për Investimet Strategjike në Republikën e 39	
Kosovë	Ligje të tjera të rëndësishme të ndërlydhura me rregullativat ligjore të IHD-ve në 43	
	Ligji Nr. 06/L -016 për shoqëritë tregtare	44
	Ligji Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike	44
	Ligji për Arbitrazhin	45
	Ligji për Standardizim (Rregullorja Nr. 2004/12)	46
	Ligji Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/l-139 për procedurën përmbartimore.....	47
	Ligji nr. 05/l-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore	48
	3.5. Legjislacioni i Bashkimit Evropian mbi Investimet e Huaja Direkte	50
	Hyrje	50
	Rrregullativa ligjore e IHD-ve në BE.....	51
	KAPITULLI IV	58
	BAZA LEGJISLATIVE QË SIGURON DHE GARANTON INVESTIMIN E KAPITALIT TË HUAJ	58
	Hyrje	58
	Rëndësia e ligjit në funksionalizimin e zhvillimit ekonomik	60
	Stabiliteti legjislativ	61
	Sigurimi dhe Mbrojtja e të drejtave të investitorëve.....	61
	Fondet investive(investuese).....	63
	Roli i Agjencioneve për Nxitjen e Investimeve tëHuaja.....	64
	Agjencioni multilateral për sigurinë e investimeve(MIGA)	65
	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)	66
	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)	66
	Transparenca.....	67
	Korrupsioni	67
	Investimet në Kosovë - përfitimet.....	70
	Sistemi Doganor.....	71
	Sistemi Tatimor i Kosovës dhe korniza ligjore.....	72
	4.10. Regjistrimi i Biznesit	75
	Baza legjislative që siguron dhe garanton investimin e kapitalit të huaj në shtetet anëtare dhe në vetë Bashkimin Evropian.....	76
	Baza legjislative që siguron dhe garanton investimin e kapitalit të huaj në disa shtete të rajonit – Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi.....	77

KAPITULLI V	78
VEPRIMET KONKRETE JURIDIKE (KONTRATA, MARRËVESHJA), BILATRALE APO MULTILATERALE, ME TË CILËN REALIZOHET PROCESI I INVESTIMIT TË KAPITALIT TË HUAJ	78
Marrëveshjet dypalëshe përinvestimet.....	78
Kontratat	79
Të drejtat dhe liritë kontraktuale.....	80
Qendra ndërkombëtare për zgjedhje të kontesteve investuese (ICSID).....	81
5.4.1. Objektivat e qendrës ICSID.....	81
Konventa mbi Rregullativat dhe Ligjet (ICSID).....	81
Konsistrimi i komisioneve, tribunaleve dhe komiteteve (ICSID).....	82
Konventa ICSID (Rregullat e Arbitrazhit) - Praktika gjyqësore e ICSID ndërmjet palëve Kosovë – Gjermani	83
KAPITULLI VI.....	87
INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË NË KRAHASIM ME VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE SHTETET MË TË REJA ANËTARE TË BE-SË.....	88
Rëndësia e Investimeve të Huaja Direkte në Kosovë dhe rajon	88
Investimet e Huaja Direkte në Kosovë në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor	89
Indikatorët kryesor makroekonomik të Kosovës dhe vendeve të Ballkanit Perëndimore	91
Aspekte analitike mbi IHD-të në Kosovë	100
Projektimet indikative të investimeve të nevojshme.....	103
Investimet ekonomike në Kosovë	104
Investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe kompanitë multinacionale.....	105
Kompanitë multinacionale në praktikë	106
Arsyet e investimit të kapitalit të huaj në Kosovë.....	107
Qasja sistemore e investimeve në Kosovë	109
Pozita qendrore gjeografike e Kosovës.....	110
Aspektet Legjislative si parakusht për tërheqjen e IHD-ve në Kosovë.....	110
Investimet e huaja ndërkombëtare në Kosovë	114
6.7.1 Pengesat për investime në Kosovë.....	115
Politikat monetare dhe roli i tyre në tërheqjen e IHD-ve	116
KAPITULLI VII.....	125
KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	125
7.1 Konkluzione.....	125
7.2. Rekomandime	132
Bibliografia.....	138
SHTOJCA.....	146

BIBLIOGRAFIA PLOTËSUESE	160
-------------------------------	-----

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Ligjet mbi tatimet dhe udhëzimet relevante në fuqi në rastin e Kosovës.....	74
Tabela 2. Normat tatimore në Kosovë	75
Tabela 3. ACP Axos Capital GmbH k. Republikës së Kosovës (Çështja ICSID Nr. ARB / 15/22) PROCEDIMI	86

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Kanalet e ndikimit të Investimeve të Huaja Direkte	29
---	----

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. IHD-të në Kosovë në komparacion me vendet e Ballkanit Perëndimor.....	90
Grafiku 2. IHD-të në Kosovë në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë.....	92
Grafiku 3. IHD-të në Shqipëri në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë	93
Grafiku 4 IHD-të në Republikën e Maqedonisë së Veriut në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë	94
Grafiku 5. IHD-të në Serbi në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë.....	95
Grafiku 6. IHD-të në Bosnjë dhe Hercegovinë në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë	96
Grafiku 7. IHD-të në Mal të Zi në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë	97

Grafiku 8. BPP-ja në Kosovë në krahasim me disa shtete të reja anëtare të BE-së..... 98

Grafiku 9. IHD-të në Kosovë në krahasim me disa shtete të reja anëtare të BE-së..... 98

Grafiku 10. Remitencat në Kosovë në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor . 99

KAPITULLI I:

Hyrje

Investimet e Huaja janë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendeve të zhvilluara dhe posaçërisht vendeve në zhvillim e sipër siç janë vendet e Ballkanit Perëndimor. Investimet e Huaja Direkte kanë zgjuar interes për politikbërësit duke tentuar gjithnjë tërheqjen e tyre me qëllim të rritjes ekonomike. Literatura bashkëkohore mbi rëndësinë e Investimeve të Huaja daton shumë më herët mirëpo për shkak të zhvillimit të hovshëm të shkencës, teknikës dhe teknologjisë së informimit, roli i IHD-ve viteve të fundit bëhet gjithnjë e më i shprehur.

Hulumtime të shumta dhe analiza teorike e empirike iu kushtohet faktorëve influencues të IHD-ve përfshirë këtu analizën e kornizës ligjore mbi investimet e huaja, funksionimin e gjyqësorit, zbatimin e ligjit, politikën fiskale në përgjithësi përfshirë atë të tatimeve dhe taksave në veçanti, politikën monetare, zhvillimin e sektorit financiar përfshirë këtu tregjet financiare, pra janë faktorë influencues mbi tërheqjen e IHD-ve. Vlen të theksohet se shtetet në zhvillim e sipër me tranzicion të tejzgjatur dhe me ngecje në zbatim të reformave hasin në vështirësi në tërheqjen e IHD-ve, megjithëse shpresë e vetme për vendet e Ballkanit Perëndimor, në veçanti rasti i Kosovës, për tërheqjen e IHD-ve mbetet fuqia punëtore që paraqet një shtyllë kryesore për hir të moshës së re dhe niveli i pagave mesatare në sektorin privat që janë shumë të ulëta krahasuar me ato të BE-së.

Ekzistojnë të paktën dy faktorë të cilët bëjnë që Investimet e Huaja Direkte të duken disi më pak të favorshme për vendet e Ballkanit Perëndimor krahasuar me vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian (Bhus & Rahman, 2018). Së pari, shumica e shteteve të reja anëtare të Bashkimit Evropian nga kërkesa për anëtarësim në hyrje në Bashkimin Evropian kanë kaluar nga 8 vite (Sllovenia dhe Republika Çeke) deri në 12 vite (Bullgaria dhe Rumania). Në fakt, 8 ose më shumë vite pas fitimit të statusit të aplikantit, vendet e Ballkanit Perëndimor ende

përballen me perspektivë të pasigurtë në lidhje me pranimin në Bashkimin Evropian. Së dyti, duke pasur parasysh një fillim të vonshëm në tranzicion, vendet e Ballkanit Perëndimor janë prapa në reforma të rëndësishme, por edhe në aftësi dhe infrastrukturë fizike krahasimisht me shtetet e reja anëtare të BE-së.

Sidoqoftë, rritja e mungesës së punës dhe plakja e parashikuar e fuqisë punëtore (popullsisë) mund të ndikojnë në vendimet e investitorëve për investime të reja karakteristike për vendet e BE-së. Sidoqoftë, kjo potencialisht mund të tregojë rënie të interesit për investim të ri. Ndërsa më shumë vende luftojnë për prodhimin e efikasitetit të IHD-ve dhe rritjen e pagave në këto vende. Suksesi i vazhdueshëm në modelin e rritjes të drejtuar nga IHD-të në këtë grup do të varet nga aftësia e tyre për të ngritur lart shkallët e teknologjisë. Sidoqoftë, këtu mund të theksojmë se edhe përkundër faktit të një tranzicioni të tejzgjatur dhe një periudhë e gjatë e pritjes për t'iu bashkuar familjes së madhe evropiane, shtetet e Ballkanit Perëndimor veçanërisht Kosova, ka fuqi punëtore të moshës së re, që është në favor kundrejt vendeve të tjera.

Sipas autorëve, Bhus & Rahman, (2018) regjioni i Ballkanit Perëndimor tregon një profil të ngjashëm përse i përket mbizotërimit të sektorit të shërbimeve. Vetëm Serbia numëron më shumë se gjysmën e aksioneve totale të IHD-ve në rajon, me pjesën tjetër të ndarë midis pesë vendeve të tjera, që afërsisht korrespondojnë me madhësinë e tyre relative. Në sektorët e shërbimeve, mbizotërimi i sektorëve financiar dhe tregtar është i ngjashëm me atë të shteteve të reja anëtare të BE-së. Për prodhimin, i cili numëron rreth të pestën e aksioneve: produktet kimike, ushqimore, pijet dhe produktet automobilistike janë më të rëndësishmet.

Faktorë të tjerë përfshijnë, për shembull, sistemin e taksave, stabilitetin politik, efikasitetin e administratës publike, infrastrukturën publike, fleksibilitetin e tregut të punës, cilësinë e furnizuesit lokal dhe kushtet për kërkime dhe zhvillim. Prandaj, Farrell (2008), IHD-të i konsideron si një "paketë të kapitalit, teknologjisë, menaxhimit dhe sipërmarrjes, e cila lejon një firmë të operojë dhe të sigurojë mallra dhe shërbime në një treg të huaj".

Investimet e Huaja Direkte përcaktohen në mënyrë konvencionale si një formë e bashkëpunimit ndërkombëtar, ndërmjet tyre të tilla që përfshijnë aksione të konsiderueshme të kapitalit dhe fuqi të efektshme të vendimit të menaxhimit ose në kontroll të pronësisë së

ndërmarrjeve të huaja. IHD-të gjithashtu konsiderohet të përfshijnë forma të tjera bashkëpunimi të një ekuiteti më të gjerë, heterogjen, që përfshijnë furnizimin e pasurive të prekshme dhe jo-materiale nga një ndërmarrje e huaj për një firmë vendase. Këto shoqata më të gjera bashkëpunimi, përfshijnë shumicën e llojeve të aranzhimeve të investimeve, të tilla si licencimi, dhënia me qira dhe ekskluziviteti; aranzhimet për fillimin dhe ndarjen e prodhimit ndërkombëtar; ndërmarrje të përbashkëta me pjesëmarrje të kufizuar të kapitalit të huaj (Mello, 1999).

Sigurimi i stimujve financiarë është një mjet i zakonshëm që përdoret nga vendet, për të rritur interesin e investitorëve të huaj. Vendet kanë tendencë të përdorin dy lloje të stimujve financiarë për të tërhequr Investimet e Huaja Direkte: instrumente me bazë fitimi (pushime tatimore, përjashtime nga taksat e kufizuara me kohë për investime të reja, dhe duke ulur normat e taksave), dhe instrumentet e bazuara në kosto (zbritja e investimeve nga të ardhurat e tatueshme, kredia tatimore dhe një zhvlerësim më i shpejtë i aktiveve fikse për qëllime tatimore).

Një bazë e re e të dhënave, për stimujt e Investimeve të Huaja Direkte tregon që ofrimi i stimujve financiarë për investitorët e huaj është mjaft i zakonshëm për vendet që përpiqen të tërheqin investitorë që kërkojnë efikasitet (Andersen, Kett, & Uexkull, 2017). Ekzistojnë studime të shumta empirike që konfirmojnë efektet pozitive të IHD – ve në vendet e Ballkanit Perëndimor, mirëpo edhe autorë të cilët kanë gjetur argumente kundër ose edhe neutrale mbi ndikimin e IHD-ve në rritjen ekonomike në përgjithësi të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Autorët Mitic & Ivić, (2016) gjetën një nivel domethënës korelacioni midis IHD-ve dhe eksportit të mallrave. Poashtu edhe autorët Selimi, Sadiku & Reçi, (2016) gjetën një efekt pozitiv dhe statistikisht domethënës të IHD-ve në ecurinë e eksporteve në Shqipëri, Kroaci, Bullgari dhe Maqedoni.

Gjithsesi, marrë në konsideratë që mbi rëndësinë e IHD-ve në aspekt teorik dhe empirik diskutohet në kapitullin e dytë të këtij studimi të doktoratës, vlen të theksojmë se Kosova është shtet i ri, me një ekonomi të brishtë, të dalë nga lufta. Menjëherë pas luftës dhe hyrjes së Forcave të KFOR-it, në të njëjtën kohë, Kosova hyri drejtpërdrejt në fazë të tranzicionit. Një nga faktorët esencial për një proces të suksesshëm të ristrukturimit ekonomik të Kosovës si një vend i Ballkanit Perëndimor, është padyshim forcimi i gjyqësorit, zbatimi i ligjit, reformat ekonomike dhe qëndrueshmëria politike me të vetmin qëllim të hapjes së ekonomisë

drejt investitorëve të huaj. Vështirësitë me të cilat është ballafaquar Kosova në fushën ekonomike, politike dhe zbatimin e ligjit janë të mëdha!

Qëllimi i punimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi, është të studiohet harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë të Unionit Evropian në fushën e investimit të kapitalit të huaj. Për t'u arritur qëllimi kryesor i këtij studimi është i pa shmangshëm interpretimi i kornizës ligjore mbi Investimet e Huaja Direkte në Kosovë ndër vite si edhe legjislacioni i Bashkimit Evropian.

Se sa Kosova është e përgatitur që të tërheqë kapitalin e huaj, së pari nga aspekti ligjor, pastaj nga aspekti i politikës ekonomike dhe financiare, është objekti kryesor i këtij studimi. Analiza e aspektit ligjor dhe e politikës ekonomike e financiare të Kosovës, do të ishte jo e plotë, po qe se, mbarë legjislacioni i Kosovës nuk do të vështrohej edhe në kontekst të kuadrit ligjor, që tani është në fuqi dhe zbatohet në shtetet anëtare dhe në vetë Bashkësinë Evropiane.

Më tej studiohet niveli i sigurisë që ofron legjislacioni i Kosovës për veprimet konkrete të investimit të kapitalit të huaj në Kosovë e që do të thotë se, nëse ky nivel tani për tani nuk ofron siguri të mjaftueshme, vallë, investuesit e kapitalit të huaj a mund, respektivisht, a do të mund të llogarisin në një mbështetje plotësuese në drejtim të krijimit të instrumenteve përkatës ligjore, të cilët jo vetëm që do të garantojnë sigurinë juridike të kapitalit të huaj të investuar në Kosovë, por, që, në anën tjetër, do të sigurojnë edhe zbatimin e praktikave më të mira investuese, në pajtim me kërkesat thelbësore të teorisë dhe të praktikës më bashkëkohore?

Megjithatë, pasi që sistemi ligjor i Kosovës, siç del edhe nga përshkrimi i pjesshëm i dokumentacionit ligjor dhe nënligjor, i prezantuar në pjesën e këtij arsyetimi, jep shpresë se synimi dhe qëllimi i këtij punimi do të realizohet me sukses, është e kuptueshme se kuptimi i shumëfishtë i termit “investim” dhe zbatimi i këtij termi në shumë fusha të shkencës dhe të praktikës, mund të jetë një kufizim objektiv.

Objektivat e ngritura në studim

Objektivat kryesore të ngritura në këtë studim të doktoratës janë:

- 1) Të analizohet korniza ligjore mbi IHD-të në rastin e Kosovës ndër vite;
- 2) Të analizohet korniza ligjore mbi IHD-të e Bashkimit Evropian;
- 3) Të analizohet komparacioni legjislativ i IHD-ve, Kosovë-BE;
- 4) Të analizohen faktorët influencues të IHD-ve dhe përfitueshmëria e vendeve nikoqire;
- 5) Të analizohet zbatimi i ligjit, gjyqësori dhe kontratat mbi IHD-të në rastin e Kosovës;
- 6) Të analizohet roli i agjencioneve dhe marrëveshjeve të ndryshme për mbështetjen e IHD-ve në rastin e Kosovës;
- 7) Të analizohet në trend rritja e IHD-ve në Kosovë në komparacion me vendet e reja anëtare të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor;
- 8) Të analizohet trendi i agregatëve kryesorë makroekonomik Kosovë - Vendet e Ballkanit Perëndimor – Vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian.

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Hipoteza thelbësore që do të jetë objekt kryesor i trajtimit në këtë punim, është se vallë sistemi juridik ekzistues i Kosovës dhe, veçmas, tërësia ligjore dhe nënligjore e Kosovës, a mundëson apo nuk mundëson investim të lirë të kapitalit të huaj dhe se ky sistem a siguron në nivel të mjaftueshëm që investimi i kapitalit të huaj të jetë i sigurt dhe fitimprurës si për investuesin ashtu edhe për shoqërinë dhe shtetin e Kosovës?!

Kuptohet, kjo hipotezë (pyetje), në vete ngërthen edhe një varg nënhipotezash: kuptimin e përgjithshëm të investimeve, teoritë e investimeve, investimet e jashtme direkte, rëndësinë dhe rolin e investimeve në zhvillimin ekonomik, rëndësinë e ligjit dhe stabilitetit legjislativ, rolin e agjencive të ndryshme ndërkombëtare në promovimin e investimeve të huaja direkte, pastaj sistemin doganor, tatimor dhe një sërë pyetjesh të tjera që janë në funksion të saj.

Kështu, bie fjala, ndër pyetjet vijuese do të jetë edhe pyetja se subjektet e tanishme juridike, të cilat tash për tash, në sistemin juridik të Kosovës janë bartës të proceseve ekonomike dhe të zhvillimit të gjithmbarshëm të Kosovës, a janë funksionalisht dhe materialisht të përgatitur që karshi subjekteve të huaja të marrin përsipër edhe rolin dhe funksionin e bartësve të investimit të kapitalit të huaj në Kosovë etj?

Pyetjet që janë shtruar dhe kërkojnë përgjigje në këtë punim janë:

1. Cili është kuptimi i përgjithshëm i investimeve?
2. Sa janë të rëndësishme investimet e huaja direkte për zhvillim ekonomik të një vendi?
3. Si i përcaktojnë IHD-të teoricienët e ndryshëm dhe cilët janë faktorët për përcaktimin e tyre? Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e IHD-ve?
4. Cili ka qenë shkaku që janë paraqitur IHD-të?
5. Sa është i rëndësishëm aspekti legjislativ në promovimin dhe mbrojtjen e IHD-ve?
6. Cili është roli i agjencioneve ndërkombëtare në përkrahjen e IHD-ve?
7. Si ndikon transparenca dhe korrupsioni në tërheqjen e IHD-ve?
8. Pse kompanitë multinationale investojnë në vendet më pak të zhvilluara?
9. Cilat janë arsyet e investimit në Kosovë dhe si ndikon pozita gjeografike në përcaktimin e IHD-ve?
10. Sa është i favorshëm legjislacioni i Kosovës për IHD?
11. Cili është roli dhe ndikimi i politikave monetare në tërheqjen e IHD-ve? Si përcaktohen IHD-të për nga natyra juridike?
12. Cilat janë veprimet konkrete juridike më të shpeshta?

Metodologjia e hulumtimit

Për të realizuar synimin dhe qëllimin e punimit, me konsekuencë zbatohen metodat përkatëse shkencore. Pasi që punimi ka për qëllim prezantimin, analizën dhe vlerësimin e sistemit juridik të Kosovës dhe shkallën e harmonizimit të tanishëm të tij me kuadrin përkatës ligjor të shteteve dhe të vetë Bashkimit Evropian, me qëllim që të identifikojë kuadrin ligjor të investimeve të kapitalit të huaj në Kosovë, para së gjithash, do të zbatohet metodën empirike, të mbështetur me metodën induktive dhe atë deduktive, në ndërlidhje të ngushtë me metodën analitike, të përcjellë me metodat e tjera përkatëse të interpretimit juridik.

Mbledhja dhe analiza e dispozitave konkrete ligjore, veçmas e atyre dispozitave që drejtpërdrejt apo tërthorazi rregullojnë çështjet konkrete të sjelljes dhe të realizimit të investimeve në Kosovë, zbatohet edhe metoda komperative me qëllim që rezultatet e studimeve të shikohen edhe nga aspekti i të arriturave në këtë fushë edhe në shtetet e tjera të Ballkanit, të cilat ende nuk janë anëtare me të drejta të plota të Bashkimit Evropian. Dhe, pasi që punimi ka për qëllim që, para së gjithash, të prezantohet, të analizohet dhe të vlerësohet se, në sistemin juridik të Kosovës ekziston apo nuk ekziston një kuadër i mirëfilltë ligjor për investime të kapitalit të huaj dhe pasi që ky fenomen, fenomeni i investimit të kapitalit të

huaj, nuk është specifik për Kosovën por është fenomen i njohur dhe i shprehur edhe në shtetet e rajonit dhe më gjerë, zbatimi i metodës krahasuese, është i domosdoshëm!

Çështjet terminologjike

Nocioni, përkatësisht përkufizimi i investimeve të huaja direkte në shumicën e rasteve apo në rastet më të shpeshta definohet si depozitim i kapitalit, në një ndërmarrje apo biznes të jashtëm për arsye të qeverisjes dhe të kontrollit të tyre. Kontrolli apo administrimi përfshin marrjen e vendimeve në procesin e prodhimit, shitjes, në përpjesëtimin e rezultateve të prodhimit, grumbullimin e vendimeve të tjera të cilat janë të favorshme dhe të njëjtat tregojnë rezultatin e ndërmarrjeve. Investimet direkte kanë forma të ndryshme, si: kontroll absolut, depozitime të barabarta dhe pjesëmarrje më të madhe (mbi 51%) ose pjesëmarrjen e mbetur në shumë më të vogël (nën50%).

Sipas autorit Alfar (2003), termi “investim”, po ashtu mund të ketë edhe nocionin e:

- Futjes së mjeteve monetare në funksion të riprodhimit të zgjeruar;
- Angazhimit të mjeteve monetare nga të ardhurat, kreditë apo nga fondi i amortizimit në favor të zgjerimit të riprodhimit të thjeshtë apo të zgjeruar;
- Shumës së mjeteve të investuara, në të cilën, disa nga format e lartëcekura dhe poshtëcekura;
- Angazhimit të mjeteve të të ardhurave, kredive, fondeve amortizuese apo të fondeve të standardit shoqëror në funksion të objekteve të riprodhimit të thjeshtë dhe të zgjeruar;
- Angazhimit të mjeteve në objekte të riprodhimit shoqëror dhe në letra me vlerë⁷.

Investimet e Huaja Direkte, hyjnë në fushën e transaksioneve juridike-biznesore të një shteti me shtetin apo shtetet e tjera dhe e njëjta mund të realizohet Në forma të ndryshme të tyre, si për shembull prodhimi i mallrave apo i produkteve, si dhe punë të tjera me formë juridiko–biznesore (Smaka, E drejta biznesore, 2007).

Në shumicën e raste, investimet jashtë vendit apo shtetit të caktuar, inkuadrojnë edhe krijimin e bizneseve të reja që realizojnë dhe transferojnë asete të kapitalit. Në këto raste subjekti juridik i një shteti (investitori) që investon jashtë shtetit të tij (shtetin tjetër), në shtetin në të cilin investon, ndër të tjera, bëhet pronar apo bashkëpronar i investimeve të jashtme, varësisht

nga forma e organizimit të tyre si biznes individual apo aksionar (Smaka, E drejta biznesore, 2007, p. 239).

Ndërkaq, në aktet ndërkombëtare dhe nacionale nuk haset një definim i përbashkët i investimeve të huaja, kështu që Investime e Huaja Direkte, sipas përkufizimit të sekretarit të Organizatës Botërore Tregtare, konsiderohen atëherë kur investuesi nga një shtet investon në shtetin tjetër me qëllim që të qeverisë me atë pronësi.

Pra, qëllimi i qeverisjes është ai i cili i ndan investimet e huaja direkte nga ato portfolio e investimit. Fondi Monetar Tregtar, Investimet e Huaja Direkte i përcakton si investime të cilat ndërmerren për arritjen e interesit të vazhduar në ndërmarrje, e cila afaron në ekonominë tjetër nga investuesi, me qëllim që investuesi të merr pjesë në qeverisjen e asaj ndërmarrjeje (Hetemi, Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut, 2005)

Sipas rregullores së Fondit Monetar Ndërkombëtar, investime direkte mund të konsiderohen ato grumbullime (depozitime), kur grumbulluesit e jashtëm mbajnë shumën e më së paku 25% të aksioneve të investuara. Në këtë formë përqindja e aksioneve, i lejon depozituesit e jashtëm të përfaqësohen në Këshillin punëdrejtues. Ndërmarrjet multinacionale, me një fuqi më të madhe ekonomike, kanë njësitë e veta operuese në shumicën e vendeve të botës. Por, sipas natyrës së vet, këto kompani janë nacionale, administrohen nga qendrat kombëtare dhe kanë lidhje të ngushtë me qeveritë e vendeve të tyre. (Berisha, 2002, p. 146)

Vlen të përmendet se angazhimi në promovimin e IHD-ve nuk mungon dhe në këtë drejtim janë të angazhuar disa akterë: Qeveria, Oda ekonomike e Kosovës, USAID-KBS, Euro Info Qendra, Sëisscontact, dhe zyrat përfaqësuese të shteteve të huaja. Aktualisht mungon koordinimi ndërmjet akterëve të ndryshëm, mungon organizimi për koordinim dhe strategjia e promovimit. Është e nevojshme të adresohet kjo situatë në të ardhmen e afërt, krahas promovimit të përparësive që i ka Kosova dhe krijimin e një imazhi të mirë për Kosovën.

Duke u nisur nga fakti se fenomeni shoqëror i njohur në teori dhe në praktikë si „investim” i kapitalit të huaj ka shumë kuptime dhe se si term shkencor e praktik, gjen shprehje si në sistemin juridik ashtu edhe në sistemin ekonomik dhe financiar të secilit shtet bashkëkohor, para së gjithash, saktësohet termi investime, kryesisht për qëllime të këtij punimi.

Nuk ka dyshim pra se, termi investim ka kuptim shumë të gjerë. Përpjekjet për ta definuar këtë term për qëllime të këtij punimi, orientohen, së pari në përcaktimin e këtij termi nga

aspekti shkencor juridik, dhe së dyti, në përcaktimin e këtij termi nga aspekti shkencor ekonomik dhe financiar.

Domosdoshmërinë e përcaktimit paraprak të termit investim, e ilustron më së miri, fakti se ky term gjen zbatim si në fushën e legjislacionit ashtu edhe në fushën e ekonomisë – praktikën e biznesit dhe të financave – praktikën e transaksioneve financiare. Pas përcaktimit terminologjik, investimet, veçmas ato të kapitalit të huaj, do të analizohen në dritën e rregullativës ligjore pozitive të sistemit juridik të Kosovës.

Do të analizohen veçmas ato dispozita ligjore dhe nënligjore që mundësojnë që fenomeni i investimit të kapitalit të huaj të trajtohet si një raport juridik, i krijuar midis subjekteve të caktuara, ndër të cilët së paku njëri prej tyre, patjetër do të duhej të jetë subjekt vendor. Analizat do të zbatohen edhe nga aspekti i rregullativës ligjore pozitive të sistemit juridik të shteteve anëtare dhe të vetë Bashkimit Evropian (veçmas aktet si rekomandime).

Aq sa hapësira dhe qëllimi i punimit do të mundësojë, do të analizohen edhe ato dispozita ligjore dhe nënligjore, vendore dhe evropiane, të cilat mundësojnë që fenomeni i investimit të kapitalit të huaj të trajtohet si një raport juridik, i krijuar midis subjekteve të caktuara, ndër të cilët së paku njëri nga ta (apo disa prej tyre) patjetër do të duhej të jetë/jenë subjekt vendor e tjetri (apo disa të tjerë) do të duhej të jetë/jenë, apo është/janë të huaj.

Struktura e punimit doktoral

Kapitulli i parë, është i modeluar si hyrje, dhe përfshin të gjitha aspektet bazë, qëllimet, objektivat e përcaktuara në studim, pyetjet kërkimore dhe hipotezat, metodat kërkimore të përdorura, metodologjinë e hulumtimit, çështjet terminologjike dhe strukturimin e studimit doktoral.

Kapitulli i dytë, paraqet shqyrtimin e literaturës, përfshirë këtu një rezymë mbi investimet e huaja direkte në përgjithësi, rëndësinë dhe rolin e tyre në rritjen e konkurrueshmërisë, faktorët influencues të Investimeve të Huaja Direkte në përgjithësi. Kosova drejt tërheqjes së Investimeve të Huaja Direkte dhe sfidat e saj dhe aspekte të tjera teroike mbi Investimet e Huaja Direkte.

Kapitulli i tretë, paraqet analizën komparative të legjislacionit mbi Investimet e Huaja Direkte në Kosovë dhe Bashkimin Evropian listuar dhe diskutuar ligjet mbi IHD-të në rastin e Kosovës dhe ligjet e përgjithshme plotësuese që rregullojnë IHD-të, në rastin e Kosovës

dhe njashu pasqyron legjislacionin dhe interpretimin e tij mbi IHD-të në Bashkimin Evropian.

Kapitulli i katërt, pasqyron bazën legjislative që siguron dhe garanton investimin e kapitalit të huaj, rëndësinë e funksionalizimit të ligjit dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik të vendit, gjë që në Kosovë, po edhe në vendet e rajonit, nuk gjen zbatim të plotë dhe ka vend për shqetësim, ngase këto ligje duhet të sillnin stabilitet legjislativ dhe mbrojtje të plotë të investitorëve të huaj, ku do të mbizotëronte transparenca dhe niveli i korrupsionit do të ishte në nivel shumë më të ulët, për të mos thënë në nivelin zero. Poashtu, këtu është pasqyruar edhe roli i agjencioneve ndërkombëtare dhe sistemit tatimor e doganor në promovimin e IHD-ve, pastaj edhe disa sektorë të cilët janë me interes për investitorët e huaj.

Kapitulli i pestë, analizon veprimet konkrete juridike, kontratat, marrëveshjet dypalëshe, të drejtat dhe liritë kontraktuale, dhomat e veçanta të zgjidhjes së kontesteve, natyra juridike e veprimeve dhe modelet e ndryshme juridike paraqesin bazën për promovimin dhe mbrojtjen e investitorëve të huaj dhe sigurimin e një klime sa më të favorshme për të gjithë ata të cilët dëshirojnë të investojnë kapitalin e tyre, që do të ishte me interes dypalësh.

Kapitulli i gjashtë, paraqet analizën krahasimore të IHD-ve në Kosovë dhe në vendet e rajonit, investime këto që janë të domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe rritje të vlerës në shkëmbimet tregtare me tregjet botërore. Këtu flitet edhe për pozitën gjeografike të vendit tonë dhe ndikimi i saj në tërheqjen e IHD-ve e po ashtu flitet edhe për pengesat që paraqiten tek IHD-të. Politikat monetare dhe roli i tyre janë sfidat kryesore në promovimin e IHD-ve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e investimeve dhe krijimin e sa më shumë vendeve të reja të punës.

Kapitulli i shtatë, paraqet konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat pasqyrojnë se investimet e huaja direkte paraqesin segment të rëndësishëm në rrugën drejt zhvillimit ekonomik të vendit. Ekonomitë në tranzicion, ballafaqohen gjithmonë me më shumë probleme sesa ekonomitë e zhvilluara, dhe zakonisht kanë bazë juridike më të dobët në njërën anë, kurse në anën tjetër e kanë domosdoshmërinë e tërheqjes të sa më shumë investimeve të huaja direkte me qëllim të rritjes së konkurrencës dhe ofrimit me tregjet dhe vendet e zhvilluara.

Kufizimet e punimit

Punimi për nga natyra e tij ka karakter multidiciplinor, në të cilin gërshetohen aspektet ligjore

dhe ekonomike. Në këtë studim analizohen hulumtime të ndryshme në drejtim të konstatimeve, qëndrimeve dhe mendimeve të autorëve të ndryshëm, që mbulojnë fushën juridike, por edhe fushën ekonomike dhe financiare të problematikës së investimeve të kapitalit të huaj në përgjithësi. Në mbështetje të konstatimeve, qëndrimeve dhe mendimeve të shprehura, i është referuar letërsisë, legjislacionit, analizave dhe vlerësimeve zyrtare, duke ndjekur me kujdes udhëzimet nga sistemi i referencimit APA. Bibliografia kryesisht përfshin letërsinë e cituar në referenca. Por, lista bibliografike do të pasurohet edhe me tituj, të cilët i referohen materies, apo të cilët materien e mbarështruar në punim, e trajtojnë ndryshe apo për këtë materie japin konstatime, qëndrime a mendime të tjera.

Megjithëse literatura e shqyrtuar që mbështet gjetjet nga ky studim doktoral është shumë e gjërë, përfshirë literaturën ndërkombëtare dhe kombëtare, pasqyruar në këtë mënyrë edhe aspektet legjislative bazuar në kornizat ligjore Kosovë – BE, dhe interpretuar agregatët kryesorë makroekonomik duke përfshirë: Investimet e Huaja Direkte, rritjen e produktit të brendshëm bruto për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë krahasuar Kosovë-Vendet e Ballkanit Perëndimor si edhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, gjithsesi punimi ka kufizime. Edhe përkundër faktit se studimi bazohet në një analizë të mirëfilltë të gërshetimit të aspekteve juridike – ekonomike, sërish studimi hap shtigje të reja hulumtimi për hulumtuesit e rinj, konkretisht analizën ose matjen e ndikimit të legjislacionit në rritjen e IHD-ve, me të dhëna panel dhe të serive kohore. Për hir të të dhënave në dispozicion, qasja e analizës ekonometrike mbetet njëherit kufizimi kryesor i këtij studimi.

KAPITULLI II

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Definicione mbi investimet dhe Investimet e Huaja Direkte

Me nocionin investime kuptojmë një gamë të tërë të aktiviteteve. Në kuptimin e gjerë, investimet paraqesin angazhimin e kapitalit në patundshmëri; letra me vlerë dhe aksione; projekte shërbyese dhe prodhuese; studime dhe kërkime shkencore; zhvillim teknologjik; ddukim të personelit etj. (Paul, 2010). Kuptohet që investimi në vete gjithsesi paraqet realizimin e profitit, por edhe qëllimet ekspansioniste, pushtimin e tregjeve me produkte dhe patentë e licenca. Qëllimi i çdo investitori është që me anë të investimeve të arrijë sigurimin e ekzistencës në rrethinën e pasigurtë, të ngrisë nivelin e efikasitetit dhe mirëqenies, në saje të efekteve financiare që do të merren në të ardhmen (Easterly, 2002). Në kohën e sotme, pothuajse pjesa më e madhe e ekonomive botërore janë të hapura ndaj konceptit të globalizimit, që nënkupton lirinë e qarkullimit të njerëzve, kapitalit, dijes etj.

Në kuptimin e gjerë të fjalës, me termin investime nënkuptojmë të hyrat nga shitja ose fitimi mbi baza të mjeteve të harxhuara individuale dhe kolektive nga organizata e punës, kolektivi politiko-shoqëror dhe organet e saj, organizatat shoqërore dhe personat e tjerë juridikë të cilët shfrytëzojnë mjete shoqërore. Investime themelore (kapitale), nënkuptojnë tërësinë e shpenzimeve që bëhen gjatë një periudhe të caktuar, për të krijuar fonde themelore të reja prodhuese (ndërtesa prodhimi, makineri etj.) dhe joprodhuese (ndërtesa me karakter social, kulturor etj.) ose për përtëritjen dhe zgjerimin e tyre.

Investimet përfaqësojnë shpenzimet e ndërmarrjes ose organizatës që kanë për qëllim zgjerimin e saj. Ato përfshijnë investimin në para ose kapital, me qëllim të sigurimit të kthimeve profitabile në formë interesi apo të të ardhurave. Pra, investimi nënkupton angazhimin e një shume të dhënë të parave në kohën e tanishme, në pritje të kthimit të një shume më të madhe në të ardhmen (Mustafa I. , 2008)

Definicione mbi Investimet e Huaja Direkte

Karakteristika e rëndësishme e investimeve të huaja të drejtpërdrejta ka të bëjë me faktin se ato nuk përfshijnë vetëm transferin e resurseve, por edhe mbikëqyrjen drejtuese. Me fjalë të

tjera, ekspozitura nuk e ka vetëm obligimin financiar ndaj ndërmarrjes mëmë, por është pjesë e strukturës së njëjtë organizative (Krugman P. R., 2010).

Kur jemi tek investimet e huaja atëherë medoemos duhet të flasim edhe nga aspekti juridik për investimet e huaja direkte që paraqesin njërën nga fuqitë themelore lëvizëse të procesit të globalizimit të ekonomisë botërore dhe janë mirë të rregulluara edhe me legjislacionet e vendeve të ndryshme, si dhe të mbrojtura në mënyrë që të mos shfaqen probleme gjatë procesit të ngritjes, përkatësisht fazës së rritjeve ekonomike. Në këto suaza, faktori ligjor është faktori crucial për të krijuar lidhje ekonomike ndërmjet vendeve industriale me shtetet në zhvillim (Instituti Demokracia për Zhvillim, 2017)

Investimet e Huaja Direkte (IHD) janë të përcaktuara si "investim i bërë për të fituar interes të qëndrueshëm në ndërmarrjet që operojnë jashtë ekonomisë së investitorit". Ato konkretisht përcaktohen si marrëdhënie ndërmjet një ndërmarrjeje mëmë dhe një filiali të huaj që formojnë një korporatë shumëkombëshe, ku kusht përcaktues që të llogariten si investim i huaj direkt është që investimi i realizuar duhet t'i lejojë ndërmarrjes mëmë kontrollin e degës së saj të huaj (Blaine, 2009). Investimet e Huaja Direkte (IHD) janë investime që realizohen nga një subjekt i një vendi në një biznes apo korporatë, në një vend tjetër, me qëllim të krijimit të një interesi të qëndrueshëm.

2.3. Teoritë e Investimeve të Huaja Direkte

Në literaturën teorike ekzistojnë një mori autorësh të cilët kanë tentuar të analizojnë arsyen pse ndodhin Investimet e Huaja Direkte, faktorët influencues të përzgjedhjes së një vendi të dytë për investim, pse Investimet e Huaja Direkte janë kaq të rëndësishme dhe kërkojnë edhe kornizë ligjore për të rregulluar të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me IHD-të, çfarë efektesh gjenerojnë në ekonominë e vendeve pritëse dhe asaj të origjinës.

Teoria e Ciklit të Prodhimit sipas Vernon

Teoria e ciklit të prodhimit të zhvilluar nga Vernon në vitin 1966 u përdor për të shpjeguar disa lloje të investimeve të huaja direkte të bëra nga kompani amerikane në Evropën Perëndimore, pas Luftës së Dytë Botërore, në industrinë e prodhimit. Sipas autorit Vernon, ekzistojnë katër faza të ciklit të prodhimit: inovacioni, rritja, pjekuria dhe rënia (Denisia, 2010, p. 55).

Sipas autorit Vernon, si gjithmonë në fazën e parë të prodhimit, kompanitë transnacionale amerikane, kanë krijuar produkte të reja inovative, para së gjithash për konsum vendor dhe më pas kanë eksportuar, në mënyrë që t'i shërbejnë edhe tregjeve të huaja. Sipas teorisë së ciklit të prodhimit, pas Luftës së Dytë Botërore, në Evropë, është rritur kërkesa për produkte të prodhuara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë mënyrë kompanitë amerikane kanë rritur eksportin duke krjuar disavantazh teknologjik ndaj konkurrentëve ndërkombëtarë. Normalisht që në fazën e parë të prodhimit, falë teknologjisë, prodhuesit kanë krijuar duke standardizuar produktin, mirëpo gjithmonë ka pasur kompani të cilat kanë kopjuar produktin, dhe për këtë arsye kompanitë amerikane janë detyruar të kryejnë lehtësira prodhimi në tregjet lokale për të ruajtur pjesën e tyre të tregut në ato zona.

Teoria e normave të këmbimit në tregjet e papërsosura të kapitalit

Në literaturën ekonomike mbi Investimet e Huaja Direkte ekzistojnë teori nga autorë të ndryshëm të cilët kanë tentuar të sqarojnë Investimet e Huaja Direkte në kuptim të arsyeshmërisë së ndodhjes së tyre ndër vite. Një teori tjetër që përpiket të sqarojë Investimet e Huaja Direkte është teoria e normave të këmbimit në tregjet e papërsosura të kapitalit. Sipas kësaj teorie, qasja e analizës, bazohet nga rreziku i këmbimit valutor, konkretisht, analizuar nga perspektiva e tregtisë ndërkombëtare. Autori (Cushman, 1985) analizoi ndikimin e pasigurisë si një faktor ndikues të IHD-ve. Në të vetmen analizë empirike të bërë deri më tani, Cushman tregon se rritja reale e kursit të këmbimit, stimuloi IHD-të të bërë nga USD, ndërsa një mbiçmim i monedhës së huaj ka zvogëluar IHD-në Amerikane.

Autori në fjalë arrin në përfundimin se mbiçmimi i dollarit ka çuar në një ulje në FDI të Sh.B.A me 25%. Sidoqoftë, teoria e normës së rrezikut të monedhës, nuk mund të shpjegojë investimet direkte të huaja midis vendeve me monedha të ndryshme. Mbështetësit argumentojnë se investime të tilla bëhen në periudha të ndryshme, por ka mjaft raste që kundërshtojnë këto pretendime.

Teoria eklektike sipas Dunning

Ekziston një larmi e gjerë strategjish për të zgjedhur mënyrën e hyrjes dhe të gjitha kanë të mirat dhe të këqijat e tyre. Strategjitë e përdorura shpesh janë eksportimi, licencimi, ekskluziviteti, formimi i një aleance strategjike, krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, blerja, ose fillimi nga e para me një investim greenfield.

Këto tre të fundit, përfshijnë investime me kapital të madh dhe për këtë arsye konsiderohen forma të Investimeve të Huaja Direkte (IHD). Një mënyrë e mirë që të paktën të përjashtohen disa prej tyre është përdorimi i të ashtuquajturës paradigme OLI (e njohur edhe si paradigma eklektike). OLI (Ownership-, Location- and Internalization) është një akronim për avantazhin e Pronësisë, Vendndodhjes/Lokacionit dhe Ndërkombëtarizimit. Sipas kësaj paradigme, një kompani ka nevojë për të trija avantazhet në mënyrë që të jetë në gjendje të angazhohet me sukses në kuadër të Investimeve të Huaja Direkte. Nëse një ose më shumë nga këto avantazhe nuk janë të pranishme, kompania mund të dëshirojë të përdorë një strategji të ndryshme të hyrjes.(Lars de Bruin, 2020)

Konkretisht, teoria eklektike, është zhvilluar nga profesori Dunning dhe paraqet një ndërthurje të tre teorive të ndryshme të Investimeve të Huaja Direkte, konkretisht teorinë e pronësisë (ownership), teorinë e lokacionit (Location) dhe teorinë e ndërkombëtarizimit (International) që ndryshe njihet si O-L-I paradigma. E sa i përket avantazhit që një kompani duhet të posedojë për tu kyqur në IHD, është ai i pronësisë që i referohet pasurive jo-materiale, të cilat janë, të paktën për një kohë, posedime ekskluzive të kompanisë dhe mund të transferohen brenda kompanive transnacionale me kosto të ulët, duke çuar ose në të ardhura më të larta ose kosto të ulta. Këto avantazhe janë kompetencat e pronës ose përfitimet specifike të kompanisë.

Në këtë rast, pretendohet që kompania është një monopol mbi avantazhet e veta specifike dhe përdorimi i tyre jashtë vendit çon në përfitim më të lartë marxhinal ose me kosto më të ulët marxhinale sesa konkurrentët e tjerë.

Përparësitë e vendndodhjes së vendeve të ndryshme janë faktorë kryesorë për të përcaktuar se kush do të bëhen vendet pritëse për aktivitetet e korporatave transnacionale. Përparësitë specifike të secilit vend mund të ndahen në tri kategori: (Denisia, 2010)

- ❖ Përfitimet ekonomike përbëhen nga faktorë sasiorë dhe cilësor të prodhimi, kostot e transportit, telekomunikacionit, madhësia e tregut etj.;
- ❖ Përparësitë politike: politikat e zakonshme dhe specifike qeveritare që ndikojnë në IHD rrjedh;
- ❖ Avantazhet sociale: përfshinë distancën midis vendlindjes dhe vendeve të shtëpisë, diversitetin kulturor, qëndrimin ndaj të huajve etj

Duke supozuar se janë plotësuar dy kushtet e para, përdorimi i këtyre avantazheve, duhet të jetë fitimprurës për kompaninë, në bashkëpunim me të paktën disa faktorë jashtë vendit të origjinës (Dunning, 1988)

Teoria e ndërkombëtarizimit si pjesë e teorisë elektike O-L-I është një kornizë në suaza të së cilës kompania duhet të shfrytëzojë të gjitha fuqitë në dispozicion të saj për të përfituar në një treg të huaj. Ndërkaq sa më shumë që përfitimet e tregut ndërkufitar janë më të larta, aq më shumë firma do të dëshirojë të angazhohet sesa të ofrojë mënyra bashkëpunimi të tilla si licenca ose franshiza.

Rëndësia ekonomike e Investimeve të Huaja Direkte

Investimet e Huaja Direkte luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e çdo vendi, veçanërisht në ekonomitë e vendeve në zhvillim. Trendet globale dëshmojnë se vendet në zhvillim e sipër pretendojnë gjithnjë e më shumë për të tërhequr Investimet e Huaja Direkte, duke krijuar klimë të favorshme investive përfshirë këtu edhe zbatimin e ligjit.

Konkretisht klima e investimeve përbëhet nga tre elemente (USAID, 2007, p. 14):

- Stabiliteti makroekonomik - është një funksion i reformave që vendosin kurset e këmbimit konkurrues dhe normat e interesit të përcaktuara nga tregu; disiplinë fiskale; sisteme efikase tatimore dhe menaxhim të kujdesshëm të shpenzimeve publike dhe borxhit publik; privatizimit; të drejtat pronësore; si dhe mjediset e liberalizuara të tregtisë dhe politikës së investimeve;
- Mjedisi biznesor - përbëhet nga faktorë mikroekonomikë që ndikojnë në mënyrën e funksionimit të individëve ose firmave duke përfshirë: qeverisjen e mirë (të drejtat e pronës, transparencën, sundimin e ligjit), hapjen ndaj tregtisë dhe shtrembërimet minimale (pengesat administrative / shiritin e kuq);
- Infrastruktura përfshin - infrastrukturën fizike, teknologjike dhe sociale, siç janë energjia elektrike, uji, transporti dhe sistemet e komunikimit; teknologjia e informacionit dhe komunikimit; dhe shërbimet shëndetësore dhe arsimore.

Bazuar në (OECD, 2008, p. 14) Investimi i Drejtpërdrejtë i Huaj (IHD) është një element kryesor në këtë integrim ekonomik evolucionar me shpejtësi, i referuar gjithashtu si globalizim. IHD-të sigurojnë një mjet për krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta, të qëndrueshme midis ekonomive. Vendet në zhvillim dhe në tranzicion kanë një interes

veçanërisht të fortë për tërheqjen e kapitalit të huaj. Kursimet e brendshme shpesh janë të pamjaftueshme në këto vende për të financuar nevojat e tyre për investime.

Kjo mungesë e kapitalit ndikon si në investimet publike ashtu edhe në ato private (Drabek & Payne, 2002). Nën mjedisin e duhur të politikës, IHD-të mund të shërbejnë si një mjet i rëndësishëm për zhvillimin e ndërmarrësisë lokale, dhe gjithashtu mund të ndihmojë në përmirësimin e pozitës konkurruese, si të ekonomisë marrëse ("pritëse") ashtu edhe të investimit ("shtëpi"). Në veçanti, IHD-të inkurajojnë transferimin e teknologjisë dhe njohurive midis ekonomive, duke ofruar kështu një mundësi për ekonominë pritëse për të promovuar produktet e saj më gjerësisht në tregjet ndërkombëtare. IHD-të, përveç efektit pozitiv në zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare, janë një burim i rëndësishëm i kapitalit për një gamë të ekonomive pritëse (OECD, 2008).

Vendet pritëse në këtë rast duhet të ndërmarrin të gjitha masat lehtësuese dhe atraktive për tërheqjen e investitorëve të huaj duke promovuar stabilitet ekonomik, politik, klimë të favorshme të biznesit, rregullativa ligjore të hartuara në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian si edhe sundimin e ligjit me qëllim që investitori i huaj të ndjehet i sigurt për investimin në vendin potencial pritës.

Investimet e Huaja Direkte lehtësojnë dukshëm dhe nxisin rritjen ekonomike në vendet në zhvillim duke rritur kursimet dhe investimet dhe konkretisht duke transferuar përvojë, teknologji dhe njohuri të reja. (Mottaleba & Kalirajan, 2010)

Kanalet nëpërmjet të cilave IHD-të ndikojnë në ekonominë pritëse

Njohur ndërkombëtarisht, ndikimi pozitiv i Investimeve të Huaja Direkte, si për vendet e origjinës ashtu edhe për ato pritëse potencohet mbi suaza të kanaleve nëpërmjet të cilave Investimet e Huaja Direkte ndikojnë në ekonominë pritëse.

Në përgjithësi IHD-të ndikojnë në ekonomi bazuar në:

- ❖ Faktorët makroekonomik përfshirë: bilancin e pagesave, stokun e kapitalit, normën e punësimeve, pritet që në këtë pikëpamje IHD-të të përmirësojnë bilancin e pagesave, të rrisin numrin e punësimeve në përgjithësi duke transferuar njëherit përvojën dhe

dijen;

- ❖ Faktorët institucional, përfshirë këtu kornizën ligjore, politikat, ligjet mbi IHD-të, ligjet mbi konkurrencën, sistemin arsimor. Korniza ligjore është më se e rëndësishme që investitori i huaj të jetë i sigurtë si në zbatim të ligjit ashtu edhe të aspekteve kontraktuale, të jetë i mborjtur me ligj nga çdo dëmtim i mundur potencial;
- ❖ Faktorët socialë përfshirë: etikën e biznesit, standardet e punës, pagën. Investimet e huaja direkte janë poashtu shtytës mbi përmirësimin e kushteve të punës edhe në ndërmarrësinë lokale me të vetmin fakt që IHD-të ofrojnë zakonisht kushte më të mira pune dhe paga më të mira;
- ❖ Mjedisin natyror, përfshirë standardet globale dhe ndotjen.



Figura 1. Kanalet e ndikimit të Investimeve të Huaja Direkte

Burimi: Përrshatur nga Klaus E Meyer 2005, Foreign Direct Investment in Emerging Economies. Templeton College Oxford Policy Discussion Paper, Emerging Markets Forum

Siç është paraqitur në Figurën mbi kanalet e ndikimit të IHD-ve, IHD-të ndikojnë edhe në çështjet sociale që lidhen me sjelljen e biznesit: praktikat etike të biznesit, dhe standardet e punës dhe pagat (Meyer, 2005). IHD-të kanë potencialin të jenë një shtytës i rëndësishëm i rritjes ekonomike dhe diversifikimit. Zhvendosja e forcës së punës të një vendi nga vendet e punës me vlerë të shtuar më të lartë do të varet nga nxitja e një game më të gjerë mundësish për aktivitetin ekonomik privat dhe nga aftësia e kompanive lokale për t'u integruar në zinxhirët e vlerës së prodhimit global.

Investimet e Huaja Direkte janë shtegu në ato zinxhirë vlerash globale, duke i lejuar vendeve

në zhvillim mundësinë që të angazhohen dhe të përfitojnë nga ekonomia botërore. Investitorët e huaj mund të krijojnë vende pune, të sjellin kapital dhe teknologji të reja dhe të krijojnë shpërndarje të njohurive. Por këto përfitime nuk janë automatike. Disa vende tërheqin sasi të mëdha të investimeve të huaja dhe kurrë nuk e ngrisin lartë zinxhirin e vlerës. Për të maksimizuar ndikimet e zhvillimit të investimeve të huaja, nevojitet një kornizë e përshtatshme e politikës së investimeve (Rashid, 2017).

Ndërkaq autori (Nunnenkamp, 2004) ka argumentuar se kërkohet që vendet në zhvillim të arrijnë një nivel minimal të zhvillimit ekonomik për të arritur përfitime të vlefshme nga IHD-të, meqë kushtet e vendit nikoqir që tregojnë institucione të dobëta dhe faktorë të pamjaftueshëm për prodhim, kufizojnë në mënyrë kritike efektet pozitive të IHD-ve.

Autori në fjalë, gjithashtu insiston që, për vendet pritëse, marrja e vlerës nga IHD-të është më e vështirë sesa vetë tërheqja e IHD-ve. Pikërisht bazuar në kanalet nëpërmjet të cilave IHD-të ndikojnë në ekonominë e një vendi, padyshim vinë në shprehje konrnizat ligjore mbi IHD-të dhe zbatimin e ligjit. Vetëm me një politikë të mirëfilltë ekonomike, shoqëruar me rregullativat juridike të hartuara konform rregullativave të BE-së dhe zbatimin e ligjit, shtetet me ekonomi në zhvillim mund të pretendojnë tërheqjen e investimeve të huaja në sektorë produktiv që do të orientojnë vendin drejt një rritjeje të qëndrueshme ekonomike.

Arsyet e investitorëve të huaj për të investuar në një vend potencial pritës

Bazuar në literaturën e gjërë ekonomike, çdo investim i huaj paraqet një transaksion biznesi. Shikuar nga ky këndvështrim, vlen të theksojmë se arsyet pse një investitor i huaj vendos të investojë në një shtet potencial pritës janë të shumta dhe të ndryshme.

Sipas raportit të (USAID, 2007) theksohet se më shpesh, ato janë kërkimi i burimeve natyrore, tregjet, efikasiteti i prodhimit, asetet strategjike, ose një kombinim i këtyre. Dunning në vitin 1988 ka propozuar teorinë e paradigmës eklektike që vendimi i një investitori të huaj për të investuar në një vend pritës varet nga madhësia e firmës, sistemet e administrimit dhe menaxhimit, kostot e punës dhe të transportit, politikat qeveritare, si dhe institucionet dhe stabiliteti politik.

Investitorët e huaj mund të jenë më të shqetësuar për rrezikun dhe kthimin kur hyjnë në

tregjet e huaja (Fedderke & Romm, 2006). Pikërisht jostabiliteti politik në rastin e Kosovës është pengesë e thithjes së IHD-ve. (Harms & Ursprung, 2002) zbulojnë se investitorët e huaj, investojnë në vendet me struktura të forta demokratike, ndërsa shoqëritë autokratike shpesh përjetojnë përmbysje të politikave dhe tërheqin më pak Investimet e Huaja Direkte.

Kosova në rrugën drejt tërheqjes së Investimeve të Huaja Direkte

Kosova si njëra ndër shtetet e Ballkanit Perëndimor, me një ekonomi në zhvillim e sipër, ka hartuar marrëveshje të shumta drejt tërheqjes së Investimeve të Huaja Direkte. Në përgjithësi, vëmendje shumë e vogël i është kushtuar IHD-ve në Ballkanin Perëndimor, meqë konsiderohen vende me tranzicion të ngadalshëm dhe shumë pak të sukseshme në reformat e kërkuara nga Bashkimi Evropian, si në pikëmpaje ekonomike ashtu edhe në atë juridike. Kapitali i huaj në përgjithësi për vendet e Ballkanit Perëndimor, konkretisht edhe për Kosovën konsiderohet një shtesë e rëndësishme për kursimet e brendshme.

Marrë në përgjithësi, investitorët e huaj kanë investuar në shërbime jo të tregtueshme të ekonomive të Ballkanit, kryesisht në shërbimet bankare, ato telekomunikuese, tregti dhe pasuri të paluajtshme. Deri në krizën globale ekonomike në fund të vitit 2008, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pësuar një rritje të shpejtë ekonomike dhe rritje të stabilitetit makroekonomik, veçanërisht të rëndësishme pas hiperinflacionit në vitet 1990. Liberalizimi i tregtisë pas vitit 2000, si me BE-në, ashtu edhe me vendet e tjera të rajonit, ka kontribuar në një rritje të jashtëzakonshme të vëllimit të tregtisë së jashtme, mirëpo pas mungesës së interesit të investitorëve të huaj në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 1990, ka patur një ngritje të shpejtë të IHD-ve në vitin 2000, të nxitura nga privatizimet e ndërmarrjeve dhe bankave dhe përmirësimi i perspektivave ekonomike. (Estrin & Uvalic, 2016).

Konkretisht edhe pse ka pasur gjithnjë pretendime për reforma dhe rritjen e marrëveshjeve ndërshtetërore për liberalizimin e tregtisë, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk arrijnë të tërheqin Investime të Huaja Direkte në nivelin mesatar të BE-se për shkaqe të problemeve të shumta të trashëguara nga tranzicioni, si në rrafshin ekonomik ashtu edhe në atë politiko – ligjor.

Kosova si një shtet i Ballkanit Perëndimor është e kufizuar në aftësinë e saj për të tërhequr investime të huaja për shkak të mungesës së shpërndarjes së informacionit brenda tregjeve globale, komunikimit të dobët ndërkombëtar në lidhje me mjedisin ekonomik dhe mundësi

për investime të huaja, dhe mungesës së vlerësimit të kredisë nga një agjenci e besueshme e huaj e vlerësimit.

Hyrjet e investimeve të huaja gjithashtu janë penguar nga shkalla e lartë e korrupsionit, reformat e ngadalta dhe joefektive të mjedisit të biznesit, mungesa e transparencës, pasiviteti ekonomik në shumë sektorë, perceptimi negativ nga investitorët e huaj dhe popullsia në diasporë, si dhe mosarritja e institucioneve për të zbatuar dhe arritur qëllimet e tyre të përcaktuara. (Pula, Loxha, & Elshani, 2017). Megjithatë me kalimin e viteve edhe Kosova shënon një shkallë rritjeje të potencialit të saj për tërheqjen e IHD-ve.

Ekzistojnë disa mënyra në të cilat Kosova është tërheqëse për investitorët e huaj. Këto përfshijnë shkallën dinamike të rritjes së vendit (me një mesatare prej 3.8% në dhjetë vitet e fundit), dhe shkallën e sheshtë të taksave të korporatave të saj në 10%. Për më tepër, Ligji i Ratifikuar për Investime Strategjike (Ligji nr.05/L-079) synon të lehtësojë aksesin në treg për investitorët në sektorët kryesorë. Ndërkohë, edhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (Fondi Kosovar për Garanci Kreditore) për të përmirësuar hyrjen në kredi së bashku me Ligjin për Falimentimin, është një përpjekje për të përmirësuar legjislacionin tregtar, ashtu si edhe fakti që Kosova ka një popullsi relativisht të re, me rreth 67% të 1.8 milion njerëzve të saj në moshë pune (15-64), është hap goxha i rëndësishëm drejt rritjes së apelit të Kosovës (Çollaku, 2018).

Megjithatë, krahas përparësive, ekzistojnë edhe një mori sfidash me të cilat Kosova përballet drejt tërheqjes së IHD-ve. Këto sfida përfshijnë: integrimin e kufizuar ekonomik rajonal dhe global, paqëndrueshmërinë politike, korrupsionin (Kosova renditet në vendin e 85-të nga 180 në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparencës Ndërkombëtare, një nga më të ultat në CESEE), furnizimin jo të besueshëm të energjisë, ekonominë e madhe informale (vlerësohet në 31% të PBB-së, kryesisht në sektorët e bujqësisë, ndërtimit dhe shitjes me pakicë), sundimi i dobët i ligjit, dhe veçanërisht mungesa e zbatimit të kontratave për shkak të gjyqësorit të dobët. (Çollaku, 2018)

Këta faktorë duket se kanë kontribuar në rënien dhe paqëndrueshmërinë e IHD-ve gjatë dekadës së fundit në rastin e Kosovës.

Legjislacioni kosovar nuk kërkon që IHD –të të kontrollohen, rishikohen ose aprovohen, dhe ligjet kombëtare nuk bëjnë diskriminim ndaj investitorëve të huaj. Sidoqoftë, investitorët e

huaj dekurajohen, ndër të tjera nga:

- nivelet e larta të korrupsionit;
- procedurat e ngadalta gjyqësore;
- mungesa e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale;
- konkurrenca nga shitësit e pa licencuar dhe parregullsitë në procedurat e prokurimit publik.

Sidoqoftë, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë të qëndrueshëm që akoma inkurajojnë IHD-të në Kosovë përfshirë:

- qëndrimi pro-afarist i qeverisë kosovare;
- vendndodhja strategjike e vendit;
- burimet e pasura natyrore;
- fuqia punëtore e arsimuar;
- një shkallë e sheshtë e 10% të taksave të korporatave dhe
- përjashtimet e përkohshme të pagesave të Taksës së Shtuar (TVSH) për eksportuesit e rinj.

Këto faktorë kanë ndihmuar në tërheqjen e disa investitorëve të huaj, konkretisht “Raporti i të bërit biznes 2020” i botuar nga Banka Botërore, e rendit Kosovën në vendin e 57-të nga 190 ekonomi, që paraqet një humbje prej trembëdhjetë pikash krahasuar me një vit më parë. Sidoqoftë, Kosova ka një nga rezultatet më të larta në rajon, duke qenë e dyta vetëm pas Kroacisë, e cila renditet në vendin e 51-të. (Santander Trade Markets, 2020)

Investimet e Huaja Direkte janë shumë të rëndësishme meqë ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i përfitimeve që vijnë nga investimet e huaja në vendet pritëse, duke përfshirë brendin e tyre, përvojën disa vjeçare dhe shumë profesionale, teknologjinë e avancuar, etj. Këto njëherit janë faktorë që ndikojnë edhe në rritjen e konkurrencës vendore!

Në raportin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ndër të tjera theksohet se investitorët e huaj nuk janë më vetëm të interesuar në aspektet teknike të marrjes së lejes së ndërtimit apo operimit në ndonjë shtet. Ajo që në baraspeshë ndikon tek investitorët e huaj është faktori politik në shtet apo rëndësia e stabilitetit politik, funksionimi i mirëfilltë i gjyqësorit dhe dhomave ekonomike, popullata e shkolluar për t’ju përshtatur nevojave të tregut. (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 2018, p. 30). Pra, vlen të theksohet se stabiliteti politik, funksionimi i

mirëfilltë i gjyqësorit, zbatimi i ligjit, popullata e shkolluar dhe e përgatitur karshi nevojave të tregut të punës janë faktorë shumë të rëndësishëm që Kosova si shtet duhet t'i mer në konsideratë për të përmirësuar rritjen e IHD-ve në vitet në vijim.

Investimet e Huaja Direkte sipas shteteve që më së shumti kanë investuar në Kosovë janë: Gjermania, Zvicra, Turqia, Austria dhe Mbretëria e Bashkuar dhe vazhdojnë të jenë investitorët kryesorë në Kosovë. Në këtë drejtim portfolio e investimeve të jashtme është mjaft e koncentruar dhe diversifikimi i investimeve të huaja mbetet në nivel jo të kënaqshëm, duke treguar se ende ka hapësirë për përmirësimin e ofertës dhe ngritjen e nivelit të investimeve nga shtetet tjera. (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 2018)

KAPITULLI III

ANALIZË KOMPARATIVE E LEGJISLACIONIT MBI INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË DHE BASHKIMIN EVROPIAN

Interpretimi i ligjit të IHD-ve në rastin e Kosovës

Investimet e Huaja Direkte luajnë një rol shumë të rëndësishëm në rritjen ekonomike veçanërisht nëse korniza ligjore është mirë e formuluar dhe e njëjta gjen zbatim. Për këtë arsye edhe qëllim kryesor i këtij studimi doktoral është të analizohet legjisacioni mbi IHD- të në rastin e Kosovës në komparacion me legjisacionin e IHD-ve në rastin e Bashkimit Evropian. IHD-të janë shumë të rëndësishme veçanërisht për shtetet në zhvillim e sipër siç është Kosova.

Qeveria e Republikës së Kosovës (QeK) që nga shpallja e pavarësisë e deri më tani edhe pse ka shënuar përparim në disa faktorë që njihen se kontribuojnë në rritjen e IHD-ve, përfshirë: politikën tatimore më të favorshme në rajon; liberalizimin; politikat e balancuara makroekonomike; infrastrukturën e mirë rrugore; stabilitetin ekonomik dhe sistemin e sigurt bankar etj, megjithatë hulumtimi tregon se: niveli i ulët i besueshmërisë institucionale, pengesat fiskale, pengesat administrative, korrupsioni, haraçi, krimi, vjedhja dhe ekonomia joformale vazhdojnë të jenë pengesa kryesore për të bërë biznes në Kosovë dhe kërcënojnë mjedisin e biznesit për tërheqjen e IHD në Kosovë (Gashi, Ajeti, & Beqiri, 2019)

Me qëllim të promovimit si shtet stabil për tërheqjen e investitorëve të huaj, në Kosovë janë themeluar shumë Agjencione siç janë: Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA); Këshilli Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik (KKZHE); Komisioni Ndërmintor për Investime Strategjike; Këshilli i Investitorëve Evropianë (KIE); Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qëndrore (CEFTA), etj. Megjithatë për shkaqe të pasigurisë ligjore, jostabilitetit politik dhe ekonomik, IHD-të në Kosovë, viteve të fundit kanë shënuar trend rrënës.

Sipas raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, të vitit 2019 (Komisioni Evropian - Raporti mbi Kosovën, 2019, p. 46) Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë, kanë shënuar trend rrënës me 16% në vitin 2018. Hyrja totale e IHD ka qenë 3.3% e PBB-së, duke mbuluar më pak se gjysmën e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Rënia e IHD-ve ka qenë për

shkak të riatdhesimit më të lartë të fitimeve të firmave të huaja për ripagimet e borxhit, të cilat kanë zvogëluar hapësirën për riinvestimin e fitimeve.

Për thithjen e investimeve të huaja direkte, falë përfitimeve të shumta si në aspekt të transferimit të njohurive ose know-how, teknologjisë, rritjes së konkurrencës dhe në përgjithësi të rritjes ekonomike, është e domosdoshmë një kornizë ligjore mirë e konceptuar me qëllim që investitorët e huaj të jenë të sigurtë në mjedisin investues.

Sipas faqes zyrtare të Ministrisë të Integritimit Evropian në Kosovë (Ministria e Integritimit Evropian në Kosovë, 2020) përafrimi i ligjit është obligim unik për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kjo do të thotë se vendet që aspirojnë t'i bashkangjiten Bashkimit Evropian duhet t'i përafrojnë ligjet, rregullat dhe procedurat e tyre kombëtare në mënyrë që të bëjnë efektive të gjithë strukturën ligjore të BE-së, brenda 'acquis communautaire'. Meqë detyrimi i përafrimit vazhdon edhe pas hyrjes, atëherë procesi i përafrimit para aderimit shndërrohet në një mundësi për këto vende që t'i organizojnë më mirë institucionet dhe procedurat e tyre dhe të trajnojnë stafin e tyre për proceset e përditshme dhe përgjegjësitë e bërjes së ligjeve sipas modelit të BE-së, zbatimin dhe implementimin e tyre.

Për këtë shkas edhe Kosova si shtet ka miratuar Ligjin mbi Investimet e Huaja i cili është riformuluar ndër vite nga ana e Kuvendit dhe Parlamentit të Kosovës dhe është bërë publik në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Gjatë procesit të shqyrtimit të literaturës, konkretisht të kornizës ligjore mbi IHD-të, që do të interpretohet në vijim, vlen të theksojmë se ligji mbi IHD-të në rastin e Kosovës nuk është shumë specifik në drejtim të rregullimit të IHD-vë në aspektin ligjor por e konsideroj si gjithëpërfshirës veçanërisht në ligjin e fundit të bërë publik në vitin 2017.

Korniza Ligjore – Ligji për Investimet e Huaja Direkte në Kosovë (Ligji nr.04 / L -220)

Studiues të ndryshëm e interpretojnë dhe komentojnë ligjin mbi Investimet e Huaja Direkte në rastin e Kosovës në mënyra të ndryshme. Sipas autorëve (Levitt & Botts, 2020), Ligji "Për Investimet e Huaja" (Ligji Nr. 04 / L-220) është ligji themelor që kërkon të sigurojë investitorët e huaj se investimet do të mbrohen dhe trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare të pranuar.

Pra, ky ligj, njëherit edhe ligji themelor mbi rregullimin e Investimeve të Huaja Direkte ka

për qëllim të garantojë të gjithë investitorët e huaj për çfarëdo lloj forme investimi se do të jenë të mbrojtur denjësisht mbi baza të praktikave ndërkombëtare.

Konkretisht, ky ligj luan një rol shumë të rëndësishëm edhe në thithjen e IHD-ve me ç'rast siguron investitorët e huaj për trajtim të drejtë dhe për operim të biznesit pa pengesa. Ligji rregullon të gjitha aspektet e investimeve të huaja, duke adresuar mosdiskriminimin, shpronësimin, respektimin e detyrimeve / standardeve dhe ligjeve, dhe, ndër të tjera, mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve.

Bazuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 1 / 09 JANAR 2014, Prishtinë, Ligji nr. 04/L-220 për investimet e huaja (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2014) ky ligj ka për qëllim të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës, t'u ofrojë investitorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore, që u japin siguri investitorëve të huaj që investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë në pajtim me standardet dhe praktikën e pranuar ndërkombëtare.

Në përgjithësi ky ligj paraqitet në 26 nene të veçanta që rregullojnë çështjen e IHD-ve në rastin e Kosovës. Neni i parë trajton në përgjithësi rëndësinë e investimeve të huaja direkte. Neni i dytë i këtij ligji specifikon shprehjet e përdorura në ligj.

Ligji përcakton që investimet e huaja përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në (Ligji 04/L-220, 2014):

- Pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, duke përfshirë të drejta në dhe mbi një pasuri të tillë siç është hipoteka, pengua, garancia, dhënia me qira dhe servituti;
- Prona e paprekshme dhe intelektuale, duke përfshirë të drejtat në pronësinë në fjalë, si dhe vullnetin e mirë, proceset teknike dhe njohuritë;
- Paratë e gatshme, fondet, letrat me vlerë, aksionet apo llojet tjera të interesave pronësore në një shoqëri tregtare të Republikës së Kosovës apo të huaj; obligacionet, dëftesat e borxhit, instrumentet tjera të kredive;
- Kërkesat ose të drejtat në para, të mirat, shërbimet dhe performanca nën kontratë;
- Koncesionet ose licencat e rregulluara me ligj, akt administrativ apo kontratë, dhe
- Fitimin e akumuluar nga një investim në Republikën e Kosovës apo ndonjë investim diku tjetër.

Neni i tretë i këtij ligji parasheh në mes tjerash që ***“Republika e Kosovës do t’ju japë***

investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre trajtim të njëjtë dhe të barabartë me ndonjë investitor vendor dhe investimeve vendore”.

Në këtë kontekst të parashtrimit të ligjit i bie që investitori i huaj do të fitojë status të barabartë me investitorët vendor drejt përfitimit të të gjitha të drejtave; **“Republika e Kosovës u siguron investitorëve të huaj dhe investimeve e tyre mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi”**

Bazuar në këtë pjesë të nenit të tretë të ligjit vlen të thkesojmë se, Kosova granton siguri të plotë për investimet nga investitorë të huaj: **“Republika e Kosovës nuk do të dëmtojë me asnjë veprim apo mosveprim të paarsyeshëm apo diskriminues, veprimtarinë, menaxhimin, mirëmbajtjen, shfrytëzimin, gëzimin apo largimin e një organizate të huaj investuese apo të ndonjë investimi tjetër nga një investitor i huaj në Republikën e Kosovës. Republika e Kosovës nuk ndërhyr me aktivitetet dhe të drejtat e ligjshme dhe me interesat ligjërish të njohura të një investitori të huaj”**

Në bazë të pikës katër të nenit të tretë të Ligjit mbi IHD-të vlen të theksojmë se, Kosova mban qëndrim të paanshëm dhe garanton se në asnjë mënyrë nuk do të diskriminojë veprimtarinë e një organizate të huaj investuese, pra Kosova si shtet nuk ndërhyr me aktivitetet ose të drejtat ligjërish të njohura për investitorin e huaj: **“Çdo autoritet publik që shkel apo në ndonjë mënyrë dështon të respektojë të drejtat dhe garancitë të siguruara me këtë ligj për investitorët e huaj dhe investimet e tyre, do të jenë të detyruar të paguajnë kompensim, në pajtim me nenin 8 paragrafi 2. të këtij ligji për humbjet dhe harxhimet e shkaktuara si pasojë e një shkeljeje apo dështimi të tillë. Asnjë lloj imuniteti ligjor nuk do të shërbejë si mbrojtje për përgjegjësinë e krijuar nga ky nen”.**

Bazuar në këtë nen parashihet masa rigoroze për autoritetet publike që në ndonjë mënyrë dështojnë të respektojnë të drejtat dhe garancitë e siguruara me ligj për investitorët e huaj. Në çdo pikëpamje të parashtrimit të ligjit pretendohet që investitorët e huaj të jenë të mbrojtur nga çdo lloj shkelje e mundshme për të evituar pasigurinë për qëllimet e tyre investuese në shtetin e Kosovës.

Bazuar në nenin 4 të këtij ligji mbi diskriminimin, vlen të thkesohet se Republika e Kosovës e specifikon edhe me ligj që investitorët e huaj do të trajtohen njejtë pavarësisht bazës së shtetësisë, origjinës, vendbanimit, vendit të themelimit të afarizmit ose kontrollit. Poashtu, në

nenin 4 të këtij ligji potencohet se investitorët e huaj dhe investimet e tyre do të jenë në pajtim dhe do të kenë të drejtë dhe obligime me ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, njëlloj sikurse investitorët vendor dhe investimet e tyre.

Neni 5 i këtij ligji parasheh Pajtueshmëria me Detyrimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2014) ku potencohet: *“Republika e Kosovës përmbushë me mirëbesim të gjitha detyrimet që ka ndaj investitorëve të huaj. Kjo dispozitë aplikohet për çdo lloj detyrimi, qoftë i krijuar me ligj, marrëveshje, ose akt tjetër ligjor”*. Siç shihet edhe nga interpretimi i nenit 5 të këtij ligji, Qeveria e Kosovës pretendon që të sigurojë bazë ligjore të mirëfilltë për investitorët e huaj ku vinë në shprehje zbatimi i ligjit për çdo lloj marrëveshje të krijuar.

Korniza Ligjore –Ligji Nr. 05/L - 079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Krahas Ligjit për Investimet e Huaja, Parlamenti i Kosovës ka miratuar Ligjin për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës, konkretisht Ligji Nr. 05 / L-079 i përbërë prej 28 neneve. Qëllimi i këtij ligji është që të tërheq investime strategjike në Republikën e Kosovës duke përcaktuar njëherit procedurat administrative dhe kriteriumet për vlerësim, zgjedhje, implementim dhe monitorim të projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien e përdorimit të pasurisë të Republikës së Kosovës.

Konkretisht, bazuar në Ligjin "Për Investimet Strategjike" (Ligji nr. 05 / L-079), shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës / nr. 6 / 08 shkurt 2017, Prishtinë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2017) përcaktohen kriteret dhe procedurat për marrjen e statusit strategjik, konkretisht investimet në sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror d.m.th. në sektorët vijues: (a) energji, infrastrukturë dhe minierat; (b) transporti dhe telekomunikacioni; (c) turizmi; (d) industria përpunuese; (e) bujqësia dhe industria ushqimore; (f) shëndetësia; (g) parqet industriale dhe teknologjike; dhe (h) ujërat e zeza dhe administrimi i mbeturinave.

Bazuar në këtë ligj, që një investim të konsiderohet investim strategjik, vlerësohet bazuar në kriteriume të tilla si për shembull: sa ndikon në rritjen ekonomike, si do të ndikojë në nivel të normës së punësimeve në vend dhe zbatimin e teknologjive të reja, nëse do të ketë ndikim në rritjen e aftësive konkurruese, nëse do të rritë eksportet, ndikimin drejt përmirësimit të mirëqenies dhe kushteve të jetesës për qytetarët e Kosovës. Sidoqoftë, ligji në fjalë nuk

parashikon asnjë politikë sa i përket rishikimit të investimeve të huaja (përfshirë transaksionet) dhe nuk ka ligje të tilla specifike në Kosovë. Legjislacioni në përgjithësi mund të zbatohet për kontrollin e investimeve të huaja për arsye të sigurisë kombëtare.

Ligji rregullon me nene përkatëse procedurat për vlerësimin, përzgjedhjen dhe realizimin e projekteve strategjike; përgjegjësitë e komisionit ndërmarrës për investime strategjike, agjencisë për investime dhe për përkrahjen e ndërmarrjeve konkretisht marrëveshjen për zbatimin e projektit strategjik, përdorimin e pasurisë së paluajtshme të Kosovës gjatë implementimit të projekteve strategjike, listën e projekteve të përgatitura nga autoritetet publike, transferimin e së drejtës për të përdorur ndërmarrjen në pronësi publike, pronë ndaj subjektit investues dhe dispozitave të tjera të rëndësishme ligjore.

Neni 4 i këtij ligji parasheh: Procedura e paraqitjes së kërkesës për marrjen e statusit investim strategjik dhe lidhjes së marrëveshjes për investime strategjike sipas të cilit: (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2017)

1. Subjekti investues i cili ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për marrjen e statusit investim strategjik mund të jetë investitor i huaj, investitor vendas, autoritet investues publik dhe ndonjë autoritet investues publik në bashkëpunim me ndonjë investitor të huaj apo vendas;
2. Subjekti investues, i cili kërkon të përfshihet në procedurat administrative për investime strategjike, me qëllim të zhvillimit të projektit investues strategjik, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim në Agjencinë për Investime dhe për Përkrahjen e Ndërmarrjeve;
3. Komisioni negocion me subjektin investues lidhjen e marrëveshjes për investime strategjike, pasi që Qeveria e Republikës së Kosovës të ketë aprovuar kërkesën e subjektit investues për dhënien e statusit investim strategjik;
4. Qeveria e Republikës së Kosovës mund t'i ftojë subjektet investuese që të aplikojnë për realizimin e ndonjë projekti strategjik, në rastet kur ajo vlerëson që interesi publik i Republikës së Kosovës për realizimin e investimeve strategjike mund të arrihet përmes procedurave tenderuese të parapara me ligjin përkatës për partneritet publiko rivat dhe ligjin përkatës për prokurimin publik. Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes do të publikohet në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit për prokurim publik;

5. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të hyjë në negociata të drejtpërdrejta me subjektet investuese për lidhjen e Marrëveshjeve për Investime Strategjike pa iu nënshtruar procedurave për marrjen e statusit investime strategjike dhe procedurave të prokurimit publik, nëse një gjë e tillë është paraparë në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe një ose më shumë shteteve tjera apo organizatave ndërkombëtare;
6. Qeveria e Kosovës në bazë të prioriteteve zhvillimore harton një listë projektsh potenciale të investimeve strategjike në pajtim me nenin 2 të këtij ligji, si dhe me një shpallje publike fton investitorët potencial strategjik për realizimin e këtyre projekteve. Në bazë të propozimit të komisionit ndërmintrosor për investime strategjike, qeveria mund të marrë vendim për të hyrë në negociata direkte me investitor të besueshëm strategjik sipas përkufizimit në nenin 3 nënparagrafi 1.3. të këtij ligji që i janë përgjigjur ftesës ose kanë shprehur interesim për të zhvilluar partneritet në zbatimin e projekteve strategjike, duke përfshirë edhe negociata për shfrytëzimin e pronës së Kosovës dhe masat e tjera mbështetëse për realizimin e këtyre projekteve sipas këtij ligji;
7. Të gjitha kërkesat për të marrë statusin e investimit strategjik, thirrjet nga Qeveria, vendimet nga mbledhja e Komisionit dhe vendimet e qeverisë, sipas paragrafëve 1. dhe 3. të këtij neni, publikohen brenda shtatë (7) ditësh në ueb faqen e qeverisë.”

Pra, me nenin 4 të këtij ligji paraqitet mundësia e të qenit investitor strategjik sipas të cilit investitor strategjik mund të jenë në parim edhe investitorët e huaj edhe ata vendas përfshirë këtu edhe autoritetin investues publik dhe ndonjë autoritet investues publik në bashkëpunim me ndonjë investitor të huaj apo vendas. Sipas nenit 4, nën pikën 1 nuk përjashtohen investitorët potencial vendor.

Neni 5, Përmbajtja e kërkesës për marrjen e statusit investim strategjik parasheh: (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2017)

1. Kërkesa nga subjekti investues për marrje të statusit të investimit strategjik duhet të përmbajë informacionet dhe dokumentet vijuese: 1.1. planin e biznesit të investimit, planin financiar të investimit dhe programin e punës për realizimin e investimit strategjik për kohëzgjatjen e kontratës, e cila nuk duhet të jetë më e shkurtë se pesë (5) vjet;

2. Kërkesa e investitorit duhet të përmbajë elemente të cilat veçanërisht duhet të përfshijnë:
 - lokacionin e investimit;
 - raportin e auditimit për entitetin investues për një periudhë të caktuar kohore;
 - profilin e detajuar të entitetit investues duke përfshirë filialet;
 - referenca të mëparshme të përvojës së investitorit në projekte të ngjashme;
 - përshkrimin së si do të financohet projekti;
 - autorizimin me shkrim të entitetit investues që autorizon Agjencinë për Investime dhe Mbështetje të Investimeve që të bëjë të gjitha verifikimet dhe kontrollimet e të dhënave të paraqitura në dosjen e entitetit investues;
 - një pasqyre financiare dhe llogari të humbjeve dhe fitimeve për tri (3) vitet e fundit financiare.
3. Në rast se subjekti investues është themeluar me qëllim të këtij investimi ose kësaj kërkesë, sipas paragrafit 2. të këtij neni, duhet gjithashtu të paraqiten për kompaninë ëmë dhe partneret e sipërmarrjes së përbashkët

Procedurat për marrjen e statusit të investitorit strategjik janë të ndryshme, varësisht prej asaj se kush është iniciatori i projektit. Fillimisht, në përputhje me nenin 4 të ligjit, subjektet që mund të marrin këtë status janë: (1) investitorët e huaj, (2) investitorët e brendshëm, (3) autoritetet investuese publike dhe (4) ndonjë autoritet investues publik në bashkëpunim me ndonjë investitor të huaj apo vendas (“Ligji për Investimet Strategjike”, Neni 4.1). (Oda Ekonomike e Kosovës, 2020)

Neni 16, Shërbimet ndaj investitorit pas marrjes së vendimit për dhënien e statusit investim strategjik;

- ndihmë në procedurat administrative për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve pranë institucioneve publike;

- ndihmë në kryerjen e veprimeve përgatitore, përgatitjen e dokumenteve që nevojiten për fillimin e procedurave administrative për marrjen e licencave, lejeve dhe autorizimeve;

- procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin e kërkesave të cilat ndërlidhen me përgatitjen dhe zbatimin e projektit strategjik;

përkrahje për qasje në infrastrukturë bazike, në përputhje me Ligjin përkatës për ndihmë shtetërore;
 vënie në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjike.

Një sfidë tejet e rëndësishme që është raportuar në vazhdimësi përgjatë viteve është edhe kërkesa e tepërt burokratike dhe mungesa e një kornize adekuate ligjore për t'u ofruar investitorëve të interesuar lehtësira të ndryshme (vëndorë apo ndërkombëtar) (Oda Ekonomike e Kosovës, 2020). Sipas publikimit nga Oda Ekonomike e Kosovës, dilemë tjetër që parashtrohet është edhe ajo se investitorët duhet të ballafaqohen me një numër të madh të institucioneve, dhe ndonjëherë procedurat e tejzgjatura burokratike (siç është marrja e lejeve dhe licencave) bëhen të papërbalueshme.

Ligje të tjera të rëndësishme të ndërlidhura me rregullativat ligjore të IHD-ve në Kosovë

Ligjet mbi Investimet e Huaja Direkte të miratuara nga Qeveria e Kosovës me qëllim të harmonizimit me praktikën ndërkombëtare kanë imponuar nevojën për ligje të tjera shtesë të cilat kanë për qëllim plotësimin e boshllëqeve nga ligjet paraprake.

Ligje të tjera të rëndësishme që lidhen me IHD-të, e që ndërlidhen me investime të huaja direkte në Kosovë janë (Stiftung, 2019):

- Ligji mbi Shoqëritë tregtare, 02 / L-123;
- Ligji për Zonat Ekonomike 03 / L-129;
- Ligji për Arbitrazhin (02 / L-75), 2007;
- Ligji për Dhomën e Tregtisë Nr. 2004/7;
- Ligji për Standardizim (Rregullorja Nr. 2004/12);
- Ligji Nr. 03 / 1008 për Procedurën Përmbartimore;
- Ligji Nr. 05 / L -057 mbi krijimin e Fondit të Garancisë së Kredisë së Kosovës.

Disa nga ligjet e numëruara mbi baza referuese me kalimin e viteve janë shfuqizuar dhe të njëjtat janë plotësuar me ligje të reja me nene përkatëse shtesë që rregullojnë marrëdhënie të caktuara, bazuar edhe në rregullativat e Bashkimit Evropian. Ligjet që aktualisht janë në fuqi dhe që rregullojnë çështjet në fjalë elaborohen në vazhdim.

Ligji Nr. 06/L -016 për shoqëritë tregtare

Ligji Nr. 06/L -016 për shoqëritë tregtare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24, 2018) është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2009/101/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 16 shtator 2009 për bashkërendimin e masave mbrojtëse të cilat kërkohen për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta, nga shtetet anëtare të kompanive në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 48 të Traktatit, me pikëpamjen që këto masa mbrojtëse të bëhen të barasvlefshme.

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i llojeve të shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë ekonomike në Kosovë; subjekteve të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës; organizimit, kompetencave dhe funksioneve të ARBK-së, kërkesave, kushteve dhe procedurave të regjistrimit dhe ç’regjistrimit, për secilin lloj të shoqërive tregtare; organizimit të shoqërive tregtare dhe të drejtave dhe detyrimeve të aksionarëve, përfaqësuesve të autorizuar, pronarëve, drejtorëve, menaxherëve, dhe palëve të treta në lidhje me shoqëritë tregtare.

Ky ligj përfshin në vete 11 kapituj dhe në total 270 Nene.

Bazuar në Nenin 269 të këtij ligji, shfuqizohen ligjet e mëhershme, konkretisht ky ligj shfuqizon Ligjin Nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare dhe ligjin Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare. Neni 17 përcakton se ky ligj hyn në fuqi me datë 15 mars të vitit 2018.

Ligji Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike

Ligji Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 6 / 12, 2013) ka për qëllim themelimin e zonave ekonomike, zonave ekonomike të lira, krijimin e bazës për hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike, vendndodhjen e zonave ekonomike, mënyrën e shfrytëzimit të zonave ekonomike, promovimin e zonave ekonomike, hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike dhe formimin e këshillit kombëtar për zonat ekonomike.

Neni i dytë i këtij ligji përcakton fushëveprimin, konkretisht, me anë të këtij ligji përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesve, përdoruesve/operatorëve dhe të subjekteve të tjera që ushtrojnë aktivitete në lidhje me zonat ekonomike, llojin e veprimtarive që kryhen brenda

zonave ekonomike, mënyrën e lëvizjes së mallrave dhe lehtësirat fiskale të parashikuara në kuadër të tyre.

Me anë të Nenit 11 të këtij ligji, përcaktohen kushtet dhe procedurat për mundësitë e shfrytëzimit të zonës ekonomike. Sipas këtij ligji parashihet se zona ekonomike mund të jepet për shfrytëzim me qëllim të realizimit të investimeve dhe realizimit të veprimtarisë afariste. Subjektet ekonomike që dëshirojnë të ushtrojnë veprimtari mbrenda zonës ekonomike lejohen mirëpo paraprakisht aplikohet në konkurs duke marrë në konsideratë kushtet dhe kriteriumet e përcaktuara dhe rregulluara me akte nënligjore nga ana e ministrisë.

Bazuar në aktet nënligjore, përcaktohet procedura, forma e konkursit dhe përmbajtja të cilën e përcakton ministria. Pasi që bëhet përzgjedhja e subjektit afarist vijohet me procedurën e lidhjes së kontratës për shfrytëzimin e zonës ekonomike. Normalisht që në bazë të kontratës përcaktohet lloji i investimit, vëllimi i investimit, lloji i veprimtarisë afariste brenda zonës ekonomike. Me lidhjen e kontratës, shfrytëzuesi fiton të drejtën e shfrytëzimit të sipërfaqes tokësore brenda zonës ekonomike të përcaktuar me leje dhe të infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e veprimtarisë afariste. E drejta e shfrytëzimit të sipërfaqes tokësore brenda zonës ekonomike nuk mund të jetë më e gjatë se nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

Shfrytëzuesit e zonës ekonomike kanë për detyrë të kryejnë investime dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre afariste në pajtim me ligjin dhe kontratën e lidhur me themeluesin sipas këtij ligji. E drejta e shfrytëzimit brenda zonës ekonomike nuk mund t'i bartet ndonjë personi të tretë pa pëlqimin e themeluesit ose në rast të mbikëqyrjes së zonës ekonomike përmes partneritetit publiko - privat, të personit të autorizuar për ndërtimin dhe mbikëqyrjen e zonës ekonomike. E drejta e shfrytëzimit të sipërfaqes tokësore brenda zonës ekonomike shuhet me rastin e skadimit apo shkëputjes së kontratës për shfrytëzimin e zonës ekonomike. Ligji nr. 04/L-159 për zonat ekonomike, shfuqizon ligjin për zonat ekonomike 03 / L-129.

Ligji për Arbitrazhin

Kuvendi i Kosovës, në mbështetje të kreut 5.1 (ç) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 datë 15 maj 2001) dhe me qëllim të rregullimit të lëndës së arbitrazhit dhe të ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit të nxjerra brenda dhe jashtë Kosovës, në pajtim me standardet bashkëkohore Evropiane dhe ndërkombëtare, ka miratuar Ligjin nr. 02/L-75 - Ligjin për Arbitrazhin

(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 37 , 2008)

Neni 1 i këtij ligji, përcakton fushëveprimin e ligjit, konkretisht parasheh rregullat që zbatohen për marrëveshjet e arbitrazhit, procedurat e arbitrazhit si dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të nxjerra brenda dhe jashtë Kosovës.

Ligji për Standardizim (Rregullorja Nr. 2004/12)

Ligji për standardizim me Nenin 1 përcakton qëllimin, konkretisht, me këtë ligj përcaktohen rregullat dhe parimet për zhvillimin e aktiviteteve të standardizimit në Republikën e Kosovës, si dhe organizimi dhe funksionimi i Agjencisë Kosovare të Standardizimit. Ky ligj transponon pjesërisht Rregulloren (BE) 1025/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 25 tetor 2012, e cila përcakton kërkesat për standardizim. (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 , 2018).

Me anë të Nenit 3 të këtij ligji emërohet Agjencia Kosovare e Standardizimit, si një organ i vetëm i administratës shtetërore për standardizim në Kosovë, e cila është organ i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Në nenin 7 të këtij ligji, parashihen funksionet dhe përgjegjësitë që bart Agjencia Kosovare e Standardizimit. Me konkretisht ky Nen parasheh:

- miratimin dhe mirëmbajtjen e standardeve kosovare dhe përditësimin e katalogut të standardeve;
- shqyrtimin, mirëmbajtjen dhe konfirmimin periodik të statusit të standardeve kosovare në përputhje me rregullat dhe procedurat e standardizimit të miratuara nga AKS;
- zhvillimin dhe miratimin e rregullave dhe procedurave mbi aktivitetet e standardizimit, në përputhje me parimet dhe rregullat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit;
- përgatitjen, miratimin dhe publikimin e programit të punës për standardizim në përputhje me interesin e palëve;
- hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin, ndryshimin, shfuqizimin dhe publikimin e standardeve kosovare dhe dokumenteve kosovare të standardizimit në përputhje me parimet dhe rregullat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit;
- administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të standardeve;
- administrimin dhe mirëmbajtjen e arkivit për standardet kosovare, evropiane dhe

ndërkombëtare, si dhe shitjen e tyre në përputhje me ligjet, rregullat dhe politikat e zbatueshme të marrëveshjeve me organet e standardizimit;

- ofrimin e shërbimeve të informimit për standardet dhe procedurat e standardizimit për subjektet afariste që kryejnë aktivitet ekonomik brenda dhe jashtë vendit;
- të vepruarit si pikë referimi për çështjet e ndërlidhura me standardizimin që rezultojnë nga marrëveshjet me organizatat evropiane dhe ndërkombëtare në lidhje me barrierat teknike në tregti dhe kodin e praktikës së mirë për hartimin, miratimin dhe publikimin e standardeve;
- shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin në fushën e standardizimit me organet e huaja nacionale të standardizimit;
- organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve tjera të ndërlidhura me standardizimin;
- publikimin e buletinit dhe katalogut vjetor me standardet kosovare; dhe
- iniciimin e studimeve, publikimeve, përvojës, punës kërkimore dhe aktivitete të tjera që kanë lidhje me standardizimin.

Kurse më anë të Nenit 8 të këtij ligji, rregullohet përfaqësimi konkretisht AKS, si organ i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë përfaqëson Republikën e Kosovës në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit: CEN; CENELEC; ETSI dhe ISO; IEC; ITU, si dhe në organizatat tjera që kanë të bëjnë me standardet. AKS, është autoritet shtetëror i Notifikimit dhe Pikë e Referimit në OBT për standarde ashtu siç kërkohet me marrëveshjet relevante ndërkombëtare. AKS, mund të ofrojë shërbime tjera plotësuese për të përkrahur përdorimin dhe zbatimin e standardeve. Këto shërbime përfshijnë trajnime, informacione dhe certifikime.

Ligji Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore

Ligji Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 3, 31.01.2013). (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 15, 2017)

Neni 19 i këtij ligji parasheh plotësimin e Nenit 155 (Sekuestrimi dhe përmbartimi në llogarinë bankare përmes Regjistrimit të llogarive bankare) të ligjit bazik, konkretisht riformulohet me tekstin vijues (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 15, 2017, p. 61):

1. Organi përmbarues përmes sistemit elektronik të Regjistrisë të Llogarive Bankare ia dorëzon bankave komerciale aktvendimin apo urdhërin për përmbarim në llogari bankare;
2. Bankat komerciale obligohen të bëjnë bllokimin e llogarive bankare të debitorit brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) minutash prej momentit të pranimit të aktvendimit apo urdhërit për përmbarim;
3. Organi përmbarues dërgon urdhërin për transfer të mjeteve brenda njëzet e katër (24) orësh, pas pranimit të njoftimit nga bankat për bllokimin e llogarisë;
4. Në rastet kur banka bën bllokimin e llogarisë bankare të debitorit, me këtë parandalon çdo tërheqje të fondeve, për çfarëdo qëllimi apo në çfarëdo forme, përveç rasteve kur banka e ka radhën e përparësisë ndaj fondeve në llogari, derisa banka të ketë përmbushur shumën e cekur në vendimin e organit përmbarues ose derisa të tërhiqet urdhëri i organit përmbarues;
5. Organi përmbarues përmes njoftimit të sistemit elektronik të Regjistrisë të Llogarive Bankare e njofton bankën për lirimin e llogarive të debitorit pas pagesës së plotë të kredisë ose pas përfundimit të procesit të përmbarimit, brenda afatit prej njëqind e njëzet (120) minutash prej momentit kur njoftohet se është bërë pagesa e kredisë;
6. Banka obligohet që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) minutash të lirojë llogaritë e bllokuara të debitorit pas marrjes së njoftimit sipas paragrafit 5. të këtij neni;
7. Më kërkesën e organit përmbarues, banka është e obliguar që të ofrojë sqarime dhe dokumente që dëshmojnë se ajo ka respektuar vendimin për transfer dhe të gjitha vendimet e tjera të organit përmbarues;
8. Nëse ekzistojnë rrethanat që e bëjnë të pamundur dërgimin e urdhërit për përmbarim apo njoftimeve përmes sistemit elektronik të regjistrisë të llogarive bankare tek banka, atëherë organi përmbarues mund të dërgojë urdhërin për përmbarim apo njoftimet sipas formave tjera që e bëjnë të mundur dërgimin e tyre.

Ligji nr. 05/l-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

Ligji nr. 05/l-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore krijohet për të ndihmuar në përmbushjen e nevojës për rritje të qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjen e prodhimit

vendor dhe shërbimet me vlerë të shtuar, përmirësimin të bilancit tregtar dhe për të zgjeruar mundësitë e financimit për NMVM-të. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ofron garanci kreditore për Institucionet e Regjistruara Financiare për kredi të caktuara të NMVM-ve. FKGK do të mund të ofrojë shërbime të tjera financiare me aprovimin paraprak të Bordit të Drejtorëve dhe BQK-së. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 , 2016)

Bazuar në Nenin 3 të këtij ligji, parashihet Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) – si një entitet juridik i pavarur dhe autonom, i krijuar me këtë Ligj për të menaxhuar asetet e FKGK dhe për të ofruar Garanci Kreditore sipas dispozitave të këtij Ligji dhe Statutit dhe Politikave të Procedurave të Brendshme.

Neni 5 i këtij ligji, parasheh parimet e garancive kreditore numëruar (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 , 2016, p. 4):

1. FKGK-ja mund të lëshojë Garanci Kreditore apo produkte dhe shërbime të tjera të miratuara në përputhje me këtë Ligj dhe me aprovim të Bordit të Drejtorëve siç përcaktohet në nenin 17 të këtij Ligji. Çdo produkt apo shërbim i ri i nënshtrohet dispozitave të Nenit 9 të këtij Ligji, duke përfshirë edhe aprovimin nga BQK;
2. Institucionet Financiare të licencuara dhe mbikqyrura nga BQK-ja mund të aplikojnë për regjistrim në FKGK, dhe FKGK, dhe do të vlerësojnë institucionet financiare bazuar në metodologjinë e BQK-së për vlerësimin e rrezikut, faktorët e tjerë institucional dhe riskun e portfolios kreditore;
3. FKGK-ja regjistron institucionet financiare dhe hyn në Marrëveshje Garancie me secilin institucion të regjistruar, duke specifikuar mbulimin, kufizimet, politikave dhe procedurat në fuqi për garantimin e kredive, duke i paguar provizionet për FKGK-në dhe për institucionet e regjistruara financiare që parashtrajnë kërkesë tek FKGK-ja;
4. FKGK-ja mund të ofrojë garanci kreditore për institucionet financiare të regjistruara në FKGK, dhe që përmbushin kriteret e kërkesat e Marrëveshjes së Garancisë;
5. FKGK-ja duhet të miratojë paraprakisht ristrukturimin, riafatizimin apo negocimin e të gjitha kredive që futen nën garancinë kreditore;
6. Kur të ndodh Rasti i Garantuar, FKGK-ja i paguan institucionit të

regjistruar financiar shumën e pagueshme, pasi që institucioni financiar i regjistruar parashtron kërkesën e vlefshme dhe të dokumentuar, si dhe FKGG-ja vërteton dhe miraton atë Kërkesë. Çdo arkëtim i mëtutjeshëm i kyegjëses së kredisë nga institucioni i regjistruar financiar do të ndahet me FKGG bazuar në Përqindjen e Garancisë.

Të gjitha ligjet e lartëcekura burojnë nga strategjia qeveritare me qëllim të plotësimit të boshllëqeve që kanë ekzistuar në ligje. Me qëllim që kuadri ligjor në Kosovë mbi Investimet e Huaja Direkte të jetë i plotë në kuptim të harmonizimit me praktikat ndërkombëtare është imponuar nevoja dhe domosdoshmëria e ligjeve plotësuese për të rregulluar mbarëvajtjen e IHD-ve. Për sa i përket procedurave në lidhje me zbatimin e kontratave meret për bazë Ligji për Procedurën Kontestimore si edhe Ligji për Ekzekutim.

3.5. Legjislacioni i Bashkimit Evropian mbi Investimet e Huaja Direkte

Hyrje

Bashkimi Evropian (BE) numëron 28 shtete anëtare me një popullatë prej afro 500 milion njerëzish. Marrë në konsideratë numrin e shteteve përbërëse të Bashkimit Evropian, rëndësia e investimeve të huaja është shumë domethënëse. Investimet e Huaja Direkte në kaudër të shteteve nëtare të BE-së kanë një treg të gjërë dhe mundësi të shumta përzgjedhjeje për të investuar. Shtetet anëtare të BE-së përfitojnë nga antarësimi i tyre në shumë aspekte përfshirë këtu edhe kornizën ligjore për investime të huaja direkte miratuar nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian. Shtetet e tyre anëtare përfitojnë nga ligjet në të gjithë BE-në, disa prej të cilave janë si më poshtë (STA LAW Firm, 2019)

Traktatet diskutohen dhe bien dakord nga vendet anëtare të BE-së, dhe pasi të formohet Traktati, ai duhet të ratifikohet nga secili shtet anëtar në legjislacionin e tyre. Rregulloret janë krijuar nga BE, megjithëse ato duhet të futen brenda secilit shtet individualisht duke përdorur proceset e tyre përkatëse. BE ofron direktiva dhe u jep shteteve qëllime specifike, megjithëse ato mund të arrihen në çdo mënyrë që anëtarët e konsiderojnë të përshtatshme.

Vendimet nga GJED (Gjykata Evropiane e Drejtësisë) janë gjithashtu të detyrueshme për çështjet e lidhura me të ardhmen, pasi vendimet gjyqësore në përgjithësi trajtohen në juridiksione të ligjit të përbashkët.

Duke qenë një burim i rëndësishëm i rritjes, vendeve të punës dhe inovacionit, investimet e huaja direkte kanë qenë gjithmonë thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Bashkimit Evropian duke sjellë njëherit përfitime të konsiderueshme për Unionin dhe qytetarët e tij, duke mbështetur objektivat e Planit të Investimeve të Komisionit për Evropën dhe duke kontribuar në projekte dhe programe të tjera të Unionit. Kjo është arsyeja pse BE mban një mjedis të hapur investimesh dhe mirëpret investimet e huaja. (Komisioni Evropian, 2017).

Investimet e Huaja Direkte në përgjithësi marrin forma të ndryshme të investimeve që janë të rregulluara me rregullore, ligje dhe nene përkatëse. Investimet e Huaja Direkte mund të marrin formën e bashkimeve, blerjeve ose sipërmarrjeve të përbashkëta që përbëjnë përqëndrime të përfshira në fushën e Rregullores së Bashkimit Evropian (EUR-Lex, 2004)

Rrregullativa ligjore e IHD-ve në BE

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian iu përmbahen rrregullativave ligjore që burojnë nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian, megjithatë çdo shtet anëtar ka të drejtën legjitime për të ndërmarrë veprime të caktuara në kuadër të mbrojtjes dhe rendit publik, njashu edhe për Investimet e Huaja Direkte. Më 13 Shtator 2017, duke u mbështetur në nismat e mëparshme, Komisioni ka propozuar një rregullore që krijon një kornizë për ekzaminimin e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Bashkimin Evropian (Komisioni Evropian, 2019)

Më 21 Mars 2019, Rregullorja (BE) 2019/452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 Mars 2019, për krijimin e një kornize për shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte në Union ("Rregullorja e FDI") u botua në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Rregullorja e IHD-ve hyn në fuqi më 10 prill 2019 dhe zbatohet për transaksionet nga 11 tetori 2020. Siç shpjegohet në mënyrë më të detajuar më poshtë, çdo transaksion që nuk po i nënshtrohet shqyrtimit në BE dhe që përfundon në ose pas 11 korrikut 2019, në parim mund të komentohet akoma nga shtetet anëtare ose të jetë objekt i mendimit të Komisionit Evropian ("Komisioni ") kur Rregullorja e IHD-ve bëhet e zbatueshme (më 11 tetor 2020). (Jones Day White Paper, 2019)

Rregullorja e IHD-ve paraqet një evolucion themelor! Është hera e parë që kontrollimi i investimeve të huaja direkte (IHD) rregullohet në nivelin e Bashkimit Evropian (BE). Kjo rregullore ndikon ndjeshëm tek ata investitorë nga vendet e treta që pretendojnë të investojnë

në BE. Bazuar në rregullativën e BE-së 2019/452 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian (Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, 2019), Investimet e Huaja Direkte, kontribuojnë në rritjen e Unionit duke rritur konkurrencën e tij, duke krijuar vende pune dhe ekonomi, duke sjellë kapital, teknologji, risi, ekspertizë dhe duke hapur tregje të reja për eksportet e unionit. Ajo mbështet objektivat e planit të investimeve për Evropën dhe kontribuon në projekte dhe programe të tjera të Bashkimit Evropian.

Poashtu Neni 3 (5) i Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU) specifikon që BE, në marrëdhëniet e tij me botën më të gjerë, do të mbështesë dhe promovojë vlerat dhe interesat e tij dhe do të kontribuojë në mbrojtjen e qytetarëve të saj. Për më tepër, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë një mjedis të hapur investimesh, i cili është i parashikuar në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe të ngulitur në angazhimet ndërkombëtare të BE-së dhe shteteve anëtare të tij në lidhje me IHD-të.

Në bazë të angazhimeve ndërkombëtare të ndërmarra në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, si dhe në marrëveshjet e tregtisë dhe investimeve të lidhura me vendet e treta, është e mundur që bashkimi dhe shtetet anëtare të miratojnë masa kufizuese në lidhje me Investimet e Huaja Direkte për shkak të sigurisë ose rendit publik, duke iu nënshtruar kërkesave të caktuara. Kuadri i krijuar nga kjo rregullore ka të bëjë me investimet e huaja direkte në Bashkimin Evropian. Investimet e jashtme dhe hyrja në tregjet e vendeve të treta trajtohen nën instrumentet e tjera të politikës së tregtisë dhe investimeve.

Rregullorja e tij nuk cenon të drejtën e shteteve anëtare për të hequr dorë nga lëvizja e lirë e kapitalit siç parashikohet në pikën (b) të nenit 65 (1) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Disa shtete anëtare kanë vendosur masa sipas të cilave ata mund të kufizojnë lëvizjen e tillë për shkak të politikave publike ose sigurisë publike.

Këto masa pasqyrojnë objektivat dhe shqetësimet e shteteve anëtare në lidhje me investimet e huaja direkte, dhe mund të rezultojnë në një numër mekanizmesh që janë të ndryshëm për sa i përket fushëveprimit dhe procedurës. Shtetet anëtare që dëshirojnë të krijojnë mekanizma të tillë në të ardhmen mund të marrin parasysh funksionimin, përvojat dhe praktikatat më të mira të mekanizmave ekzistues. Aktualisht nuk ka një kornizë gjithëpërfshirëse në nivelin e Bashkimit Evropian për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte për shkak të sigurisë ose

rendit publik, ndërsa partnerët kryesorë tregtarë të Unionit kanë zhvilluar tashmë korniza të tilla. Investimet e Huaja Direkte janë në fushën e politikës së përbashkët tregtare.

Kjo kornizë ligjore ka në total 17 Nene, me anë të të cilave rregullohen investimet e Huaja Direkte në kuadër të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Në përputhje me pikën (e) të nenit 3 (1), Bashkimi Evropian ka kompetencë ekskluzive në lidhje me politikën e përbashkët tregtare. Është e rëndësishme të sigurohet siguri juridike për mekanizmat e shqyrtimit të shteteve anëtare mbi bazën e sigurisë dhe rendit publik, dhe të sigurohet koordinim dhe bashkëpunim i gjerë i BE-së në shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte që mund të ndikojnë në sigurinë ose rendin publik. Kjo kornizë e përbashkët nuk cenon përgjegjësinë e shteteve anëtare për ruajtjen e sigurisë së tyre kombëtare, siç parashikohet në nenin 4 (2) të Traktatit për Bashkimin Evropian.

Kuadri për kontrollimin e investimeve të huaja direkte dhe për bashkëpunim duhet t'u sigurojë shteteve anëtare dhe komisionit mjete për të adresuar rreziqet ndaj sigurisë ose rendit publik në një mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe për t'u përshtatur me rrethanat në ndryshim, duke ruajtur fleksibilitetin e nevojshëm për shtetet anëtare për të kontrolluar Investimet e Huaja Direkte për shkak të sigurisë dhe rendit publik, duke marrë parasysh situatat e tyre individuale dhe specifikat kombëtare. Vendimi për të krijuar një mekanizëm shqyrtimi ose për të ekzaminuar një investim të veçantë të huaj, të drejtpërdrejtë, mbetet përgjegjësia e vetme e shtetit anëtar në fjalë.

Një gamë e gjerë e investimeve që krijojnë ose mbajnë lidhje të qëndrueshme dhe të drejtpërdrejta midis investitorëve nga vendet e treta, përfshirë entitetet shtetërore, dhe ndërmarrjet që kryejnë një aktivitet ekonomik në një shtet anëtar duhet të mbulojnë nga kjo rregullore. Sidoqoftë, nuk duhet të mbulojë investimet e portofolit.

Shtetet anëtare që kanë një mekanizëm shqyrtimi duhet të parashikojnë masat e nevojshme, në përputhje me ligjin e Unionit, për të parandaluar anashkalimin e mekanizmave të tyre të shqyrtimit dhe vendimet e shqyrtimit. Kjo duhet të mbulojë investimet brenda Bashkimit me anë të marrëveshjeve artificiale që nuk pasqyrojnë realitetin ekonomik dhe anashkalojnë mekanizmat e shqyrtimit dhe vendimet e shqyrtimit, ku investitori është në pronësi të fundit ose kontrollohet nga një person fizik ose një ndërmarrje e një vendi të tretë. Kjo nuk cenon lirinë e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të kapitalit të vendosur në Traktatin për Funkcionimin e

Bashkimit Evropian

Me Nenin 1 të kësaj rregulloreje, krijohet një kornizë për shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në prizmin e sigurisë ose rendit publik dhe për një mekanizëm për bashkëpunim midis shteteve anëtare, dhe komisionit, konkretisht sipas këtij neni, nuk çënohet e drejta e çdo shteti anëtar për të ruajtur sigurinë e tij kombëtare dhe për të mbrojtur interesat kryesore të sigurisë së vendit.

Pra, më këtë ligj ju jepet e drejta shteteve anëtare, të kontrollojnë investimet e huaja me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike të vetë shtetit.

Në Nenin 2 të këtij ligji, paraqiten përkufizimet e nocioneve kryesore përfshirë 'Investim i Drejtpërdrejtë i Huaj' sipas të cilit nënkupton një investim të çdo lloji nga një investitor i huaj që synon të krijojë ose të ruajë lidhje të qëndrueshme dhe të drejtpërdrejta midis investitorit të huaj dhe sipërmarrësit, të cilit ose ndërmarrja për të cilën kapitali është në dispozicion për të kryer një veprimtaria ekonomike në një shtet snëtar, përfshirë investimet që mundësojnë pjesëmarrje efektive në administrimin ose kontrollin e një kompanie që kryen një veprimtari ekonomike; në mes të tjerave potencohet edhe termi "Investitor i huaj" sipas të cilit nënkupton një person fizik i një vendi të tretë ose i një ndërmarrjeje të një vendi të tretë, që synon të bëjë ose të ketë bërë një investim të huaj të drejtpërdrejtë. Poashtu parashihen termet screening dhe mekanizëm shqyrtimi që përfshinë në vete procedurat për vlerësim dhe instrumentet e aplikimit të përgjithshëm numëruar këtu rregullore, kërkesa administrative; regulla zbatimi ose udhëzime.

Më tej interpretohet Neni 3, konkretisht në detaje përshkruhen mekanizmat e shqyrtimit të shteteve anëtare, rregullat dhe procedurat që lidhen me mekanizmat e shqyrtimit, përfshirë afatet kohore përkatëse, rëndësinë e transparencës dhe jo diskriminimin midis vendeve të treta. Më tej me nene përkatëse rregullohen faktorët që mund të merren në konsideratë nga shtetet anëtare ose komisioni për të përcaktuar nëse një investim i huaj i drejtpërdrejtë ka të ngjarë të ndikojë në sigurinë ose rendin publik. Shtetet anëtare dhe komisioni mund të marrin parasysh efektet e tij të mundshme, ndër të tjera:

- infrastruktura kritike, qoftë fizike apo virtuale, përfshirë energjinë, transportin, ujin, shëndetin, komunikimet, media, përpunimin ose ruajtjen e të dhënave, hapësirën ajrore, mbrojtëse, elektorale ose financiare, dhe lehtësirat e

ndjeshme, si dhe tokën dhe pasuritë e paluajtshme vendimtare për përdorim të një infrastrukture të tillë;

- teknologjitë kritike dhe artikujt e përdorimit të dyfishtë siç përcaktohen në pikën 1 të nenit 2 të Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 428/2009 (15), përfshirë inteligjencën artificiale, robotikën, gjysmëpërçuesit, sigurinë në internet, hapësirën e hapësirës ajrore, mbrojtjen, ruajtjen e energjisë, kuantitetin dhe teknologjitë bërthamore si si dhe nanoteknologjitë dhe bioteknologjitë;
- furnizimi i inputeve kritike, përfshirë energjinë ose lëndët e para, si dhe sigurinë ushqimore;
- qasje në informacione të ndjeshme, përfshirë të dhënat personale, ose aftësinë për të kontrolluar informacionin e tillë; ose
- liria dhe pluralizmi i mediave.

Për të përcaktuar nëse një investim i huaj i drejtpërdrejtë ka të ngjarë të ndikojë në sigurinë ose rendin publik, shtetet anëtare dhe komisioni gjithashtu mund të marrin parasysh, veçanërisht:

- nëse investitori i huaj kontrollohet drejtpërdrejtë ose indirekt nga qeveria, përfshirë organet shtetërore ose forcat e armatosura, të një vendi të tretë, përfshirë strukturën e pronësisë ose fondet e rëndësishme;
- nëse investitori i huaj tashmë është përfshirë në aktivitete që prekin sigurinë ose rendin publik në një Shtet Anëtar; ose
- nëse ekziston një rrezik serioz që investitori i huaj të përfshihet në veprimtari të paligjshme ose kriminale.

Me Nenin 5 të këtij ligji, është i rregulluar procesi i raportimit vjetor sipas të cilit:

- Deri më 31 mars të çdo viti, shtetet anëtare duhet t'i paraqesin komisionit një raport vjetor që përfshin vitin paraprak kalendarik, i cili përfshin informacionin e grumbulluar për investimet e huaja direkte që ndodhen në territorin e tyre, mbi bazën e informacionit në dispozicion të tyre, si dhe informacionin e grumbulluar për kërkesat e marra nga shtetet e tjera anëtare, në përputhje me nenet 6 (6) dhe 7 (5);
- Për secilën periudhë raportimi, shtetet anëtare që mbajnë mekanizmat e kontrollit, përveç informacionit të përmendur në paragrafin 1, japin

informacion të grumbulluar për zbatimin e mekanizmave të tyre të shqyrtimit

- Komisioni do t'i sigurojë Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport vjetor për zbatimin e kësaj rregulloreje. Ky raport do të bëhet publik.
- Parlamenti Evropian mund të ftojë komisionin në një mbledhje të komitetit të tij përgjegjës për të paraqitur dhe shpjeguar çështje sistemike në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 6 i këtij ligji parasheh, mekanizmin e bashkëpunimit në lidhje me investimet e huaja direkte që i nënshtrohen shqyrtimit konkretisht:

- Shtetet anëtare njoftojnë komisionin dhe shtetet e tjera anëtare për çdo investim të huaj të drejtpërdrejtë në territorin e tyre që është duke kaluar shqyrtimin duke siguruar informacionin e përmendur në nenin 9 (2) të kësaj rregulloreje sa më shpejt të jetë e mundur.
- Kur një shtet anëtar konsideron se një investim i huaj i drejtpërdrejtë që i nënshtrohet shqyrtimit në një shtet tjetër anëtar ka të ngjarë të ndikojë në sigurinë e tij ose në rendin publik, ose të ketë informacione të rëndësishme për një ekzaminim të tillë, ai mund të sigurojë komente për shtetin anëtar që ka ndërmarrë shqyrtimin.
- Komisioni do të njoftojë shtetet e tjera anëtare që komentet janë dhënë.
- Kur komisioni konsideron se një investim i huaj i drejtpërdrejtë që i nënshtrohet shqyrtimit ka të ngjarë të ndikojë në sigurinë ose rendin publik në më shumë se një shtet anëtar, ose ka informacione përkatëse në lidhje me atë investim të huaj të drejtpërdrejtë, ai mund të lëshojë një mendim drejtuar shtetit anëtar, shqyrtim dhe të tjera.

Në Nenin 7 të këtij ligji, parashihet mekanizmi i bashkëpunimit në lidhje me Investimet e Huaja Direkte që nuk i nënshtrohen shqyrtimit.

Sipas Neni 8, Investimet e Huaja Direkte ka të ngjarë të ndikojnë në projekte ose programe me interes të Unionit

Neni 9 përfshin kërkesat e informacionit, strukturën e pronësisë së investitorit të huaj dhe të ndërmarrjes në të cilën është planifikuar ose ka përfunduar investimi i huaj i drejtpërdrejtë, përfshirë informacionin për investitorin përfundimtar dhe pjesëmarrjen në kapital; vlerën e

përafërt të investimit të huaj të drejtpërdrejtë; produktet, shërbimet dhe operacionet e biznesit të investitorit të huaj dhe të ndërmarrjes në të cilën është planifikuar ose ka përfunduar investimi i huaj direkt; Shtetet anëtare në të cilat investitori i huaj dhe ndërmarrja në të cilën është planifikuar ose ka përfunduar investimi i huaj i drejtpërdrejtë kryejnë operacione përkatëse afariste; financimi i investimit dhe burimi i tij, në bazë të informacionit më të mirë të disponueshëm për shtetin anëtar; data kur investimi i huaj direkt planifikohet të përfundojë ose të ketë përfunduar.

Me anë të Nenit 10, parashihet konfidencialiteti i informacionit të transmetuar duke përfshirë në mes të tjerave atë se shtetet anëtare dhe komisioni sigurojnë mbrojtjen e informacionit konfidencial të fituar në zbatim të kësaj rregulloreje në përputhje me Bashkimin Evropian dhe ligjin përkatës kombëtar dhe njashtu shtetet anëtare dhe komisioni sigurojnë që informacioni i klasifikuar i siguar ose i shkëmbyer sipas kësaj rregulloreje nuk është zvogëluar ose deklasifikuar pa pëlqimin paraprak me shkrim të krijuesit.

Neni 11 parasheh pikat e kontaktit dhe sipas tij shtetet anëtare e krijojnë një pikë të caktuar kontakti dhe e njejta më tej shfrytëzohet për të gjitha çështjet e rëndësishme që i paraprijnë rregullores në fjalë.

Neni 12 parasheh një grup ekspertësh për ekzaminimin e Investimeve të Huaja Direkte në Bashkimin Evropian. Ky grup meret me shqyrtimin e IHD-ve në BE duke ofruar këshilla dhe ekspertizë për komisionin, të njejtit diskutojnë çështje që lidhen me shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte, shkëmbehet informacion mbi praktikatat më të mira dhe mësimet e marra dhe njashtu shkëmbejnë mendime mbi tendencat dhe çështjet me shqetësim të përbashkët në lidhje me investimet e huaja direkte. Komisioni gjithashtu shqyrton kërkimin e këshillave të këtij grupi për çështje sistemike në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Bazuar në Nenin 13 të kësaj rregulloreje, parashihet bashkëpunimi ndërkombëtar ku shtetet anëtare dhe komisioni mund të bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse të vendeve të treta për çështje që lidhen me kontrollimin e investimeve të huaja direkte, për shkak të sigurisë dhe rendit publik.

Neni 14 parasheh përpunimin e të dhënave personale që zbatohen me rregulloren në fjalë, vetëm për atë që është e nevojshme për kontrollimin e Investimeve të Huaja Direkte nga shtetet anëtare për të siguruar efektivitetin e bashkëpunimit të parashikuar në këtë

rregullore. Të dhënat personale që lidhen me zbatimin e kësaj rregulloreje mbahen vetëm për kohën e nevojshme për të arritur qëllimet për të cilat janë mbledhur.

Neni 15 parasheh vlerësimin, konkretisht nga data 12 tetor të vitit 2023 dhe çdo pesë vjet pas kësaj, komisioni vlerëson funksionimin dhe efektivitetin e kësaj rregulloreje dhe paraqet një raport në Parlamentin Evropian dhe Këshillin.

Neni 16 parasheh ushtrimin e delegacionit ku fuqia për të miratuar akte të deleguara i jepet komisionit, në varësi të kushteve të përcaktuara në këtë nen.

Neni 17 parasheh hyrjen në fuqi të rregullores. Kjo rregullore ka hyrë në fuqi në ditën e njëzetë pas botimit të saj në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian. Konkretisht zbatohet nga 11 tetori 2020.

KAPITULLI IV

BAZA LEGJISLATIVE QË SIGURON DHE GARANTON INVESTIMIN E KAPITALIT TË HUAJ

Hyrje

Domosdoshmëri për vendet në zhvillim dhe ato të pazhvilluara janë investimet e kapitalit të huaj. Andaj, për mbrojtjen e tyre (investimeve) në kuadër të çdo shteti, ekzistojnë dispozitat me të cilat janë të rregulluara investimet e jashtme, ku zakonisht janë të përfshira në dispozita të veçanta në “Ligje për investime ose kodekse”. Dispozitat mund të jenë në ligje të përgjithshme (për investimet e jashtme) ose të veçanta (më të cilat rregullohen investime në sektorë të ndryshëm si: turizëm, infrastrukturë, bujqësi etj). Pra, qëllim kryesor i ligjit, si atij të përgjithshëm dhe atij të veçantë, është qasja e rregullimit dhe krijimit të klimës stimuluese përkatëse juridike për tërheqjen e investimeve të huaja nga shtetet e zhvilluara (Mehdi, 2005)

Investimet nga jashtë, në një shtet të caktuar, mund të realizohen atëherë kur ndër të tjera, në shtetin pritës ekziston legjislacioni i volitshëm për investime të jashtme me gjyqësorin efikas dhe sigurinë juridike efikase në përgjithësi (Riza, 2007)

Shtetet, të cilat kanë një sistem ligjor tregtar, modern dhe efikas, përmes së cilës mbrohen interesat e bizneseve, janë më atraktive dhe të sigurta për investitorët. Prandaj, legjislacioni i vendit pritës duhet të jetë stimulues për investitorët, pasi është një përbërës thelbësor në

zhvillimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e ekonomisë së shëndoshë, përmes së cilës atyre ju mundësohet të përdorin lirinë ekonomike me qëllim të arritjes së kontributit të përbashkët.

Në kohën e sotme pothuajse pjesa më e madhe e ekonomive botërore janë të hapura ndaj konceptit të globalizimit, që nënkupton lirinë e qarkullimit të ideve dhe kapitaleve ekonomike nga një shtet në tjetrin, e si përfaqësuese të rrymave të tilla janë investitorët e ndryshëm, (Bajrami, Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, 2012)

Roli i Investimeve të Huaja Direkte, është rritur goxha shumë gjatë dekadës së kaluar si një burim i kapitalit, menaxhimit, dhe të teknologjisë për botën në zhvillim dhe ekonomitë në tranzicion. Megjithatë, analiza e politikës ndaj investimeve të tilla për vendet pritëse dhe vendet potenciale pritëse kanë mbetur shumë prapa.

Nuk ka pasur vlerësim të plotë të teorisë dhe evidencës për të sqaruar se cilat qasje politike janë më të dobishme, cilat janë kundër produktive dhe cilat janë me të vërtetë të dëmshme për qeveritë që duan t'i shfrytëzojnë Investimet e Huaja Direkte, si pjesë e strategjive të tyre të zhvillimit.

Rëndësia e studimit të Investimeve të Huaja Direkte dhe e të dhënave mbi ecurinë e tyre në mbarë botën qëndron në faktin e sigurimit të informacioneve ndërkombëtarisht të krahasueshme mbi shkallën e integritit ekonomik dhe të konkurrencës së tregjeve, ndjekjen e tendencave të investimeve, me qëllim të hartimit të politikave të mirë informuara për qasjen ndaj këtyre investimeve.

Tregtia dhe Investimet e Huaja Direkte kanë kontribuar shumë në rritjen ekonomike dhe ngritjen e standardeve të jetesës në të gjithë botën, veçanërisht në vendet në Evropën Qëndrore dhe Azinë Lindore. Tregtia ka ofruar cilësi më të mirë, produkte me kosto më të ulët, të cilat kanë përmirësuar në mënyrë të ndjeshme cilësinë e jetës së qytetarëve të këtyre vendeve. Bizneset lokale kanë lulëzuar duke u rritur eksportet në tregjet e reja. Presionet konkurruese nga importet kanë ngritur standardet vendore, duke nxitur përmirësime në cilësinë dhe produktivitetin në vendet ku janë investuar, gjë që kanë çuar në të ardhura më të larta për qytetarët lokalë.

Përfitimet e liberalizimit të tregtisë janë veçanërisht të mëdha në biznese më të vogla, në të cilat mungonin koleksione të plota të industrive të nevojshme konkurruese, të cilët prodhojnë një shumëllojshmëri të gjerë të produkteve. Bizneset më të vogla shpesh kanë një avantazh

në degë të industrisë kyçe që kanë nevojë për tregjet e eksportit të cilat kanë për qëllim rritjen e tyre.

Kështu që shtetet, të cilat kanë qëllimin thithjen e investimeve të huaja, për t'i realizuar ato, duhet që fillimisht t'i ndërmarrin masat përkatëse ligjore, si hartimin e ligjit për investimet e huaja, i cili rregullon mbrojtjen ligjore të investimeve, përpilimin dhe realizimin e marrëveshjeve me kompanitë shumëpalëshe dhe masat mbrojtëse, me anë të të cilave sigurojnë mbrojtën e të drejtave të investuesit, të drejtave të pronësisë etj, siç janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, e Bankës Qëndrore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi investimet, qendra ndërkombëtare e OECD-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi investimet ndërkombëtare dhe ndërmarrjet shumëpalëshe.

Prandaj, për të siguruar një klimë të favorshme për investitorët duhet të përpilohen dhe realizohen marrëveshje për investimet dypalëshe dhe të njëjta, të përcaktohet mbrojtja dhe siguria e investimeve, përpilimi i akteve ligjore, të cilat në mënyrë specifike rregullojnë masat e shpronësimit dhe kompensimit të rastet eventuale të tyre, si dhe garantimin se në mënyrë transparente dhe të arsyeshme do t'i sigurohen kushte në rastet kur investitorët janë të interesuar për të blerë tokë apo të njëjtat t'i marrin me qira.

Rëndësia e ligjit në funksionalizimin e zhvillimit ekonomik

Në periudhën e viteve të 90-ta, atëherë kur ekonomitë në tranzicion zhvilluan hapat e parë drejt ekonomisë së tregut, me shpresë se do të kishte një lulëzim të hovshëm ekonomik, u vu re se vetëm me bartjen e pronësisë private, nuk arrihet zhvillim i mirëfilltë ekonomik, por e njëjta arrihet vetëm me zbatimin e mirëfilltë të legjislacionit, i cili do të përdoret për të mbrojtur lirinë ekonomike.

Kështu që e drejta për përdorimin, transformimin, tregtimin dhe përjashtimin e të tjerëve nga përdorimi i pronës private, është e domosdoshme për një ekonomi dhe shoqëri të zhvilluar. Andaj, për përkrahjen e zhvillimit ekonomik dhe tërheqjen e investimeve të huaja, vendi duhet të mbrojë të drejtën mbi pronën.

Prona konsiston në pronën e paluajtshme (tokë) dhe në pronën personale (çdo pronë përveç tokës). Prona personale mund të jetë e prekshme, si për shembull makineri, automobila, artikuj etj, ose e paprekshme si të drejta kontraktuale, aksione të stokut të një kompanie,

patenta, të drejta autori etj (OSCE., 2006). Prandaj, si vende me prioritet për investime të huaja janë gjithnjë ato, të cilat me ligjin përkatës mbrojnë të drejtën e pronës nga sekuestrimi i pa kompensuar nga qeveria, nga mashtrimet dhe krimi.

Stabiliteti legjislativ

Një nga faktorët esencial për tërheqjen e investimeve të huaja, është stabiliteti legjislativ, dhe një mjedis politik, i cili mbështet klimën e qëndrueshme të biznesit dhe investimeve. Andaj ligjet, të cilat ndryshojnë vazhdimisht, ndikojnë negativisht në parashikimet e investitorëve për të realizuar fitimet e planifikuara me rastin e investimit (OSCE., 2006, p. 27)

Pra, një mjedis i paqëndrueshëm legjislativ, në një moment të caktuar krijon mendim te investitorët se ekziston një rrezik i lartë për tu krijuar kushte jo të favorshme dhe të njëjtit për t'iu shmangur rreziqeve të mundshme heqin dorë nga investimet dhe kërkojnë që të njëjtat të realizohen në ndonjë vend (shtet) me stabilitet legjislativ. Këtu mund të themi se, miratimi i legjislacionit tregtar, i njëjtë apo i përafërt me 'acquies communitaire' të Bashkimit Evropian, i cili është i njohur për investitorët, i njëjti siguron një kornizë të njohur ligjore me standarde ndërkombëtare, të cilat njihen dhe janë të qarta për ta.

Prandaj, për investitorët është më shumë i favorshëm vendi i cili ka një sistem stabil legjislativ, posaçërisht ato vende që janë të hapura ndaj reformës në legjislacionin tregtar dhe miratojnë ligje jo diskriminuese, si dhe praktikojnë vendosjen e një periudhe për njoftim dhe komente për projektligjet për tregtinë, ku ju jepet e drejta njerëzve të biznesit të përgatiten që të ndryshojnë mënyrën e të bërit biznes dhe me "komentet" e tyre eventuale mund të përmirësojnë legjislacionin tregtar.

Sigurimi dhe Mbrojtja e të drejtave të investitorëve

Duke u nisur nga fakti se investimi, si motor i zhvillimit ekonomik, mund të luajë rol kyç duke siguruar që rritja ekonomike të jetë e qëndrueshme, çdo vend (shtet) pritës i investitorëve, ka autorizimin sovran që me akte ligjore të sigurojë investimet e huaja në territorin e tyre, kështu që shteti me aktivitetin e vet ligjor mund të krijojë klimë të përshtatshme, jo më pak të favorshme ose klimë aspak të mirë për investitorët e huaj. (Hetemi, Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut, 2005)

Andaj, investitori duhet të ndihet i sigurt, se do të trajtohet me drejtësi dhe pa diskriminim,

dhe që mosmarrëveshjet eventuale do të zgjidhen në mënyrë të drejtë edhe në rastet kur shteti në të cilin investohet, është vend i sigurt, investitorët pretendojnë në të drejtat e tyre dhe të njëjtit kërkojnë që ato të mbrohen.

Kështu që, shtetet të cilat kanë klimë të organizuar të të bërit biznes dhe investime, i trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet vendëse dhe ato të huaja, ku si parim qenësor në bazë të të cilit edhe rregullohen investimet e jashtme janë parimet e trajtimit kombëtar të tyre (Smaka, E drejta biznesore, 2007). Këtu mund të themi se në bazë të këtij parimi kërkohet që investitori i jashtëm të mund t'i transferojë autorizimet e veta pasurore, të ketë të drejta të njëjta për blerje të pasurive të paluajtshme, të tatimohet dhe të ngarkohet me tagra, nëse jo më lehtësira apo favorizime së paku të njëjta me ata (investitorë) të brendshëm.

Po ashtu, të ju lejohet investitorëve të jashtëm të kenë të drejtë për themelim dhe organizim të ndërmarrjeve vartëse, filialeve si dhe zyrave përfaqësuese të ndërmarrjeve në një shtet tjetër, ashtu si i kanë këto të drejta edhe investitorët (ndërmarrjet) e brendshëm – vendor.

Klima e biznesit në Republikën e Kosovës është në fazën e përpjekjeve për tu bërë një ndër vendet konkurruese në rajon. Përparësitë e krijuara, janë në rrugëtim të një sistemi të shkëlqyeshëm të taksave, burimeve të bollshme natyrore, regjistrimi i shpejtë dhe i lehtë i bizneseve, ligjet transparente mbi investimet e huaja si dhe benificionet e tjera, po e bëjnë Kosovën, një mjedis mjaft atraktiv për thithjen e investimeve të huaja. Investitorët (Kompanitë), të cilët janë në kërkim të një vendi me klimë të përshtatshme për të investuar, me shpenzime të vogla e me qasje të lehtë në BE, në Evropën Qendrore dhe në tregjet e Ballkanit, Republika e Kosovës paraqet një mundësi tërheqëse. Në këtë periudhë, në Kosovë, një investitor mund të regjistrojë biznesin për 2 ditë pa shpenzime.

Duke u bazuar në Raportin tregues të Bankës Botërore për të bërit biznes, Kosova është zhvendosur për 26 vende më lartë, duke e bërë atë ndryshuesin më dinamik në Evropën Jug-Lindore dhe Qëndrore.

Këtu mund të themi se çdo investitor, me rastin e marrjes së vendimit për të investuar në një shtet, fillimisht kërkon disa nga mbrojtjet dhe siguritë bazike. Parimet themelore të investuesit përmbajnë të drejtën për trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të investuesve vendas dhe të huaj, investim në të gjithë sektorët dhe të gjitha llojet e biznesit, të cilat rregullohen me ligjet e vendit për investime, transferim të mjeteve (fitimeve) jashtë shtetit të huaj, pas përfundimit të pagimit të taksave dhe kushteve të caktuara konform ligjit, siguri në

raste të privatizimit, shpronësimit apo masave të tjera, mbrojtje të pronësisë intelektuale dhe industriale, si dhe zgjidhje të mosmarrëveshjeve eventuale në gjykata kompetente vendore, apo në rastin konkret e Kosovës me Austrinë.

Republika e Kosovës, në vazhdimësi është duke krijuar klimë të favorshme të biznesit, andaj me qëllim të zbatimit të disa garancive ligjore dhe sigurimit të kushteve të lartshënuara, e që janë të nevojshme për inkuadrimin e investimeve të huaja, në prill të vitit 2006, Qeveria e Kosovës përpiloi Ligjin për investimet e huaja (Ligji Nr.02/L-33). Në bazë të këtij ligji, një investues i huaj, i definuar si person fizik që nuk është banor i përhershëm i Kosovës, një biznes apo organizatë tjetër, apo asociacioni i themeluar jashtë juridiksionit të Kosovës, duhet të udhëhiqet nga parimi i trajtimit nacional, që do të thotë se ndërmarrjet e huaja do të trajtohen njësoj si ndërmarrjet e ngjashme vendore.

Në veçanti të drejtat që i takojnë një investuesi të huaj janë (Ligji Nr 02/L-33, 2006)

- Trajtimi i barabartë apo jodiskriminues;
- Mbrojtja dhe siguria e vazhdueshme;
- Kompensimi në raste të nacionalizimit apo shpronësimit, duke përfshirë edhe pagesën e interesit;
- Transferimi i lirë dhe përdorimi i pakufizuar i të ardhurave;
- Mbrojtja ndaj aplikimit retroaktiv të ligjeve.

Sistemi legal i Kosovës është rikonstruktuar që të jetë në përputhje me legjislacionin e EU-së. Riatdhesimi i fitimeve dhe transferimi i kapitalit të investuar është i lirë dhe i pakufizuar. Të gjitha ligjet dhe rregulloret në Kosovë janë në dispozicion në internet në gjuhën angleze duke bërë sistemin legjislativ të Kosovës ndër më transparentët në rajon. Prandaj, duke u bazuar në garancitë legjislative dhe më qëllim të promovimit për mbrojtjen e investimeve, ka hartuar dhe ka nënshkruar dhjetë marrëveshje bilaterale, me SHBA (OPIC), Austrinë, Turqinë, Shqipërinë, Malin e Zi, Kuvajtin dhe Katarin, Belgjikën dhe Luksemburgun, Maqedoninë dhe Kroacinë.

Fondet investive (investuese)

Janë organizata, asociacione apo firma specifike, që themelohen me qëllim të tubimit të mjeteve nga anëtarët e vet (investitorët, të cilët pas saj i investojnë drejtpërsëdrejti, me letra vendore me vlerë, instrumente financiare apo patundshmëri)¹¹².

Fondet investive dallojnë nga investimet e tjera, ndonëse merren si instrumente apo mekanizma investues, vetvetiu nuk janë LV. Këto fonde mund të emetojnë LV, mund të tregtojnë me to, por nuk janë letra të themi autentike me vlerë. Ato, në fakt, janë grupe të menaxhuara profesionale të LV, të organizuara si një portofol apo më shumë sish. Kur investitori investon në fond, ai nuk investon në një letër të veçantë me vlerë, të cilën e mban fondi, por investon në të gjitha se bashku, kryesisht ashtu që (qoftë edhe me aksion) e blen pjesëmarrjen në fond, për ta fituar përmes kësaj të drejtën indirekte të pronësisë në fund dhe portofolin e tij (Armand, 2012, p. 84)

Roli i Agjencioneve për Nxitjen e Investimeve të Huaja

Çdo vend, i cili ka për qëllimin zhvillimin ekonomik përmes investimeve huaja, këtë e realizon me anë të agjencive për nxitjen e investimeve, e cila është hallka lidhëse për zhvillimin e imazhit të një vendi si një destinacion investimi, rekrutim aktiv i investimeve të huaja, përmësim i klimës së të bërit biznes, në të kundërtën, në rast të mos promovimit të investimeve, vjen deri te vendosja e barrierave rreth njohurive dhe mundësive për investitorët permanent.

Roli i agjencive për investime, është se ato ndikojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin e imazhit të vendit si një destinacion tërheqës investimi, promovojnë identitetin e vet si pikë referimi për investitorët aktual dhe ndërmjetësojnë me qeverinë për t'i informuar në hollësi investitorët e huaj, derisa në të njëjtën kohë veprojnë si agjenci të pavarura, në shërbim të klientëve.

Andaj, agjencionet për nxitje të investimeve, në konsultim me investuesit e huaj identifikojnë pengesat, të cilat konsiderohen se janë arsyt e mos investimit dhe të njëjtat ia paraqesin qeverisë si rekomandim, me qëllim të evitimit të tyre. Roli tjetër i tyre është edhe mbështetja e përpjekjeve për eliminimin e pengesave rregullative, si proceduarat burokratike për regjistrim dhe licencim të ndërmarrjeve si dhe administrimin tatimor. Si rol kyç i tyre (agjencive) është edhe nxitja e imazhit të vendit si destinacion tërheqës për investues potencial, i cili prezanton resurset natyrore dhe përparësitë të cilat konsiderohen si të

favorshme për investimet e huaja, ku e njejta realizohet përmes marketingut me shpërndarjen e mesazheve në broshurat dhe në faqet e internetit.

Agjencitë, përveç nxitjes së Investimeve të Huaja Direkte, tek investuesit potencial, përmes stafit japin informacion dhe shërbime edhe për klientët, si shpjegimi i procesit të regjistrimit të ndërmarrjeve, informacione për gjetjen e vendit më të favorshëm, ndihmë për zgjerimin e investimeve përmes gjetjes së partnerëve për biznes, ofrimin e shërbimeve infrastrukturore, monitorimin e investimeve si dhe raportimin para qeverisë, mediave rreth investimeve dhe statistikave.

Agjencioni multilateral për sigurinë e investimeve(MIGA)

Me qëllim të mbrojtjes së investimeve në vitin 1988, është formuar Agjencioni Multilateral për Sigurinë e Investimeve (**MIGA**) dhe si i tillë është institucioni i fundit i themeluar, i cili bën pjesë në Grupacionin Banka Botërore. Ky agjencion mbështet investimet direkte në vendet me zhvillim. Këtë e bën në atë mënyrë që siguron garanci kundër rrezikut (ndikimit) politik (jo komercial) i cili do t'i shkaktonte dëm investitorit. Investitorët, kur sigurojnë mbrojtjen e MIGA – së, janë me të gatshëm për të investuar në vende të cilat, sipas mendimit të vet investuesit, nuk janë mjaft të sigurta për të investuar në projekte (Krasniqi, 2012). Pra, misioni i MIGA-së është që të promovojë Investimet e Huaja Direkte (IHD) në vendet në zhvillim, për të ndihmuar mbështetjen e rritjes ekonomike, reduktimin e varfërisë dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve, si dhe siguron investimet ndërkufitare të bëra nga investitorët në çdo vend anëtar MIGA në një vend anëtar në zhvillim.

MIGA, ka qëllim të ofrojë avantazhe krahasuese në fusha përkatëse si dhe aftësinë për të rivendosur besimin e komunitetit të biznesit, për bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm me tregun e sigurimeve publike dhe private, për të rritur shumën e sigurimit në dispozicion për investitorët.

Në Republikën e Kosovës paraqitja e Agjencisë Shumëpalëshe për Garantim të Investimeve (MIGA), me datën 31 tetor 2011, arrinte shumën 53.2 milionë dollarë amerikanë. Ekspozimi i MIGA-së është 23 milionë dollarë, rezultat i një garancie që MIGA e lëshoi në dhjetor të vitit 2010 për ProCredit Holding (PCH) duke mbuluar investimin e saj në kompaninë e saj vartëse në Republikën e Kosovës. Mbulimi është për një periudhë deri në 10 vjet kundër rrezikut të shpronësimit të fondeve për rezervat e detyrueshme që i mban vartësi në bankën qendrore të

juridiksionit të saj. Ky projekt është pjesë e një kontrate madhore që MIGA e ka lëshuar për PCH. PCH është me seli në Gjermani dhe është kompania mëmë e 21 bankave të rrjetit (grupi ProCredit). Në Kosovë, ProCredit Bank është një bankë e orientuar kah zhvillimi me shërbime të plota dhe përqendrohet në aktivitetet e saj të kredidhënies për ndërmarrjet mikro, të vogla, dhe të mesme (NMVM), duke kontribuar ndjeshëm në krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë.

Përkrahja e vazhdueshme nga MIGA për këtë projekt sinjalizon aftësinë e agjencisë për të nënshkruar projekte në vend dhe përkrahjen e investime të huaja direkte - IHD të brendshme, në sektorin e energjisë, atë financiar, të infrastrukturës dhe bujqësisë, dhe kështu të shtojë edhe strategjinë e Grupit të Bankës Botërore për të inkurajuar zhvillimin e sektorit privat, duke trajtuar pengesat reale dhe të perceptuara në mjedisin punues të vendit.

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Në Republikën e Kosovës, në promovimin e investimeve dhe mbështetjen e investimeve është Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. E njëjta jo vetëm që është përgjegjëse për mbrojtën dhe promovimin e investimeve, ajo mbështet edhe zbatimin e politikave dhe programeve publike në fushën e zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (Dedaj & Carabregu, 2012). Agjencia zhvillon politika lidhur me themelimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike, si dhe promovimin e të gjitha produkteve të prodhuara në Kosovë me qëllim të zgjerimit të tregut për prodhuesit vendor.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në tekstin e mëtejshëm AIDA, me qëllim të thithjes së investime të huaja propozon politika për lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime, duke u ofruar shërbime dhe mbështetje investitorëve ekzistues dhe atyre potencial (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, 2020). AIDA, gjithashtu nxit eksportet, mallrat dhe shërbimet, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse dhe dhënies së asistencës financiare për shoqëritë eksportuese dhe promovimin e eksporteve. Me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të sekretit privat ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme të përmirësimit të klimës së biznesit duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet tregtare në të

gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke bashkëpunuar dhe ndërmjetësuar me investitorët dhe organet shtetërore.

Synim tjetër i AIDA-s është edhe mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me fondin e konkurrueshmërisë për të mundësuar rinovimin dhe përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve.

Transparenca

Faktor tjetër i rëndësishëm, si për investuesit vendas ashtu dhe ata të huaj, është informacioni transparent për mënyrën si zbatohen rregullat dhe aktet për investimet dhe se si ato mund të ndryshohen. Pra, është një faktor vendimtar në vendimet për investime. Transparenca dhe parashikueshmëria janë veçanërisht të rëndësishme për investuesit e huaj që u duhet të funksionojnë me sisteme rregullatori, kultura dhe kuadër administrativ shumë ndryshe nga ato që janë mësuar (Baker, 1999). Transparenca në të shumtën e rasteve është e rëndësishme për ekonominë në zhvillim dhe në tranzicion, sepse niveli i ulët i investimeve nuk jep një “historik” për investuesit (OSCE, 2006, p. 28).

Për investitorët dhe institucionet publike, regjimi apo masat nxitëse duhet të jenë transparente. Investitorët duhet të kenë qasje të lehtë në informata për nxitësit në dispozicion, për kërkesat e kualifikimit dhe dokumentacionit, shumat maksimale, procedurën dhe kriteret e vendimit për akordim, kohëzgjatjen e procedurës, autoritetin në krye etj. Institucionet publike relevante duhet të mbledhin dhe shkëmbejnë informacion mbi atë se kush e çfarë lloj të masave nxitëse merr dhe nga kush. Një regjistër i masave nxitëse publike të investimeve ose çdo lloj tjetër i bazës së të dhënave të centralizuara mund të ndihmojë në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi masat nxitëse të dhëna (Grupi i Bankës Botërore, 2013).

Korrupsioni

Fenomeni (faktori) tjetër, i cili ndikon mjaft negativisht në zhvillimin ekonomik të vendit, e konkretisht në thithjen e investimeve të huaja është korrupsioni. Kjo dukuri pengon dhe vështirëson zhvillimet në të gjitha fushat ku gjen zbatim. Perceptimi i lartë i korrupsionit, jo vetëm se e ulë besimin e qytetarëve dhe bizneseve drejt qeverisë dhe institucioneve publike, krijon një reputacion negativ të vendit, madje është edhe pengesë për tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte ashtu edhe për zhvillimin ekonomik të vendit.

Lehtësimi i burokracisë në aspektin e të bërit biznes duhet të shkojë përkitazi me

përmirësimet në luftën kundër korrupsionit me qëllim që të arrihet synimi për rritje të investimeve të huaja. Ky fenomen është burim i pasigurisë për biznese të huaja serioze dhe kështu rrit edhe më tutje rrezikun e investimit në vend.

Këtu mund të themi se, vendet të cilat për qëllim kryesor kanë zhvillimin ekonomik, të njëjtat pra, duhet të ofrojnë stabilitet legjislativ, transparencë si dhe luftimin e korrupsionit. Kjo mund të arrihet duke krijuar një departament të pavarur anti korrupsion, me qëllim të ndjekjes penalisht të autorëve të korrupsionit, të ofrojë lehtësira administrative, funksionim të gjyqësorit si organ i pavarur, profesionalizëm dhe rritje të pagave të nëpunësve civilë, ekzekutim dhe zbatim të ligjit antikorrupsion. Me realizimin e këtyre masave, të cilat janë disa nga elementet kyçe të klimës së favorshme për investime, atëherë çdo investitor do ta ketë më të lehtë marrjen e vendimeve dhe eliminimin e dyshimit për investime në atë shtet (OSCE, Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë pozitive për biznesin dhe investimet, 2006, p. 27).

Baza legjislative që siguron dhe garanton investimin e kapitalit të huaj në Kosovë

Duke u nisur nga rëndësia se investimet e huaja direkte, janë një burim shumë i rëndësishëm i flukseve të kapitalit dhe zhvillimit të ekonomisë së një vendi, Kosova ofron një siguri të mirë për investime të huaja, përkatësisht ka një infrastrukturë të mirë sa i përket këtyre investimeve. Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2012)

Andaj, investimet e huaja direkte paraqesin një rën nga fuqitë themelore lëvizëse të procesit të globalizimit të ekonomisë botërore, ku edhe janë faktorët me më rëndësi të lidhjes ekonomike të vendeve industriale me shtetet në zhvillim, andaj aktualisht mundësitë e vetme për zhvillim ekonomik në Kosovë janë investimet nga jashtë, për faktin e vetëm se kapacitetet për investime vendore janë shumë të limituara.

Bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar i një vendi, pra edhe i një rajoni, është rezultat i nivelit të zhvillimit ekonomik dhe të zhvillimit të strukturës ekonomike të atij vendi, përkatësisht rajoni. Prandaj, edhe bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar i Kosovës varet nga këta dy faktorë kryesorë, që caktojnë suazat e përgjithshme, dinamikën dhe drejtimet

kryesore të zhvillimit të këtij bashkëpunimi (Berisha, 2002)

Andaj, legjislacioni i Kosovës ka si qëllim kryesor nxitjen dhe inkurajimin e Investimeve të Huaja në Kosovë, duke iu ofruar investitorëve të huaj, të drejta, garanci themelore dhe të ekzekutueshme që u japin siguri investitorëve të huaj që ata dhe investimet e tyre do të mbrohen dhe do të trajtohen në mënyrë të drejtë, si dhe në pajtim të plotë me parimin e sundimit të ligjit, standardet dhe praktikat e pranura ndërkombëtare. Me nxitjen dhe inkurajimin e investimeve të huaja, legjislacioni kosovar synon që të ndihmojë zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës, veçanërisht zhvillimin e një sektori privat të fuqishëm, konkurrues dhe të angazhuar në degë të ndryshme të ekonomisë.

Garantimi i sigurisë së investimeve të huaja nënkupton sistem të masave të shtetit pranues të investimeve, me të cilat ky i mbron investitorët e huaj nga paraqitjet e rreziqeve komerciale dhe jo komerciale, si dhe të shtytjes së veprimeve të tyre. Sipas dispozitës së nenit 3 të Rregullores për Investimet e Huaja, garantohet tretmani nacional, siguria juridike, e drejta e konversionit dhe pagimit të lirë, mbajtja e librave dhe transferi i fitimit, pasurisë etj. (UNMIK, 2001)

Sipas nenit 12 të Rregullores për Investimet e kapitalit të huaj në Kosovë, asnjë ligj, rregullore, udhëzim ose akt tjetër që ka fuqinë e ligjit për të vendosur mbi investimin e huaj e që ka kushte më pak të favorshme se ato që ekzistojnë kur investimi i huaj ishte kryer nuk mund të ketë fuqi prapavepruese (Ligji 04/L-220 , 2014)

Kosova ka një ekonomi të re dhe dinamike, ku baza e saj është transformuar nga një ekonomi centraliste e dirigjuar në një ekonomi të hapur të tregut, cila transformimin e saj të thellë e ka përjetuar pas vitit 1999, me çlirimin e Kosovës nga Serbia. Një ndër sfidat me të cilat ajo u përball gjatë dekadës së fundit është edhe procesi i privatizimit (Qeveria e Republikës së Kosovës, 2018)

Në përpjekje për të krijuar një mjedis sa më të përshtatshëm për investitorët, *AKP*-ja vazhdon me një program të përsheptuar të privatizimit të ndërmarrjeve dhe Aseteve përmes një procesi të tenderimit transparent dhe konkurrues, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Agjencia Kosovare e Privatizimit (*AKP*, 2012) themelohet si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit të Kuvendit të Kosovës, ligjit **Nr. 04/L-034** për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit **Nr. 05/L-**

080 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin **Nr. 04/L-115** për përfundimin e mbikqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës si dhe ndryshim plotësimin me ligjin **Nr.06/L-023**.

E ndodhur në Evropën Juglindore, ekonomia e këtij vendi (Kosovës) është bërë pjesë e integritimeve ekonomike të këtij rajoni, të cilat ofrojnë mundësitë e zgjerimit të tregut në një hapësirë mjaft të gjerë. Qëllim në vete tashmë është rritja e konkurrueshmërisë së kësaj ekonomie duke rritur kapacitetin e saj eksportues për të zvogëluar deficitin tregtar që Kosova aktualisht e ka. Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit, ofron një sërë përparësish komparative, si: popullsinë e re dhe mjaft mirë të kualifikuar, ku mosha mesatare e saj është mjaftë e re, resurset natyrore, kushtet e volitshme klimatike, infrastruktura e re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-s dhe në atë të Bashkimit Evropian. Kosova përveç se është anëtare e CEFTA-s, në qershor të këtij viti është anëtarësuar edhe në FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar) dhe BB (Banka Botërore) si dhe aspiron në mekanizma tjerë të fuqishëm ekonomiko-financiar siç është BERZH, si dhe në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës CEB (Ministria e Integritimit Evropian në Kosovë, 2020)¹³³.

Kosova gjatë muajit qershor 2013, është pranuar si anëtare e plotë në CEB. Kjo bankë është degë autonome e Këshillit të Evropës dhe aspiron në mekanizma të tjerë të fuqishëm ekonomiko-financiar si, Organizata Botërore e Tregtisë OBT etj.

Në Kosovë, investimet e jashtme direkte kanë filluar pas vitit 2000, ndërkaq investimet më voluminoze janë bërë në vitet 2007 – 2008. Investimet e mëdha të viteve 2007 – 2008 i dedikohen investimit në telefoninë e dytë mobile në Kosovë. Rënia e investimeve të huaja direkte u vërejt nga fundi i vitit 2008 dhe fillimi i vitit 2009 nga kriza ekonomike globale ku investimet e jashtme patën rënie drastike. Ndërkaq më 2010 – 2011 filloi rritja e investimeve edhe pse me një ritëm shumë të ngadalshëm (Domniku, 2012)

Investimet në Kosovë , përfitimet

Arsyet për të investuar në Kosovë janë të shumta. Këtu përfshihen kushte të favroshme ekonomike si taksa dhe tatime të ulëta, kornizë ligjore të harmonizuar me atë të Bashkimit Evropian mbi Investimet, zbatimi i ligjit etj. Disa nga përfitimet e listuara për të investuar në Kosovë sipas Ministrisë së Integritimit Evropian në Kosovë numërojnë: (Ministria e Integritimit Evropian në Kosovë, 2020)

- Taksa të ulëta, resurse të pasura dhe ambient përkrahës të biznesit;
- Taksat në Kosovë janë shumë të ulëta krahasuar me shtetet fqinje;
- Sistemi tatimor është mbajtur jashtëzakonisht i thjeshtë;
- Popullata e re dhe e motivuar, 70% nën moshën 35vjeçare;
- Një fuqi të re dhe të motivuar punëtore me shpirt dhe aftësi të forta ndërmarrëse dhe gjithashtu njohuri të përgjithshme të shumicës së gjuhëve evropiane;
- Resurset e lakmueshme natyrore: linjiti, zinku, plumbi, ferro-nikeli dhe toka pjellore bujqësore;
- Qasje të lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe tregjet fqinje;
- Institucione moderne në përkrahjen e bizneseve;
- Procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë për regjistrimin e bizneseve (brenda 3ditëve);
- Sistem të sigurtë bankar;
- Strukturë moderne, ligjore dhe në pajtim me BE-në,dhe;
- Monedha zyrtare në Kosovë është Euro, që eliminon rrezikun e Euro-zonave.

Sistemi Doganor

Dogana e Kosovës aplikon proceduara të avancuara në zhdoganimin e mallrave, përmes sistemit elektronik – TIMS (Trade Information Management System) ku 90% e deklarimeve bëhet përmes DTI (Direct Trade Input). Koha mesatare e vlerësuar për zhdoganim në kalimet kufitare është 3 orë (Ministria e Integritimit Evropian në Kosovë, 2020)

Tarifat doganore në Kosovë sa i përket importit janë: 0% për mallrat që importohen nga vendet e CEFTA, 10% për mallrat që importohen nga të gjitha shtetet tjera, taksa e akcizës variabile për produkte, si: duhani, nafta, alkooli etj.(Ministria e Integritimit Evropian në Kosovë, 2020)

Pas ndryshimeve të bëra në sistemin doganor është bërë reduktimi i tarifave doganore për mjetet kapitale(themelore), lëndët e para për agrobiznes dhe disa sektorë tjerë të prodhimit, lëndëve të ndërmjetme për procesim të mëtutjeshëm nga 10% në 0%.

Të liruara nga tarifat doganore janë: plehërat artificiale, prodhimet farmaceutike, instrumentet dhe aparatura kirurgjike,mallrat për qëllime humanitare,mallrat që përdoren nga diplomatët e

huaj dhe misionet konsullore siç janë: KFOR-i, UNHCR, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, OJQ-të e regjistruara te UNMIK-u që kanë qëllim mbështetjen e programeve dhe projekteve humanitare dhe rindërtuese në Kosovë (Ministria e Integrimit Evropian në Kosovë, 2020)

Sistemi Tatimor i Kosovës dhe korniza ligjore

Bazuar në Administratën Tatimore të Kosovës, sistemi tatimor i Kosovës zhvillohet mbi përvojat dhe politikat e Bashkimit Evropian që paraqet një sistem mirë të zhvilluar mbi tatimet si edhe politikat doganore në përgjithësi. Sistemi tatimor në Kosovë përbën një pako ligjesh tatimore dhe udhëzimesh administrative që janë: (Administrata Tatimore e Kosovës, 2020):

- I. Legjislacioni për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me anë të të cilit rregullohen çështjet mbi: themelimin dhe funksionimin e administratës tatimore, të drejtat dhe obligimet e ATK-së dhe tatimpaguesve, regjistrimet me ç’rast: pajisen me numër fiskal, me numër të TVSH-së Ç’regjistrimet nga TVSH-ja Librat dhe regjistrimet e domosdoshme Gjobat dhe Ndëshkimet Afatet dhe Deklarimet
- II. Legjislacioni për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), përfshin aplikimin e tatimit të përgjithshëm në konsum për mallra dhe shërbime, i cili është saktësisht proporcional me çmimin e mallrave dhe shërbimeve, dhe llogaritet në këtë çmim sipas normës së aplikueshme, e ngarkohet në fazat e ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, në fund bartet nga konsumatori i fundit; (ATK, Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, 2015)
- III. Legjislacioni mbi Tatimin në të Ardhurat Personale (TAP) (ATK, Ligji nr. 05/L -028 mbi Tatimin në të Ardhura Personale, 2015) bazuar në nenin 4 të këtij ligji, objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës ndërsa objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë. Sipas nenit pesë të këtij ligji, të ardhurat e tatueshme, për një periudhë të tatueshme, nënkuptojnë ndryshimin ndërmjet të ardhurave bruto të pranuar ose të krijuara gjatë periudhës tatimore dhe zbritjeve të lejueshme sipas këtij ligji lidhur me të ardhurat e tilla bruto. Sipas nenit 6 – të, të ligjit mbi tatimin në të ardhura personale, tatimi në të ardhura personale vjetore, ngarkohet sipas shkallëve në vijim:

- Për të ardhurat e tatueshme, nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) ose më pak, zero për qind (0%);
- Për të ardhurat e tatueshme mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) deri në tre mijë euro (3.000 €), duke përfshirë edhe shumën tre mijë euro (3.000 €), katër për qind (4%) të shumës mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €);
- Për të ardhurat e tatueshme mbi tre mijë euro (3.000 €), deri në pesë mijë e katër qind (5.400 €), duke përfshirë edhe shumën pesë mijë e katër qind (5,400 €), tetëdhjetë e një pikë gjashtë euro (81.6 €) plus tetë për qind (8%) të shumës mbi tre mijë euro (3.000 €);
- Për të ardhurat e tatueshme mbi pesë mijë e katër qind (5,400 €), dyqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë euro (273.6 €) plus dhjetë për qind (10%) të shumës mbi pesë mijë e katër qind (5,400 €).

IV. Legjislacionit mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (TAK)

Sipas ligjit, LIGJI Nr. 05/L -029 për tatimin në të ardhurat e korporatave, Neni 3 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2015) tatimpagues konsiderohen:

- Korporata apo ndonjë ndërmarrje tjetër afariste që ka statusin e personit juridik sipas ligjit në fuqi në Kosovë;
- Shoqëria tregtare që vepron me pasuri në pronësi shoqërore ose publike;
- Organizata e regjistruar si organizatë jo-qeveritare sipas legjislacionit përkatës që rregullon regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve në Kosovë;
- Personi jo rezident me njësi të përhershme në Kosovë. duke iu nënshtruar paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji sipas të cilit:
- 1.Objekti i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës dhe Objekti i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë.

V. Legjislacioni mbi Kontributet Pensionale (KP) - Ligji mbi kontributet Pensionale në Kosovë Ligji Nr. 04/L-101 (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2012) në nenin 3 parasheh Format e Kursimeve Pensionale në Kosovë, sipas të cilit përcaktohen dhe përshkruhen format e ndryshme të sigurimit pensional qeveritar dhe privat në Kosovë.

Vetëm Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës, fondet pensionale plotësuese të punëdhënësit ose siguruesit e pensioneve të licencuar për sigurimin e pensioneve plotësuese individuale në pajtim me këtë ligj mund të sigurojnë pensione në Kosovë. Vendosja e politikës ekonomike, lidhur me pensionet si pjesë e politikës buxhetore dhe fiskale është përgjegjësi e qeverisë. Pensionet obligative përfshijnë dy forma të pensionit: pensionin bazë dhe pensionet e bazuara në kursimet individuale. Punëdhënësit po ashtu mund të sigurojnë për punonjësit e tyre pensione plotësuese që i siguron punëdhënësi për punonjësit e tij. Individët mund të blejnë pensione plotësuese individuale përmes siguruesve të pensioneve.

<i>Emri i Ligjit</i>	<i>Nr. i Ligjit</i>	<i>Nr. i Udhëzimit Administrativ</i>
<i>Ligji për administratën tatimore dhe procedurat</i>	Nr.03/L-222	Nr.03/2016
	Nr.04/L-102	Nr.15/2010
	Nr.04/L-223	
<i>Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar - Tvsh</i>	Nr.05/L-037	Nr.03/2015
		Nr.06/2016
<i>Ligji për tatimet në të ardhurat personale (TAP)</i>	Nr.05/L-028	Nr.01/2016
<i>Ligji për tatim në të ardhurat e korporatave (TAK)</i>	Nr.05/L-029	Nr.02/2016
<i>Ligji për kontributet Pensionale</i>	Nr.04/L-168	
	Nr.04/L-101	
	Nr.04/L-116	

Tabela 1. Ligjet mbi tatimet dhe ushëzimet relevante në fuqi në rastin e Kosovës

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës, udhëzuesit sipas gazetës zyrtare në linkun <http://gzk.rks.gov.net/default.aspx>

Në tabelën mbi ligjet dhe udhëzimet administrative të tatimeve në Kosovë paraqitet një përmbledhje e kornizës ligjore bazuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me shënime konkrete të shpallura nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Lloji i tatimit	Pragu i qarkllimit	Norma tatimore
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar – TVSh	30,000 euro	8% dhe 18%
Tatimi në të Ardhura të Korporatave – TAK	Nën 50,000 euro	
Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportese		3%

Veprimtaria shërbyese		9%
Tatimi në të Ardhura të Personale – TAP		
Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportese, etj.	Nën 50,000 euro	3%
Veprimtaria shërbyese		9%
Tatimi në të Ardhura të Korporatave – TAK	Mbi 50,000 euro	10%
Tatimi në të Ardhura të Personale – TAP		
Të ardhura Vjetore nga 0 deri 960	Mbi 50,000 euro	0%
Të ardhura Vjetore nga 960- 3,000		4%
Të ardhura Vjetore nga 3,000 -5,400		8%
Të ardhura Vjetore nga 5,400 e me lartë		10%
Tatimi në Paga (mujore)		
Të ardhura mujore nga 0 deri 80		0%
Të ardhura mujore nga 80-250		4%
Të ardhura mujore nga 250-450		8%
Të ardhura mujore nga 450 e më lartë		10%
Tatimi në Qira, Interes dhe të drejta pronësore		10%
Tatimi për kategori të veçanta		3% apo 1%
Tatimi për jo-rezidentët		5%

Tabela 2. Normat tatimore në Kosovë

Burimi: Administrata tatimore e Kosovës (ATK), Informata të përgjithshme për tatimet në Kosovë, <http://www.atk-ks.org/portfolio/informata-te-pergjithshme-per-tatimet-ne-kosove/>

Në tabelën mbi normat tatimore në Kosovë janë paraqitur të gjitha llojet e tatimeve në rastin e Kosovës dhe normat e tyre përkatëse. Nga të dhënat në tabelë vërrejmë se në të Ardhura të Korporatave është 10 përqind dhe kjo është një normë e ulët që paraqet një përparësi kundrejt tërheqjes së Investimeve të Huaja në rastin e Kosovës.

Regjistrimi i Biznesit

Proceduarat e regjistrimit të biznesit në Kosovë janë mjaft të thjeshta dhe të shpejta. Për investimet e jashtme ekziston Ligji për Investimet e Huaja, i cili mbron investitorët e huaj dhe i trajton të barabartë me investitorët vendorë. Për të operuar si biznes legjitim, ndërmarrjet e huaja dhe vendore duhet të regjistrohen në Agjencionin e Regjistrimit të Bizneseve, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë si një nga këto kategori biznesesh: biznese individuale, ortakëri të përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare, kompani e huaj, ndërmarrje shoqërore, ndërmarrje publike, kooperativa bujqësore, ndërmarrje të tjera nën juridiksionin e AKM-së. (Ministria e Integrimit Evropian në Kosovë, 2020),

Në përputhje me nenet e Ligjit për Investim të Huaj, kompanitë e huaja janë të lejuara të angazhohen në çfarëdo aktiviteti biznesor që është i hapur për bizneset vendore, dhe nuk ekziston ndonjë kufizim sa i përket kapitalit që mund të kenë këto kompani. Investitorët e jashtëm mund të themelojnë degë të veta në të njëjtën formë si bizneset vendore, të cilat funksionojnë në kuadër të Republikës së Kosovës (Ministria e Integritimit Evropian në Kosovë, 2020)

Baza legislative që siguron dhe garanton investimin e kapitalit të huaj në shtetet anëtare dhe në vetë Bashkimin Evropian

Investimet e Huaja Direkte luajnë një rol shumë të rëndësishëm në transformimin e vendeve, veçanërisht atyre në tranzicion. Me ndryshimin e strukturës, nënkuptojmë përparimin dhe hapjen e ekonomisë nga pikëpamja ndërkombëtare dhe orientimin në avantazhet konkurruese si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Një nga përparësitë e Investimeve të Huaja Direkte është se ato ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të vendit ku derdhen investimet. Investimet e huaja direkte, zakonisht gjejnë zbatim në vendet në zhvillim, ku njëherit ishin një nga burimet kryesore të financimit të jashtëm për shumicën e vendeve që kishin në perspektivë rritjen ekonomike, ku të njëjtat kanë ndikuar në disa vende kur ato janë përballur me vështirësi ekonomike. Gjithashtu këto ndihmojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e pagave të punëtorëve, lehtësimin e mënyrës së jetesës etj, si dhe kryesisht kontribuojnë në zhvillimin e sektorit prodhues të vendit pritës të investimeve.

Në çdo shtet, përpos dispozitave të brendshme (nacionale), më të cilat mbrohen investimet e jashtme është e domosdoshme që mbrojtja e tyre (investimeve) të rregullohet apo të harmonizohet edhe për dy apo më shumë shtete. Përveç konventës për themelimin e agjencisë multilaterale për garantimin e investimeve MIGA, mbrojtja e investimeve të jashtme, në fakt është e rregulluar me dispozita të brendshme dhe me marrëveshje bilaterale për investimet, ku zakonisht këtë e lidhin shtetet e zhvilluara me ato në zhvillim. (Hetemi, Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut, 2005, p. 147). Andaj, Investimet e Huaja Direkte, po ashtu luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e kushteve të duhura ekonomike për anëtarësimin në BE. Mbi 60 ligje të reja nacionale mbi investimet dhe mbi 1200 marrëveshje bilaterale e multilaterale e shprehin synimin e liberalizimit të dispozitave mbi investimet e huaja dhe krijimin e kushteve të volitshme për investuesit e huaj, kështu që, organizata të shumta ndërkombëtare merren me çështjen e investimeve të huaja në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Baza legjislative që siguron dhe garanton investimin e kapitalit të huaj në disa shtete të rajonit – Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi

Duke u nisur nga fakti se Investimet e Huaja Direkte, në ditët e sotme luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit, për këtë arsye, edhe nga ana e qeverive të Republikës së Shqipërisë, janë ndërmarrë dhe zbatuar politika favorizuese për nxitjen e IHD-ve. Ndër politikat kryesore mund të përmendim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, stabilitetin dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike, përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimet në klimën e biznesit etj.

Andaj, fokusi për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë shqiptare do të mbetet në tërheqjen e IHD-ve, me një fokus në sektorë ku ekonomia shqiptare ka potencial të pashfrytëzuar në aspektin e burimeve natyrore, si dhe në zhvillimin e sektorëve që ende nuk janë kryer për potencialin e tyre të plotë, të tilla si energjia e rinovueshme, turizmi, agrobiznesi, infrastruktura dhe shërbimet. Shqipëria ka miratuar një kornizë liberale, e cila është projektuar për të krijuar një klimë të favorshme investimi për investitorët e huaj. (UNDP, 2011) Legjislacioni në Republikën e Shqipërisë, siguron që Investimet e Huaja nuk kushtëzohen nga një autorizim paraprak. Ato lejohen dhe trajtohen mbi bazën e kushteve jo më pak të favorshme se ato që iu njihen investimeve vendase në kushte të ngjashme, me përjashtim të pronësisë mbi tokën, e cila rregullohet me ligj të veçantë.

Qeveria e Shqipërisë po ndërmerr një sërë masash konkurruese në nivelin ndërkombëtar. Modeli i ri ekonomik në vend, ka fokus prodhimin dhe eksportet, përmes reformave të mëdha strukturore. Klima e biznesit po zhvillohet me anë të reformave të mëtejshme në mënyrë që të shpërndajnë mundësitë në rritje që ofrohen për investitorët e huaj (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, 2020)

Shqipëria ka zbatuar një kuadër të favorshëm politikash për investimet e huaja direkte. Ndërsa kohët e fundit janë parashtruar politika për mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat në përgjithësi. Në kuadrin e proceseve integruese të Shqipërisë në BE dhe atyre në nivel rajonal është formalizuar tashmë Reforma për Zonën Ekonomike Rajonale (REA). Një komponent i REA-s, është edhe agjenda për investimet (RIRA)², e cila synon midis të tjerave edhe një harmonizim të kuadrit ligjor dhe rregullator të investimeve në vend me praktikën më të mira ndërkombëtare. (Këshili i Shqipërisë për Investimet, 2018). Gjithashtu, janë marrë masa të tjera për përmirësimet mëtejshme, duke përfshirë përmirësimet ligjore dhe krijimin e agjencisë së re për nxitjen e investimeve (AIDA).

Një ndër përparësitë e projekteve të Qeverisë së Shqipërisë janë zhvillimi i shpejtë ekonomik dhe integrimi në Bashkimin Evropian (BE). Politikat kryesore të vendit gjatë viteve të fundit kanë rezultuar në një kuadër të liberalizuar ekonomik dhe kanë sjellë një përmirësim të kushteve për bërjen e biznesit dhe thithjen e investimeve të huaja direkte (IHD). Në periudhat midis viteve 2008-2011, rritja ekonomike e vendit shënoi hapa pozitiv. Shqipëria, gjatë kësaj periudhe, ka shënuar një ndër rritjet ekonomike dhe mund të thuhet se krizën financiare e ka përballuar relativisht mirë. Investimet janë projekte shumë të ndjeshme dhe kërkojnë një analizë të gjithanshme dhe të saktë të mjedisit ku duhet investuar. Kjo sidomos vlen për shtete sikurse Kosova, ku normat e interesit bankar janë shumë të larta. Nga paragrafët e mësipërm, e shikuar se të gjitha investimet në broadband, në shtetet e ndryshme, kryhen nga qeveritë e atyre vendeve, çka në rastin e Kosovës kjo nuk është ashtu. Në Kosovë, këtë proces e kanë filluar kompanitë e ndryshme private nëpër rajonet ku veprojnë, dmth nuk janë projekte që shtrihen në tërë Kosovën pasi janë shumë të kushtueshme.

Në Prishtinë, implementimin e fibrës si teknologji broadband e ka bërë kompania “Artmotion”, kurse në Gjakovë kompania “Fiberlink” dhe nuk ka të tjera. Kur të përmendet broadbandi në kohët e sotme zakonisht mendohet në fibër e jo në teknologji të tjera që përdorin kabllon koaksial.

Po ashtu edhe në investimet private, e para që duhet llogaritur janë kthimet e fitimeve, gjë që nuk ndodhë te investimet shtetërore. Zakonisht kthimi i fitimit, ashtu siç e tregon edhe shembulli i mësipërm, nuk ndodh para periudhës tre vjeçare. Investimi në këtë teknologji, siç e pamë më lartë, ndikon edhe në rritjen e bruto prodhimit vendor, prandaj në kapitullin e mëposhtëm do të kalkulojmë një investim në broadband përmes fibrës në zonat rurale të Gjakovës. Qëllimi i investimit është që zonat rurale të kenë internet brezgjërë me çka do të kenë mundësi të bëjnë shitje online, me ç’rast do t’i rritnin të hyrat e tyre.

KAPITULLI V

VEPRIMET KONKRETE JURIDIKE (KONTRATA, MARRËVESHJA), BILATRALE APO MULTILATERALE, ME TË CILËN REALIZOHET PROCESI I INVESTIMIT TË KAPITALIT TË HUAJ

Marrëveshjet dypalëshe për investimet

Për ta bërë vendin sa më tërheqës për investitorët dhe për t'i stimuluar investimet ndërkombëtare, vendet gjithnjë e më tepër hyjnë në marrëveshje dypalëshe (ose rajonale shumëpalëshe, investimesh me partnerët e tyre tregtar). Këto marrëveshje ndërkombëtare detyruese u garantojnë mbrojtje investueseve të njëres palë shtet në territorin e palës tjetër shtet. Ato përmbajnë dispozita që pasqyrojnë disa nga parimet e evidentuara për secilën palë duke përfshirë: trajtim mos diskriminues të investuesve të huaj, trajtim të drejtë dhe të barabartë të investuesit të huaj, heqjen e kërkesave për performancën, riatdhesim të pa kufizuar të kapitalit dhe fitimeve, mbrojtjen nga shpronësimi bazuar në standardet ligjore ndërkombëtare, dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga arbitrazhi detyrues i një pale të tretë.

Në vitin 1994, SHBA-të e kanë ofruar modelin e tyre të një marrëveshjeje të tillë bilaterale në formë të një kontrate (The 1994 U.S. Prototype Bilateral Investment Treaty – në tekstin e mëtejshëm SHBA – BIT). Në kuadër të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim OECD-së (The Organisation for Economic Co-operation and development), një grup i posaçëm i ekspertëve në periudhën ndërmjet 1995 dhe 1998, kanë punuar në formulimin e tekstit të propozimit të Marrëveshje multilaterale për investime - MAI (Multilateral Agreement on Investments). Kjo marrëveshje ka pasur për detyrë të krijojë sistemin unik të rregullave lidhur me qasjen e investimeve të jashtme dhe investitorëve. Pra, qëllimi ka qenë që në treg të brendshëm të krijojë një kornizë unike të sigurisë juridike në nivelin botëror (Mehdi, 2005, p. 148)

Kontratat

Me kontrata kuptojmë pajtimin e autonomisë së vullnetit të palëve, të dy apo më shumë subjekteve të së drejtës, me anë të së cilës synohet të arrihet një qëllim juridik, të shuhet apo modifikohet qëllimi i saj, i cili mund të rezultojë edhe me përfundimin e saj (Kontratës) (Riza, 2007, p. 219) Kështu që, kontratat ndërmjet personave juridikë dhe/ose fizikë paraqesin bazën e tregtisë në ekonominë e tregut të lirë. Pra, kontratat hyjnë në grupin e punëve juridike të dyanshme. Terminologjia lidhur me përcaktimin e kontratës nuk është unike, sepse përveç termit kontratë përdoren edhe termet, si: konventë, traktat, pakt, dakordim dhe marrëveshje (Armand, 2012, p. 16). E drejta kontraktuale gjithashtu shërben për të plotësuar marrëveshjet e palëve, dhe për të siguruar që kufinj të adekuatë janë vendosur, në aftësinë e një pale apo palëve që të mos tejkalojnë limitet e pranuar.

Investimet e jashtme, në bazë të legjisllacioneve të shteteve respektive, rregullohen me

marrëveshje apo me kontrata bilaterale për investime, me të cilat ndër të tjera përcaktohet edhe mënyra dhe procedura e zgjidhjes së kontesteve eventuale ndërmjet kontraktorëve (Riza, 2007, p. 261) Në parim, kontratat janë marrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese për raportin e caktuar juridik, mirëpo si nocion, shprehet në definicione të ndryshme. Kështu në bazë të nenit 1001, të Kodit Civil Francez (Code Civile), kontrata është një nocion, në bazë të së cilës një apo më shumë persona obligohen ndaj dy apo më shumë personave të tjerë për të kryer apo mos kryer një obligim të caktuar juridik ku kontraktorët për kontraktim, mund të jenë (Smaka, E drejta biznesore, 2007, p. 220)

Personi natyral (personi fizik, etniteti natyral, subjekti fizik), si dhe personi legal (subjekti juridik, personi juridik, etniteti legal). Kontratat bilaterale janë të dyanshme, me të cilat krijohen detyrime kontraktore për të dy palët kontraktuese, kurse kontrata multilaterale është kontratë kolektive, ndërmjet përfaqësuesve të autorizuar të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, si dhe të qeverisë respektive (Smaka, E drejta biznesore, 2007, p. 224)

Shfrytëzimi i informatave në dispozicion për të shpjeguar të drejtën kontraktuale është një grup i mjeteve të vlefshme për të siguruar se marrëveshjet janë jetësuar mjaftueshëm për të shmangur konfliktet dhe për të shpjeguar “marrëveshjen” në rast se ka ndonjë mosmarrëveshje.

Të drejtat dhe liritë kontraktuale

Investuesit dhe bizneset kanë nevojë për liri dhe stabilitet në marrëdhëniet ekonomike, sidomos në marrëdhëniet kontraktuale, që të vendosin në mënyrë të pavarur kufinj të një transaksioni me anë të negociatave dhe marrëveshjes. Pra, për investuesit është e rëndësishme dhe kërkohet garantim se me nënshkrimin e një marrëveshje ajo zbatohet ashtu si edhe është nënshkruar. Me “lirinë e kontratës”, domethënë se palët kontraktuese mund “të jenë dakord për kufizimet e mundshme ligjore, në mënyrë që të nxjerrin benifite nga bashkëpunimi dhe shkëmbimi”. Në rastet kur shteti vlerëson se me një marrëveshje janë shkelur politikat e rëndësishme publike, atëherë ka të drejtë të kërkojë që e njëjta të shpallet e pavlefshme (OSCE, Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë pozitive për biznesin dhe investimet, 2018, p. 71)

Andaj, këtu mund të themi se nuk mund t’iu imponohet investuesve të huaj të hynë në partneritet me kompanitë vendase apo t’iu përcaktohen çmimet me të cilat një palë mund të nënshkruajë kontratën.

Qendra ndërkombëtare për zgjedhje të kontesteve investuese (ICSID)

Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID) është themeluar nga Konventa për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve midis Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të tjera (Konventa e ICSID). Konventa u formulua nga drejtorët ekzekutivë të bankës ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim (Banka Botërore). Më 18 mars 1965, drejtorët ekzekutivë, paraqitën konventën, me një raport shoqëruar, për qeveritë anëtare të bankës botërore për shqyrtimin e tyre të konventës, me qëllim nënshkrimin dhe ratifikimin e saj. Konventa hyri në fuqi më 14 tetor 1966, kur ajo ishte ratifikuar nga 20 vende. Më 10 prill 2006, 143 vende kanë ratifikuar konventën për t'u bërë shtete kontraktuese (ICSID, 2006)

Objektivat e qendrës ICSID

Me qëllim që të sigurojë një forum për zgjedhjen e kontesteve në mes të investitorëve të huaj dhe të vendit nikoqir – pritës, nëpërmjet ndërmjetësimeve ose arbitrazheve është themeluar në vitin 1966 me kontratë ndërkombëtare qendra ndërkombëtare për zgjedhje të kontesteve investuese (ICSID). Selia e qendrës është në lokalet e bankës ndërkombëtare për ndërtim dhe zhvillim. Kryetari i kësaj banke, sipas pozitës, është edhe kryetar i këshillit administrativ të qendrës por pa të drejtë vote. Objektivat e qendrës janë mundësimi i shtimit të vëllimit të investimeve të huaja duke themeluar një arbitrazh të posaçëm për zgjedhjen e kontesteve të krijuara me investime të jashtme. Qendra zgjedh konteste në mes të investitorëve të huaj dhe shteteve në të cilat bëhen investime, me kusht që shteti nacionalitetin e të cilit e ka investitori i huaj dhe shteti në të cilin janë bërë investimet, të jenë kontraktues të konventës së ICSID – së.

Qendra ndërkombëtare për zgjedhje të kontesteve investuese (ICSID), është institucioni kryesor në botë, i përkushtuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërkombëtare. Ajo ka përvojë të gjerë në këtë fushë, pasi ka administruar shumicën e të gjitha rasteve të investimeve ndërkombëtare. Shtetet kanë rënë dakord që ICSID, të jetë si një forum për zgjidhjen e kontesteve në mes të investitorëve shtetëror, kontesteve në shumicën e traktateve ndërkombëtare të investimeve dhe në ligjet e shumta të investimeve dhe kontratat.

Konventa mbi rregullativat dhe ligjet (ICSID)

Sipas nenit 6 të konventës mbi rregullativat dhe ligjet e qendrës ndërkombëtare për zgjedhje të kontesteve investuese, ICSID, (ICSID, 2006) pa cënuar fuqitë dhe funksionet që i janë ngarkuar parashihet të:

- miratojë rregulloret administrative dhe financiare të qendrës;
- miratojë rregulloren e procedurës për institucionin e pajtimit dhe procedurave të arbitrazhit;
- miratojë rregullat e procedurës për pajtimin dhe procedurën e arbitrazhit (të quajtur më tej Rregullat e pajtimit dhe Rregullat e Arbitrazhit);
- miratojë marrëveshjet me Bankën për përdorimin e lehtësive dhe shërbimeve administrative të Bankës;
- përcaktojë kushtet e shërbimit të sekretarit të përgjithshëm dhe të ndonjë zëvendës sekretari të përgjithshëm;
- miratojë buxhetin vjetor të të ardhurave dhe shpenzimeve të qendrës;
- miratojë raportin vjetor për funksionimin e qendrës, vendimet e përmendura në nënparagrafët (a), (b), (c) dhe (f), më lartë do të miratohen me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të këshillit administrativ. Këshilli administrativ mund të caktojë komitete të tilla që i konsideron të domosdoshme. Këshilli administrativ ushtron edhe një tjetër kompetencë dhe kryen funksione të tilla të tjera siç përcakton të jenë të domosdoshme për zbatimin e dispozitave të kësaj konvente.

Konsistrimi i komisioneve, tribunaleve dhe komiteteve (ICSID)

Bazuar në raportin e vitit 2019 të qendrës ICSID mbi konsistrimin e komisioneve tribunale dhe komitetet ad hoc vlen të theksohet se janë bërë gjithsejtë 171 emërimë në gjykatat e ICSID, komisionet dhe komitetet ad hoc. Këto emërimë iu bënë 42 gjykatave në arbitrazhione origjinale, dhe shtatë komiteteve ad hoc. Për më tepër, një gjykatë u krijua në një procedurë rishikimi dhe 21 emërimë u bënë në rindërtimin e gjykatave dhe komiteteve ad hoc.

Tetëdhjetë përqind e emërimeve ishin bërë nga palët ose nga partia e caktuar (ICSID Annual Report, 2019)

ICSID u krijua nga konventa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për investime midis shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera, kështu në fund të vitit fiskal 2019, ICSID numëroi 163 nënshkrues të konventës ICSID, nga të cilët 154 janë shtete kontraktuese. Kosova, nënshkroi marrëveshjen më 29 qershor të vitit 2009, depozita e ratifikimit u realizua më 29 qershor 2009, kurse hyrja në fuqi e konventës më 29 korrik 2009. (ICSID Annual Report, 2019, p. 67). Të gjitha shtetet kontraktuese përfaqësohen në mënyrë të barabartë në këshillin administrativ të ICSID. Si organ drejtues i ICSID, këshilli administrativ miraton buxhetin vjetor të qendrës, zgjedh sekretarin e përgjithshëm dhe zëvendës sekretarët e përgjithshëm dhe gjithashtu miraton raportin vjetor.

Shtetet kontraktuese gjithashtu kanë të drejtë të propozojnë dhe votojnë mbi ndryshimet në konventën dhe rregullat e ICSID, si dhe të caktojnë individë në kolegjet e ICSID të arbitrave dhe të pajtuesve.

Një numër i njoftimeve dhe përcaktimeve nga shtetet kontraktuese janë të mundshme në bazë të konventës ICSID, të cilat janë regjistruar në një dokument të quajtur ICSID / 8. Kjo përfshin përjashtimin e territoreve të caktuara të një shteti nga fushëveprimi i konventës (neni 70), shtrirja e juridiksionit të konventës në nëndarje ose agjenci specifike të një shteti (neni 25 (1)), duke përfshirë ose përjashtuar klasa të caktuara të mosmarrëveshjeve nga juridiksioni i ICSID (neni 25 (4), caktimin e gjykatave ose autoriteteve të tjera për njohjen dhe zbatimin e çmimeve të ICSID, dhe miratimin e masave legjislative ose të tjera që janë të nevojshme për ta bërë konventën ICSID efektive në territorin e një shteti (neni 69).

Që nga viti fiskal 2019, shtetet anëtare kanë bërë 93 njoftime dhe përcaktime të tilla. (ICSID Annual Report, 2019) Në raportin e ICSID, njashtu bëhet e ditur se Kosova ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Austrinë, Zvicrën, Belgjikë-Luksemburg (ICSID, 2020)

Konventa ICSID (Rregullat e Arbitrazhit) - Praktika gjyqësore e ICSID ndërmjet palëve Kosovë – Gjermani

Kosova si një shtet i pasluftës, ngadalë por gradualisht është bërë anëtar i shumë organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe anëtarësimin në qendrën për zgjidhjen e kontesteve të investimeve ndërkombëtare ICSID, duke nënshkruar Konventën ICSID në korrik të vitit

2009, që njëkohësisht hap rrugën për investime të huaja. Kosova poashtu ka qenë anëtare e FMN-së dhe bankës ndërkombëtare për rindërtim dhe zhvillim që nga viti 2009. Për më tepër, Kosova u pranua kohët e fundit si shteti anëtar më i ri i PCA. Kosova që kishte hyrë në IBRD më 29 qershor 2009, përmbushi kushtin për anëtarësim të përcaktuar në nenin 67 (a). Nënshkrimi i konventës ICSID ishte megjithatë, vetëm një pikë e parë, që do të merrej para 'depozitimit të një instrumenti të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Një akt zyrtar i ratifikimit, pranimit ose miratimit kërkohet me të vërtetë nga shteti nënshkruar si një parakusht për hyrjen në fuqi të konventës ICSID për atë shtet. Instrumenti i tillë do të depozitohet në departamentin e sekretarit të bankës botërore, i cili është depozituesi i konventës. Në përputhje me nenin 68 (2) të saj, konventa hyn në fuqi për shtetin në fjalë, 30 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit. Siç u përmend më parë, Kosova depozitoi instrumentin e saj të pranimit të 100-të të konventës ICSID, pranë bankës botërore në të njëjtën ditë në të cilën ajo nënshkroi konventën e 101-të, prandaj kjo hyri në fuqi për Republikën e Kosovës një muaj më vonë, që i bie më 29 korrik 2009. (Dupont, 2020). Të gjitha këto anëtarësime të Kosovës në organizata ndërkombëtare luajnë një rol shumë të rëndësishëm për pozicionimin e saj si një shtet me mundësi për investime të huaja.

Qendra ICSID është krijuar nga konventa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për investime midis shteteve, dhe nuk kishte shumë kohë pas nënshkrimit të konventës ICSID nga ana e Kosovës, me c'rast u përball me pretendimin e saj të parë për investime. Konkretisht subjekt i mosmarrëveshjes kanë qenë Bit Gjermania dhe Kosova në sektorin ekonomik ku janë zbatuar rregullat e arbitrazhit sipas konventës ICSID. (ICSID, 2020). Investitori gjerman Axos Capital Partners, paraqiti një kërkesë kundër Kosovës duke kërkuar 180 milion € (200 milion USD) si dëmshpërblim. Kërkesa u paraqit nën BIT të Gjermanisë - Jugosllavisë 1989, për të cilën investitori argumentoi se Kosova ishte e detyruar nga ligjet e trashëgimisë shtetërore (International Arbitration Information, 2020)

Çështja ka të bëjë me privatizimin e ndërmarrjes postare dhe telekomunikuese të Kosovës ("PTK") për të cilën paditësi fitoi një tender për të blerë 75 përqind të aksioneve të saj. Sidoqoftë, qeveria kosovare u tërhoq nga marrëveshja dhe në mes të vitit 2014, PTK hyri në një kontratë të re me Alcatel-Lucent dhe Nokia Siemens Network Services. Përveç kësaj, sindikata e PTK-së protestoi kundër shitjes së kompanive shtetërore, duke deklaruar frikën se privatizimet do të çonin në një ndërprerje të vendeve të punës. Gjykata ICSID u krijua në

dhjetor të vitit 2015, kryesuar nga Phillipe Pinsolle (Franko-Zvicerian), Michael Feit (Zvicero-Izraelit), i caktuar nga Paditësi dhe J. Christopher Thomas (Kanadez), i caktuar nga pala e paditur.

Në vijim paraqesim në formë tabelare procedimin në mes ACP Axos Capital GmbH kundrejt Republikës së Kosovës (Çështja ICSID Nr. ARB / 15/22)

<i>Data</i>	<i>Zhvillimi</i>
4 qershor 2015	Sekretari i Përgjithshëm regjistron një kërkesë për institucionin e procedurave të arbitrazhit.
18 shtator 2015	Pas emërimit nga Paditësi, Michael Feit (Izraelit / Zvicëran) pranon emërimin e tij si arbitër.
23 shtator 2015	Pas emërimit nga i Padituri, J. Christopher Thomas (Kanadez) pranon emërimin e tij si arbitër.
2 dhjetor 2015	Pas emërimit nga Sekretari i Përgjithshëm, Philippe Pinsolle (Francez / Zvicëran) pranon emërimin e tij si arbitër kryesues.
3 Dhjetor 2015	Tribunali themelohet në përputhje me nenin 37 (2) (a) të Konventës ICSID. Anëtarët e tij janë: Philippe Pinsolle (Frëngjisht / Zvicër), President, i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm në përputhje me marrëveshjen e palëve; Michael Feit (Izraelit / Zvicëran), i emëruar nga Paditësi; dhe J. Christopher Thomas (Kanadez), i emëruar nga e Paditura.
1 Shkurt 2016	Tribunali zhvillon një sesion të parë me konferencë telefonike.
10 Shkurt 2016	Tribunali lëshon Urdhërin Procedural Nr. 1 në lidhje me çështjet procedurale.
24 qershor 2016	Paditësi paraqet një memorial për meritat.
23 Dhjetor 2016	E Paditura paraqet një kundër-memorial për meritat dhe një memorial për juridiksionin.
23 Shkurt 2017	Secila palë paraqet një kërkesë në Tribunal për të vendosur mbi prodhimin e dokumenteve.
6 Mars 2017	Tribunali lëshon Urdhërin Procedural Nr. 2 në lidhje me prodhimin e dokumenteve.
14 qershor 2017	Paditësi paraqet një kërkesë në lidhje me prodhimin e dokumenteve.
16 qershor 2017	Paraqitësi i kërkesës paraqet një përgjigje mbi meritat dhe kuantumin dhe një kundër-memorial për juridiksionin.
21 qershor 2017	Pala e paraqet vërejtjet mbi kërkesën e Paditësit të 14 qershorit 2017.
5 korrik 2017	Tribunali lëshon Urdhërin Procedural Nr. 3 në lidhje me prodhimin e dokumenteve.
1 shtator 2017	E paditura paraqet një përgjigje për meritat dhe kuantumin dhe një përgjigje për juridiksionin.
29 shtator 2017	Paditësi paraqet një përgjigje për juridiksionin.
3 Tetor 2017	Presidenti zhvillon një takim organizativ para dëgjimit me palët përmes një konference telefonike.
6 tetor 2017	Tribunali lëshon Urdhërin Procedural Nr. 4 në lidhje me organizimin e seancës.
6 nëntor 2017 - 13 nëntor 2017	Tribunali zhvillon një seancë dëgjimore mbi juridiksionin, meritat dhe kuantumin në Paris.
12 Dhjetor 2017	Secila palë paraqet një deklaratë të kostove.
20 dhjetor 2017	Secila palë paraqet vëzhgime mbi deklaratën e shpenzimeve të palës tjetër.
4 Prill 2018	Tribunali deklaron procedimin e mbyllur në përputhje me Rregulloren 38 (1) të Arbitrazhit ICSID.
3 maj 2018	Tribunali jep çmimin e tij.

Tabela 3. ACP Axos Capital GmbH k. Republikës së Kosovës (Çështja ICSID Nr. ARB / 15/22) PROCEDIMI
Burimi: ICSID Case Details (ICSID, 2020)

Në tabelë është paraqitur procedimi në mes ACP Axos Capital GmbH, kundrejt Republikës së Kosovës (Çështja ICSID Nr. ARB / 15/22) ku vërrejmë një periudhë kohore 3 vjeçare, konkretisht 4 qershor 2015 ku sekretari i përgjithshëm regjistron një kërkesë për institucionin e procedurave të arbitrazhit, rrjedhimisht bazuar në aspektet procedurale me datë 3 maj 2018 tribunali jep çmimin e tij. Një çmim i datës 3 maj 2018, ku gjykata në qendrën ndërkombëtare për

zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve (ICSID) hodhi poshtë pretendimet e sjella nga kompania gjermane ACP Axos Capital GMBH (Axos) kundër Kosovës pas anulimit nga Kosova të tenderit dhe shitjes së 75 përqind të aksioneve të Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK). Gjykata gjeti se i mungonte juridiksioni mbi arbitrazhin, me arsyetimin se nuk ekzistonte ndonjë kontratë e vlefshme midis Axos dhe Kosovës sipas ligjit kosovar. (IISD, 2018,a)

Konkretisht, Kosova bëri rastin që, edhe nëse kishte një marrëveshje ndërmjet konsorciumit dhe Kosovës, marrëveshja e tillë nuk ishte e vlefshme pasi që nuk ishte ekzekutuar në përputhje me Ligjin e Kosovës për Partneritet Publiko-Privat (PPP). Në të vërtetë, ligji kërkonte që përfaqësuesi i autorizuar i partnerit privat dhe përfaqësuesi më i lartë i shtetit (domethënë ministri që kryeson GPC) të nënshkruajnë marrëveshjen. Gjykata gjeti se, pa mungesën e nënshkrimit të ministrit, nuk kishte asnjë kontratë të vlefshme. Bazuar në konstatimin e tij se nuk ekzistonte asnjë kontratë e vlefshme midis Axos dhe Kosovës për shitjen e aksioneve të PTK-së, gjykata arriti në përfundimin se asnjë investim nuk ekzistonte nën kuptimin e BIT-it neni 1 (1) dhe se ai nuk kishte juridiksion mbi mosmarrëveshjen. Në dritën e mbrojtjes së suksesshme të Kosovës, gjykata vendosi që Axos do të përballonte të gjitha shpenzimet e arbitrazhit dhe tarifat e arsyeshme ligjore dhe shpenzimet e Kosovës, duke urdhëruar Axos që t'i paguante Kosovës 1,713,349.40 USD dhe 132,446.20 EUR. (IISD, 2018,b)¹

KAPITULLI VI

¹Pwr mw tepwr ndiq linkun:

<https://icsid.worldbank.org/apps/icsidweb/cases/Pages/casedetail.aspx?CaseNo=ARB/15/22&tab=PRD>
<https://www.oecd.org/investment/globalforum/44246234.pdf>

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË NË KRAHASIM ME VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE SHTETET MË TË REJA ANËTARE TË BE-SË

Rëndësia e Investimeve të Huaja Direkte në Kosovë dhe rajon

Investimet e Huaja Direkte janë një katalizator që e vë në funksion procesin e zhvillimit të vendit, prandaj zënë një vend të pa kompromis në rëndësinë që kanë për ekonominë tonë. Në konferencën “Bashkëpunimi rajonal si forcë shtytëse për rritje ekonomike dhe stabilitet” në mes të tjerave thuhet: “Standardet e BE-së duhet të jenë korniza absolute për gjithçka realizohet në këtë rajon, dhe duhet të nisë nga shteti i së drejtës”.

Shteti i së drejtës është reforma themelore për çdo shtet të ballkanit perëndimor, pasi pa të do të ishte e pamundur krijimi i një lloj besimi dhe parashikueshmërie, që është e rëndësishme jo vetëm për marrëdhëniet dypalëshe mes shteteve të rajonit, por edhe në marrëdhëniet me BE-në (Albanian Council on Foreign Relations, 2014, p. 16). Kjo lë të kuptohet që sundimi i së drejtës në një shtet demokratik është i domosdoshëm në tërheqjen e kapitalit të huaj në përgjithësi dhe Investimeve të Huaja Direkte, në veçanti në rastin e Kosovës dhe të rajonit.

Andaj, mund të themi se investimet karakterizohen nga fakti se ato në afat të shkurtër ndikojnë në prodhim nëpërmjet efektit mbi kërkesën agregate, kurse në afat të gjatë ndikojnë mbi ofertën agregate me anë të efektit në rritjen e kapitalit dhe të produktit potencial. Ato janë të përcaktuara nga (Polovina & Mediq, 2002)

- madhësia e të hyrave (rendimenteve) nga investimet;
- madhësia e shpenzimeve të investimit, ku më të rëndësishme janë kamatat dhe tatimet;
- pritjet dhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme.

Të gjitha këto kanë një mbështetje logjike, nëse kthehemi në retrospektivë dhe bëjmë një komperacion ndërmjet periudhave para dhe pas aplikimit të investimeve të jashtme direkte. Shohim se shumica e indikatorëve ekonomikë janë në avantazh + në momentet kur janë absorbuar investimet e jashtme direkte.

Hyrjet e investimeve të jashtme direkte mund të pranohen si një konglomerat i beneficioneve, përfshirë këtu rritjen e prodhimit, rritjen e punësimeve, transferin e dijes, teknikës dhe teknologjisë ose know-how, rritja e eksportit dhe përmirësimi i bilancit të pagesave, diversifikim të tregut, rritjen e konkurrencës etj.

Investimet e Huaja Direkte në Kosovë në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor

Në këtë pjesë të kapitullit elaborohet trendi i IHD-vë në rastin e Kosovës në komparacion me vendet e ballkanit perëndimor dhe disa shtete më të reja anëtare të bashkimit evropian. Krahas IHD-ve pasqyrohet rritja e PBB-së për kokë banori dhe norma e rritjes së popullsisë në përqindje, bazuar në indikatorët e bankës botërore për periudhë kohore 2000-2018.

Fokusi kryesor i çdo qeverie është të tërheq kapitalin nga jashtë, pasi që zhvillimi ekonomik kërkon burime të mëdha financiare. Nëse kursimet lokale janë të ulëta, kapitali i huaj është i mirëpritur për të nxitur rritjen ekonomike, si dhe rritjen e standardit të jetesës. Me IHD-të, një vend pritës nuk duhet të zvogëlojë konsumin për të reduktuar deficitin e llogarisë korente. Nga ana tjetër, investimet kapitale nga jashtë mund tu ndihmojnë investitorëve për të diversifikuar portofolet e tyre duke investuar në vende të ndryshme. Si pasojë, ata zvogëlojnë rrezikun e përgjithshëm të portofolit të tyre duke diversifikuar atë. Investitorët e huaj fitojnë qasje në treg, si dhe inpute me kosto të ulët.


Qeveria e Kosovës e ka miratuar projektligjin për investime strategjike në vitin 2015 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2017), ligj ky i cili ka për qëllim të lehtësojë barrierat për investitorët potencialë në Kosovë.

Përveç lehtësimit të procedurave, Qeveria e Kosovës përmes këtij ligji ka të drejtën të negociojë drejtpërdrejt me investitorë dhe të nxisë investime në rast se ata i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj dhe qëllimi kryesor i ligjit është nxitja e investimeve. Në shtetet e rajonit, është diskutuar mjaft shumë sa i përket aspektit të lehtësirave që i sjellin këto ligje që mund të nxisin investime të shumta të huaja, gjë që ka nxitur shumë debate dhe reagime se qeveria mund të merr shumë kompetenca duke mos iu nënshtruar asnjë kontrolli të jashtëm dhe mundësia për korrupsion është relativisht e theksuar. Shqetësime të tilla janë paraqitur në Kroaci dhe Shqipëri. Duke iu referuar kësaj analize mund të konkludohet lidhur me

përparësitë dhe mangësitë që mund të dalin nga Ligji për Investime Strategjike në Kosovë.

Flukset e IHD-ve janë rritur ndjeshëm gjatë tri dekadave të fundit, sepse kompanitë kërkojnë vazhdimisht tregje të reja, një mundësi për të zvogëluar rrezikun nga diversifikimi, përfitimin më të lartë. Jo vetëm investitorët e huaj kanë përfitime nga Investimet e Huaja Direkte, por gjithashtu edhe vendi pritës i ka avantazhet e veta, pasi që rritet konkurrenca, njohuritë teknologjike si dhe zvogëlohet shkalla e papunësisë. Lëvizja e lirë e kapitalit midis vendeve është e dobishme për zhvillimin ekonomik, për shkak se ajo ndan kursimet për përdorimin e tyre në mënyrë sa më produktive.

Duke pasur parasysh rëndësinë e IHD-ve për promovim të zhvillimit të udhëhequr nga sektori privat në Kosovë, me investitorët e huaj, për të mësuar më shumë se sa perceptohet se është tërheqëse Kosova për investitorët e huaj duhet bërë anketa dhe analiza krahasimore në lidhje me IHD-të (Krugman & Obstfeld, 2010). Rezultatet e këtyre analizave të bëra tregojnë që investitorët kanë parë zhvillime pozitive në Kosovë, derisa e kanë vlerësuar atë si vend me tranzicion të suksesshëm dhe qasje në institucionet ndërkombëtare. Hapja e bizneseve në Maqedoni ka qenë reformuesi më i suksesshëm ndër shtetet në tranzicion për thjeshtimin e regjistrimit të bizneseve.



Grafiku 1. IHD-të në Kosovë në komparacion me vendet e Ballkanit Perëndimor

Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori, <https://data.eorlbank.org/indicator>

Bazuar në grafikun mbi Investimet e Huaja Direkte në Kosovë në komparacion me vendet e


ballkanit perëndimor, vërrejmë se në Kosovë, IHD-të në vitin 2004 kanë qenë 1.50 dhe shënojnë një trend rritës të shpejtë, ku në vitin 2007 arrin në 12.97 që njëherit paraqet nivelin më të lartë të IHD-ve në rastin e Kosovës. Nga viti 2007 deri në vitin 2018, IHD-të shënojnë trend në ulje, në vitin 2018 arrijnë në 4,01. Shqipëria në përgjithësi shënon një trend pozitiv në rritje graduale ku në vitin 2001 norma e IHD-ve në rastin e Shqipërisë shënon 4.11 kurse në vitin 2018 arrin në 7.97. Maqedonia e Veriut në vitin 2000 ka shënuar IHD-të në vlerën prej 5.77 dhe në përgjithësi trendi ndër vite është rrënës (një rrënie dhe ngritje e lehtë) në vitin 2018 arrin në 5.12. Serbia në vitin 2010 shënon IHD-të në vlerë prej 10.25, kështu deri në vitin 2018 trendi është luajtës në ulje - ngritje jo shumë të theksuara. Në vitin 2018 IHD-të arrijnë në 8.05. E sa i përket Bosnjës dhe Hercegovinës vërrejmë se IHD-të kanë trend më të ulët në krahasim me të gjitha vendet e tjera të ballkanit perëndimor, konkretisht në vitin 2000 norma e IHD-ve ka qenë 2.65 dhe në vitin 2018 arrin në 2.42.

Mali i Zi është një nga shtetet e ballkanit perëndimor që ka pasur IHD-të në nivel më të lartë, krahasimisht me vendet e tjera, më konkretisht në vitin 2007 norma e IHD-ve ka qenë 25.7 dhe në vitin 2018 trendi është në rrënie për të arritur në 8.82.

Marrë për bazë vitin 2018, në analizën e IHD-ve mbi vendet e ballkanit perëndimor, në rrugën drejt tërheqjes së IHD-vë, vërrejmë se Mali i Zi është vendi me IHD – të më të larta pasuar me Serbinë, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe në fund Bosnja dhe Hercegovina. Nga kjo rradhitje konstatojmë se Kosova në kuadër të vendeve të ballkanit perëndimor është vendi i parafundit për sa i përket normës së IHD-ve si përqindje e PBB-së.

Indikatorët kryesorë makroekonomik të Kosovës dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor

Në këtë pjesë të kapitullit elaborohen indikatorët kryesorë makroekonomik, përsirë produktin e brendshëm bruto për kokë banori, Investimet e Huaja Direkte dhe normën e rritjes së popullsisë për vendet e ballkanit perëndimor.



Grafiku 2. IHD-të në Kosovë në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë

Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori,


<https://data.worldbank.org/indicator>

Bazuar në të dhënat e interpretuara në grafikë të cilat janë të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, mirëpo të kalkuluara nga vetë autori, janë të paraqitura Investimet e Huaja Direkte në Kosovë në komparacion me rritjen e produktit të brendshëm bruto për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë, në komparacion me vendet e ballkanit perëndimor, shënojnë trend rritës dhe pozitiv. IHD-të në vitin 2004 kanë qenë 1.50 dhe shënojnë një trend rritës të shpejtë, ku në vitin 2007 arrijnë në 12.97 që njëherit paraqet nivelin më të lartë të IHD-ve në rastin e Kosovës. Ndërkaq nga viti 2007 deri në vitin 2018, IHD-të shënojnë trend në ulje me c' rast në vitin 2018 arrijnë në 4,01.

E sa i përket produktit të brendshëm bruto për kokë banori, në rastin e Kosovës vërrejmë një ulje drastike nga viti 2001 ku norma ka qenë 26.88, derisa në vitin 2002 ulet në (0.76). Në vitin 2003 trendi është rritës dhe pozitiv ku norma e PBB-së arrin në vlerën 5.90. Një rritje e theksuar shënohet edhe në vitin 2005 ku norma e PBB-së për kokë banori në Kosovë arrin 5.96, e në vitin 2006 ulet në 3.66, ndërkaq në vitin 2007 norma arrin në 6.42 dhe në vitet në vijim trendi është luhatës në përgjithësi ulës, ku në vitin 2018 arrin në normën 2.99.

Për sa i përket rritjes së normës së popullsisë në Kosovë, bazuar në grafikë, vërrejmë se norma e popullsisë nga viti 2000 deri në vitin 2011 shënon trend pozitiv dhe në rritje, mirëpo ajo që vlen të theksohet është pikërisht se nga viti 2011, norma e popullsisë në rastin e

Kosovës shënon trend rrënës, ku përkatësisht në vitin 2014 norma është negative (0.126) poashtu edhe në vitin 2015 norma është negative në vlerën (1.103).Ndërkaq, nga viti 2016 shënohet një përmirësim i lehtë në rritje, ku në vitin 2018 norma e rritjes së popullsisë në rastin e Kosovës është 0.79.



Grafiku 3. IHD-të në Shqipëri në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë


Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori, <https://data.worldbank.org/indicator>

Investimet e Huaja Direkte në rastin e Shqipërisë, për periudhën e marrë nën shqyrtim, në përgjithësi shënojnë trend rritës dhe pozitiv. IHD-të në Shqipëri në vitin 2000 kanë qenë 4.11 ku vlerën më të lartë e arrijnë në vitin 2009 në normën 11.17 dhe në vitet në vijim trendi është më i ulët, ku në vitin 2018 arrijnë në 7.97. Megjithatë trendi është luhatës vlen të theksojmë se përkundër luhatjeve mbrenda periudhës nën shqyrtim, në mesatare trendi është pozitiv dhe rritës.

Ndërkaq, sa i përket rritjes së produktit të brendshëm bruto për kokë banori, Shqipëria nga viti 2000 deri në vitin 2018 shënon trend përgjithësisht në ulje. Në vitin 2000 norma ka qenë 7.63 me një trend ulës deri në vitin 2008, ku përsëri në vitin 2008 shënohet një trend pozitiv në vlerën prej 8.32. Ajo që vërejmë është se nga viti 2008 deri në vitin 2014 trendi është në rrënie të theksuar, dhe në vitin 2014 arrijnë në 1.98. Nga viti 2015 deri në vitin 2018 trendi përsëri është në rritje, me c'rast më 2018 norma e rritjes së PBB-së për kokë banori në rastin e Shqipërisë arrijnë në normën 4.40.

Sa i përket normës së rritjes së popullsisë vlen të theksojmë se në përgjithësi në rastin e

Shqipërisë shënohet trend negativ, përkatësisht në vitin 2000 norma është negative (0.63) me një ulje përgjatë viteve dhe me disa luhajtje të vogla mbrenda ciklit. Në vitin 2018 norma e rritjes së popullsisë në rastin e Shqipërisë ulet në (0.24) që mund të konsatojmë se në përgjithësi edhe pse në vlera negative përgjatë gjithë viteve nën shqyrtim, trendi është sërish në ulje.



Grafiku 4 IHD-të në Republikën e Maqedonisë së Veriut në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë


Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori, <https://data.worldbank.org/indicator>

Investimet e Huaja Direkte në Maqedoninë e Veriut shënojnë trend pozitiv me disa luhajtje mbrenda periudhës kohore të marrë nën shqyrtim. Bazuar në të dhënat në grafikë vërrejmë se në Maqedoninë e Veriut në vitin 2000 norma e IHD-vë shënon 5.77. Norma më e lartë e shënuar e IHD-ve është në vitin 2001 në vlerën prej 12.66 dhe më pas trendi është në rrënie. Përgjithësisht në vitin 2018 norma e IHD-ve arrin në 5.12.

Produkti i brendshëm bruto për kokë banori në rastin e Maqedonisë së Veriut në vitin 2000 shënon normën 4.01 për të pasuar me normë negative në vitin 2001 në vlerën (3.44). Nga viti 2001 trendi fillon të rritet deri në vitin 2009 ku përsëri shënohet një normë negative në normën prej (0.44). Nga viti 2009 deri në vitin 2018 trendi i produktit të brendshëm bruto në Maqedoninë e Veriut shënon trend pozitiv dhe në vitin 2018 arrin në 2.61.

Norma e rritjes së popullsisë në rastin e Maqedonisë së Veriut shënon trend në ulje. Në vitin

2000 norma e rritjes së popullsisë ka qenë 0.513 dhe për gjatë gjithë periudhës nën shqyrtim shënohet trend në ulje për të arritur në vitin 2018 në normën 0.046.



Grafiku 5. IHD-të në Serbi në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë

Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori, <https://data.worldbank.org/indicator>

Investimet e Huaja Direkte në rastin e Serbisë për periudhën kohore të marrë nën shqyrtim vërrejmë një trend në ulje. Në vitin 2007 norma e IHD-vë në rastin e Serbisë ka qenë 10.25, njëherit edhe vlera më e lartë për gjatë viteve në shqyrtim. Më tej, trendi është luhatës mirëpo përgjithësisht në ulje ku në vitin 2018 arrin në 8.05.

Rritja e PBB-së për kokë banori në rastin e Serbisë shënon në trend përgjithësisht në ulje. Në vitin 2000 norma e PBB-së për kokë banori në rastin e Serbisë është 8.10 duke arritur në normë negative në vitin 2009 respektivisht në normën (2.34). Më pas, me disa fluktuatione në cikël, në vitin 2018 arrin në normën 4.96. Analizuar në mesatare vlen të theksojmë se PBB për kokë banori në rastin e Serbisë shënon trend rrënës për periudhën kohore të marrë nën shqyrtim konkretisht 2000-2018.

Norma e rritjes së popullsisë në rastin e Serbisë për periudhë kohore 2000-2018 është negative dhe rrënëse. Në vitin 2000 norma e rritjes së popullsisë shënon vlerën negative (0.319) ku përgjatë gjithë periudhës norma është negative respektivisht në vitin 2018 arrin poashtu në normë negative konkretisht (0.54).



Grafiku 6. IHD-të në Bosnjë dhe Hercegovinë në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë


Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori, <https://data.worldbank.org/indicator>

Në grafikë janë paraqitur indikatorët kryesorë makroekonomik për Bosnjën dhe Hercegovinën. Vërrejmë se IHD-të në rastin e BH-së në vitin 2000 kanë qenë në normën 2.65 ku përgjatë gjithë periudhës të marrë nën shqyrtim vërehet një normë në rritje e IHD-ve, ku në vitin 2007 arrin në normën më të lartë përgjatë gjithë periudhës në vlerën prej 11.67, e më pas trendi është në rrënie dhe në vitin 2018 arrin në 2.42.

Produkti i brendshëm bruto në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës për periudhën kohore 2000-2018 shënon trend stabil me disa luhatje përgjatë ciklit. Në vitin 2000 norma e PBB-së është 5.28 për të arritur në normën më të lartë përgjatë gjithë periudhës që është 8.72 në vitin 2005 dhe nga viti 2005 trendi është rrënës për të arritur në normën 4.48 në vitin 2018.

Norma e rritjes së popullsisë në Bosnjë dhe Hercegovinë shënon trend rrënës pasi në vitin 2000 norma ka qenë 0.2 kursë në vitin 2018 arrin në normën negative prej (0.82).

Ajo çfarë në përgjithësi vërrejmë është fakti se norma e rritjes së popullsisë në të gjitha vendet e ballkanit perëndimor shënon trend negativ.




Grafiku 7. IHD-të në Mal të Zi në komparacion me rritjen e PBB-së, rritjen e PBB-së për kokë banori dhe normën e rritjes së popullsisë

Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori, <https://data.worldbank.org/indicator>

Në grafikun mbi indikatorët kryesorë makroekonomik për Malin e Zi vërrejmë se Investimet e Huaja Direkte për periudhën kohore të marrë në shqyrtim kanë shënuar trend rrënës, konkretisht në vitin 2007 norma e IHD-ve është 25.47, për të shënuar normën më të lartë përgjatë gjithë periudhës, konkretisht në vitin 2009, norma e IHD-vë kap vlerën 37.27 dhe më pas në vitet në vijim trendi është në rrënie për të arritur në normën 8.82 në vitin 2018.

Bruto produkti i brendshëm për kokë banori në rastin e Malit të Zi shënon një trend rritës analizuar mesatarisht, nën periudhën e marrë nën shqyrtim. Konkretisht në vitin 2000, PBB-ja shënon normën 3.27, dhe norma më e lartë arrihet në vitin 2006, respektivisht me normën 8.43 dhe në vitet në vijim trendi i PBB-së është në rrënie me disa luhate jo shumë të theksuara për të aritur në normën 5.10 në vitin 2018.


Norma e rritjes së popullsisë në Mal të Zi shënon trend përgjithësisht në rrënie. Në vitin 2000 norma ka qenë negative konkretisht (0.02) e më pas edhe pse vërrehet një përmirësim dhe një normë pozitive në vitin 2001 norma arrin në 0.40, mirëpo përgjatë viteve ulet për të arritur në normë negative prej (0.023) në vitin 2018.



Grafiku 8. BPP-ja në Kosovë në krahasim me disa shtete të reja anëtare të BE-së

Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori, <https://data.worldbank.org/indicator>

Bazuar në të dhënat në grafikë mbi produktin e brendshëm bruto, vërrejmë se Kosova shënon trend luhatës, mirëpo në përgjithësi pozitiv. Në vitin 2019 norma e BPP-së në Kosovë arrin në 4.17 që është normë e rritjes shumë më e lartë në krahasim me shtetet e BE-së. Respektivisht në vitin 2019, Sllovenia shënon normën e produktit të brendshëm bruto 2.44, Bullgaria shënon normën 3.37, Kroacia normën 2.94 dhe Sllovakia normën 2.40. Vlen të theksohet se nga viti 2001 ku PBB-ja e Kosovës është 26.97, në vitin 2002 ka vlerë negative në (0.70) dhe nga viti 2003 trendi është luhatës mirëpo i qëndrueshëm.




Grafiku 9. IHD-të në Kosovë në krahasim me disa shtete të reja anëtare të BE-së

Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori, <https://data.worldbank.org/indicator>

Bazuar në të dhënat e indikatorëve të Bankës Botërore për periudhë kohore 2000-2019 mbi

IHD-të për Kosovën, në krahasim me disa vende të bashkimit europian, të cilat së fundmi kanë fituar statusin e anëtarësimit në BE, mund të konkludojmë se norma e IHD-ve në Kosovë ndër vite është më e lartë se norma e IHD-ve në vendet e BE-së, përfshirë Slloveninë, Bullgarinë, Kroacinë dhe Sllovakinë. Investimet e Huaja Direkt në Kosovë në vitin 2004 kanë qenë në normën 1.50, kurse në vitin e fundit të analizës arrijnë në normën 4.01. Edhe pse në Bullgari vërehet një trend shumë i lartë i IHD-ve deri në vitin 2007, ku norma arrin në 31.25, ndërsa në vitet në vijim trendi ulet në vitin 2019 dhe arrin në 2.21. Respektivisht Investimet e Huaja Direkte në vitin 2019 në Slloveni shënojnë normën 2.57, në Bullgari 2.21, në Kroaci 1.94 dhe në rastin e Sllovakisë 2.19. Po të marim në analizë vitet e fundit, vërejmë se Kosova ka normën më të lartë të IHD-ve, respektivisht sa dyfishi i vendeve të BE-së të marra nën analizë.



Grafiku 10. Remitencat në Kosovë në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor

Burimi: Të dhëna dytësore të siguruara nga indikatorët e bankës botërore, kalkulime nga autori, <https://data.worldbank.org/indicator>

Remitencat në Kosovë në vitin 2004, bazuar në indikatorët e bankës botërore kanë qenë 17.49. Në vitet vijuese norma e remitencave rritet, konkretisht në vitin 2006 arrin në normën 20.5. Nga viti 2006 remitencat në Kosovë shënojnë një trend në ulje graduale, konkretisht në vitin 2018, arrijnë në 15.57. Norma e remitencave në rastin e Shqipërisë në vitin 2000 shënon normën 17.18, mirëpo kjo normë në vitet e mara nën analizë për rastin e Shqipërisë shënon një ulje graduale për të arritur në vitin 2018 në normën 9.66. Remitencat në rastin e Malit të Zi, në vitin 2003, shënojnë normën 5.96 dhe në vitin 2018 arrijnë në normën 10.70, konkretisht një trend pozitiv dhe rritës ndër vite.

Remitencat në rastin e Maqedonisë së Veriut në vitin 2000 shënojnë normën 2.14 me disa luhatje të vogla ndër vite, norma arrin në 2.72 në vitin 2018.

Bosnja dhe Hercegovina në vitin 2000 kanë shënuar normën e remitencave prej 28.71 , mirëpo kjo normë e lartë është ulur ndër vite dhe në vitin 2018 arrin në 10.52.

E Serbia, në vitin 2000 shënon normën e remitencave në vlerë prej 6.42 me një trend luhatës ndër vite, kurse në vitin 2018 arrin në vlerën 8.79.

Analizuar remitencat në rastin e Kosovës, krahasuar me vendet e tjera të ballkanit perëndimor vërrejmë se Kosova është vendi me normën më të lartë të remitencave në rajon. Këtu vinë në shprehje kultura, lidhja me familjen, atdhedashësia dhe faktorë të shumtë të cilët ndikojnë që diaspora mos ta harojë Kosovën dhe familjarët e tyre. Poashtu vlen të theksohet se remitencat në Kosovë janë një burim shumë i rëndësishëm i rritjes ekonomike në përgjithësi dhe ndikojnë në rritjen e konsumit për familjet dhe përmirësimin e standardit jetësor dhe mirëqenies sociale.

Aspekte analitike mbi IHD-të në Kosovë

Standardizimi global i promovimit të investimeve, i grupit të bankës botërore për Kosovën identifikon fushat e përmirësimit duke filluar nga informatat specifike siç janë: përparësitë kryesore, studimet e rastit, aftësitë, koston dhe të dhënat krahasimore për personelin anglistfolës që mund t'iu përgjigjen pyetjeve (MIGA-Fias, 2005). Gjithashtu, ka pasur një lëvizje të fokusit kah investitorët ekzistues për t'iu ndihmuar të mbajnë dhe zgjerojnë bizneset e tyre. Ndërsa investitorët ekzistues në Kosovë kanë treguar interesim të konsiderueshëm për zgjerimin e biznesit të tyre, dhe qeveria duhet të kërkojë mënyra për t'i përkrahur të gjithë ata.

Firmat e huaja janë duke marrë në konsideratë investimin në Kosovë, me gjithë vështirësitë që kanë për shkak të mungesës së njohurive për situatën. Ato firma që tashmë janë të pranishme në Kosovë, kanë më së shumti mundësi të investojnë, dhe gati gjysma prej tyre kanë deklaruar që do të investojnë më shumë në tri vitet e ardhshme. Kompanitë në sektorin e teknologjisë informative (TI), mallrat për konsum, tekstili dhe logjistika kanë më së shumti gjasa të investojnë në Kosovë.

Statusi i investimit strategjik ose projektit investues strategjik mund të fitohet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me ligj, për projektet nga sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik e social të cilët i kontribuojnë rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, rritjes së aftësisë konkurruese të ekonomisë së Kosovës, rritjes së eksportit dhe zvogëlimit të deficitit tregtar dhe që përgjithësisht ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe të kushteve të jetesës së qytetarëve të Republikës së Kosovës në sektorët, (Ligji nr.05/L-079, p. 15) si:

- Energji me infrastrukturë dhe miniera;
- Transport dhe telekomunikacion;
- Turizëm;
- Industri përpunuese;
- Bujqësi dhe industri ushqimore;
- Shëndetësi;
- Parqe industriale dhe teknologjike;
- Administrim i ujërave të zeza dhe mbeturinave.

Investimet direkte në përgjithësi definoohen si depozitime të kapitalit të huaj apo të kapitalit të ndërmarrjeve të jashtme me qëllim të qeverisjes, po edhe të një kontrolli të mundshëm të këtyre ndërmarrjeve në kuadër të tregut relevant (Duning & Narula, 1996). Në Kosovë çështja e investimeve dhe investitorëve është e garantuar edhe me kushtetutë të vendit, ku në paragrafin 6 të nenit 119 thuhet:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës jep garanci direkte për atë, që është një nga interesat themelore të investitorëve të huaj. Pra, është diktues i politikave fiskale të lira në rastet e lëvizjes së kapitaleve brenda apo jashtë vendit, por duke e sanksionuar në pjesën e tij të fundit “në pajtim me ligjin”, e cila nënkupton se kapitali nuk mund të hyjë brenda dhe të dalë jashtë shtetit të Kosovës, nëse paraprakisht nuk i ka kryer të gjitha obligimet ligjore.

Konkretisht kapitali i fituar brenda territorit të Kosovës duhet të jetë i tatuar nga shteti i

Kosovës, pastaj pjesa e mbetur është në disponimin e plotë dhe të lirë të investitorit të cilit i përket kapitali (Bajrami, Sistemi kushtetues i Kosovës,, 2011, p. 401)

Në analizën e tregut, shkallët tatimore nuk kanë ndikuar në nxitjen e konkurrencës midis investitorëve, me atë forcë të efektit nxitës që kanë dhënë politikat për shkallët tatimore në vende të tjera të rajonit (Kroaci dhe Mali i Zi). Ndërkaq, lehtësirat fiskale kanë favorizuar vlerat e investuara dhe investitorët në industrinë nxjerrëse dhe përpunuese, energjetikë, prodhimet e materialeve të ndërtimit dhe industriale, eksportues të industrisë së veshjeve, kontraktorë ndërtimi të infrastrukturës dhe shërbime të transportit (Calderoni, 2014)

Por, a është arritur objektivi afatshkurtër në financat publike dhe ekonomi? Nga zhvillimi i politikave fiskale ka pjesë të ardhurash që buxheti i humbet! Këto efekte me vlerë zbritëse llogariten si të ardhura, që buxheti nuk do t'i përfshijë në të ardhmen. Por, nga ana tjetër kur miratohen politikat fiskale me lehtësira për investimet, duhen konsideruar me detaje instrumentet e mirë administrimit (si pjesë të strategjisë vizionare të zhvillimit ekonomik) (Meier & Rauch, 2000)

Kjo ndërthurje i jep mundësi buxhetit të fitojë pjesë të tjera edhe më të mëdha të ardhurash në të ardhmen, si dhe për periudha afatgjata, duke ndikuar në forcimin dhe konsolidimin fiskal. Efekti i investimeve në funksion të të ardhurave fiskale ka regjistruar një kontribut gjithsejtë sa 11% e totalit të të ardhurave nga tatimet dhe doganat në 5 vitet e fundit (730 milionë dollarë).

Duhet theksuar fakti, se ky kontribut, nga aktivitetet investuese të kompanive të mëdha përfshin brenda tij edhe kërkesat për rimbursim të bizneseve që bashkëpunojnë me to dhe lehtësirat në import për investimet. Ajo që duhet të arrijë ekonomia është forca e efektit nxitës të lehtësirave fiskale për rikuperim të shpejtë të vlerës së investuar dhe kompaktësimit të vlerës së shtuar nga investitorët. Këto elemente vërehen, nëse depërtojmë në vlerat e investimeve dhe shpërndarjen e tyre në ekonomi (Meier & Rauch, 2000)

Ndërkaq, një rritje të peshës së investimeve e ka marrë industria nxjerrëse dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore me një nivel deri 1/3 e investimeve të huaja gjithsejtë.

Pjesa tjetër e investimeve përfshin gjithë sektorët e tjerë, ku bëjnë pjesë: depërtimi i kapitalit në sektorin e shërbimeve turistike, përfshirë lojërat e fatit, sektorin e prodhimeve gjysmë të

gatshme, sektorin e përpunimit të produkteve natyrore bujqësore, mjekësore dhe blegtorale, si dhe sektorin e ndërtimit infrastrukturor dhe shërbimet financiare (Calderoni, 2014)

Nga të metat e investimeve po nënvizojmë kërkesën e investitorëve të jashtëm në projekte rentabile dhe të leverdishme, ku shpeshherë më shumë vetëm për ata, pastaj për gjithë strukturën ekonomike kërkojnë që t'iu përshtatet vetëm interesave dhe investimeve të tyre, mundohen të krijojnë politika në favor të vendit importues të kapitalit, me një fjalë i përkushtohen në përgjithësi parametrate që kanë impakte më të shumta në ekonominë e vendeve të tyre dhe operatorit të tyre ekonomik në kuptimin e varshmërisë prodhuese, shkencore, teknike, tregtare dhe financiare nga investuesi i jashtëm (Berisha, 2002, p. 72). Investimet direkte mund të kenë edhe karakter të trefishtë (Mirkusic, 2008) si investimet direkte që mundësojnë realizim të eksportit, investimet direkte që rrisin importin, dhe investimet e tjera direkte. Investimet e grupit të parë që mundësojnë realizimin e eksportit përdoren në ndërtimin e të ashtuquajturave fabrika doganore.

Grupi i dytë i investimeve që rrisin importin kryesisht ka ardhur në shprehje te ato vende dhe industri të cilat janë të orientuara kryesisht në burime të brendshme, që mendohen se një ditë mund edhe të shterohen e më pastaj ato duhet të furnizohen nga burime të jashtme. Dhe investimet direkte janë ato që në kuptimin e përgjithshëm angazhohen në infrastrukturë, si p.sh. ndërtimi i hekurudhave, rrugëve të asfaltuara, urave dhe të tjera.

Është një rregull apo praktikë që investitorët e jashtëm kur ndërtojnë ndonjë kapacitet prodhues në ndonjë vend të caktuar, aty po ashtu ata ndërtojnë edhe infrastrukturën përcjellëse të asaj fabrike apo kapaciteti tjetër prodhues dhe i cili është në shërbim të tërë ekonomisë së vendit të caktuar.

Projektimet indikative të investimeve të nevojshme

Në rastin e Kosovës, vlerësimet e kapaciteteve investuese (sektorët & burimet) janë posaçërisht të rëndësishme duke marrë parasysh nevojën që ka Kosova për mobilizimin e të gjitha burimeve investuese. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për vlerësimin e kapaciteteve investuese publike. Ky vlerësim është plotësisht indikativ dhe është i dedikuar për të treguar se çfarë përpjekjesh duhet bërë për të realizuar një rritje dinamike ekonomike.

Projektimet e strukturës indikative investuese për periudhën 2005-2015 janë bazuar në këta

faktorë (BQK, 2005): trendet ekonomike të pas luftës në Kosovë, planet aktuale të përpiluara nga institucionet e Kosovës dhe posaçërisht nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Energjetikës dhe Minierave, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (Arsimi i lartë) si dhe disa projekte brenda AKM-së (Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit), përvojat e vendeve të tjera, posaçërisht përvojat e shteteve fqinje dhe shteteve në tranzicion, dhe objektivat zhvillimore.

Investimet ekonomike në Kosovë

Kosova edhe pse vend i vogël dhe i posa formuar ka një ekonomi të re dhe mjaft dinamike, e cila krahasuar me vendet e tjera është për tu admiruar me gjithë vështirësitë dhe të metat e saj. Krahas kësaj, Kosova cilësohet të jetë vend me kapacitet të ulët udhëheqës, pastaj, niveli i lartë i korrupsionit në institucionet shtetërore dhe i perceptimit të korrupsionit kanë kontribuar në imazhin e Kosovës si vend jo i preferueshëm për investime (Indeksi i Lirisë Ekonomike, 2016)

Agjencia për Investime, përveç detyrave dhe kompetencave që ka në kuadër të Ligjit përkatës për Investimet e Huaja, në kuptim të zbatimit të këtij ligji, ka edhe këto përgjegjësi (Ligji nr.05/L-079, p. 21):

- Përcakton dhe përshkruan detyrat, veprimet dhe procedurat e secilit autoritet publik në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e çdo projekti individual për investime strategjike dhe informon investitorin e interesuar;
- Kryen veprime që lidhen me paraqitjen e zhvillimit të projektit dhe që mbështesin kryerjen e investimit strategjik dhe hartimin e një liste masash e dokumentesh që duhet të përmbajë dhe/ose duhet të merren për të realizuar projektin e investimit strategjik, përmes procedurave të përsheptuara;
- Bën harmonizimin dhe koordinimin e aktiviteteve të autoriteteve publike për përgatitjen dhe draftimin e dokumenteve të nevojshme, për realizimin e projektit dhe të afateve për zbatimin e tyre, në përputhje me kompetencat e institucioneve përkatëse;
- Bën vlerësimin teknik të projektit të investimit strategjik, të potencialit strategjik të tij, të riskut operacional dhe të planit të veprimit për realizimin e

këtij projekti;

- Analizon profilin e subjektit investues dhe për këtë qëllim ka të drejtë t'i kërkojë investitorit informacion lidhur me kapacitetin financiar dhe aftësinë e tij për të gjeneruar fonde të mjaftueshme për financimin e investimit, deklaratat financiare, strukturën menaxheriale, pronësinë, pozicionimin në treg, eksperiencat e mëparshme lidhur me fushën e investimit, projektet e ngjashme, si dhe elemente të tjera të nevojshme për të provuar aftësitë për të qenë investues strategjik, sipas kriterëve të këtij ligji;
- I propozon komisionit vendimin për dhënien e statusit investim strategjik, për refuzimin e propozimit për dhënien e statusit investim strategjik dhe për anulimin e vendimit për dhënien e statusit investim strategjik.

Investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe kompanitë multinacionale

Një pjesë e konsiderueshme e mobilitetit ndërkombëtar të kapitalit ka të bëjë me formën tjetër të transaksionit, me investimet e huaja të drejtpërdrejta (Helpman, 2006). Ato nënkuptojnë rrjedhat ndërkombëtare të kapitalit në të cilat ndërmarrja prej një shteti e krijon apo e zgjeron ekspoziturën në shtetin tjetër. Karakteristika e rëndësishme e investimeve të huaja të drejtpërdrejta ka të bëjë me faktin se ato nuk përfshijnë vetëm transferin e resurseve, por edhe marrjen e mbikqyrjes drejtuese. Me fjalë të tjera, ekspozitura nuk e ka vetëm obligimin financiar ndaj ndërmarrjes mëmë, por është pjesë e strukturës së njëjtë organizative.

Kur mund ta quajmë një ndërmarrje multinacionale? Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndërmarrja në pronësi të pronarit të huaj merret si ekspoziturë e firmës së huaj multinacionale, nëse më së paku 10% e kapitalit aksionar janë në posedimin e të huajit. Pra, 10% e kapitalit aksionar është mjaft për tu fituar mbikqyrja drejtuese. Ndërmarrja amerikane merret si multinacionale, nëse posedon pakon e aksioneve të ndërmarrjes së huaj, që i mundëson mbikqyrje drejtuese (Helpman, 2006)

Firmat multinacionale shpesh i kontribuojnë borxhit dhe huazimit ndërkombëtar. Ndërmarrja mëmë e furnizon shpesh ekspoziturën e vet të jashtme me kapital dhe pret kthimin e parave të huazuara në të ardhmen. Investimet e huaja të drejtpërdrejta paraqesin mënyrën alternative të financimit të ekspoziturës së jashtme me huazim ndërkombëtar. Mirëpo, kjo e lë edhe më

tutje të hapur pyetjen se pse pikërisht investimet e huaja zgjidhen si mënyrë e financimit, e jo si ndonjë formë tjetër e transferimit të mjeteve financiare.

Sidoqoftë, ekzistimi i firmave multinacionale nuk shpreh medoemos rrjedhat neto të kapitalit prej një shteti në tjetrin. Firmat multinacionale, kurdo që vijnë deri te mjetet financiare, zgjerimin afarist të ekspoziturave të veta e bëjnë në shtetet ku veprojnë ato ekspozitura, e jo në shtetin e vet amë. Përpos kësaj, ekzistojnë edhe investimet e jashtme të drejtpërdrejta, të dyanshme ndërmjet shteteve industriale prej të cilave, për shembull, ndërmarrja amerikane e zgjeron afarizmin e ekspoziturës së vet evropiane në të njëjtën kohë kur ndërmarrja evropiane e zgjeron afarizmin e ekspoziturës së vet amerikane (Larrain, Calava, & Clare, 2000)²⁰⁴.

Konstatimi është, se derisa firmat multinacionale u kontribuojnë rrjedhave ndërkombëtare të kapitalit, nuk është e drejtë që të merren në rend të parë investimet e huaja të jashtme si mënyrë alternative në të cilën shtetet mund të hyjnë borxh dhe të huazojnë, ngase ato mundësojnë krijimin e firmave multinacionale. Me fjalë të tjera, zgjerimi i mbikqyrjes drejtuese është roli kryesor i investimeve të huaja të jashtme.

Teoria bashkëkohore e firmave multinacionale bazohet në dallimin e dy pyetjeve. E para, pse prodhohet e mira në dy (apo më shumë) shtete e jo vetëm në një shtet. Kjo pyetje quhet pyetja e lokacionit. Pyetja e dytë: pse një ndërmarrje, e jo shumë sosh prodhon në lokacione të ndryshme? Kjo pyetje quhet për shkaqe që do t'i shpjegojmë më vonë, pyetja e internalizimit (Winder, 2012). Teoria e lokacionit, shikuar në përgjithësi, është lehtë e kuptueshme. Në fakt, ajo është identike me teorinë e tregtisë, kurse lokacioni i prodhimit përcaktohet më së shpeshti me resurse.

Kompanitë multinacionale në praktikë

Kompanitë multinacionale luajnë rol të rëndësishëm në tregtinë botërore dhe në investime. Për shembull, gati gjysma e importit amerikan është e lidhur me transaksionet ndërmjet “palëve të ngjashme”. Palët e ngjashme paraqesin blerës dhe shitës, pronari dhe menaxheri i të cilëve është një ndërmarrje e vetme. Për këtë arsye, gjysma e importit amerikan mund të merret si transaksion ndërmjet ekspoziturave të kompanive multinacionale (Haaland & Wooton, 1999).

Natyrisht, kompanitë multinacionale mund të jenë në pronësi vendore apo të huaj. Kompanitë

multinacionale në pronësi të huaj luajnë rol të rëndësishëm në shumicën e ekonomive dhe kanë rëndësi gjithnjë e më të madhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Saggi, 2002) Mirëpo, çështja me rëndësi ka të bëjë me efektin që kanë kompanitë multinacionale. Me kuptimin e kufizuar se pse ekzistojnë kompanitë multinacionale, në këtë pyetje është vështirë të japim përgjigje. Mirëpo, teoria ekzistuese ofron disa përgjigje fillestare. Vëreni fillimisht, se pjesa më e madhe e aktiviteteve të kompanive multinacionale mund të zhvillohet pa ekzistimin e domosdoshëm të këtyre ndërmarrjeve, ndonëse jo aq thjeshtë.

Dy shembuj të këtij pohimi e përfshijnë ndryshimin e prodhimtarisë me intensitet të punës nga shtetet industriale, në shtetet që kanë bollëk të punës si dhe rrjedhat e kapitalit nga shtetet me bollëk të kapitalit, në shtete ku kapitali mungon (Olofsdotter, 1998). Kompanitë multinacionale u kontribuojnë herë-herë këtyre ndryshimeve, për ç'gjë ose i lavdërojmë ose i fajësojmë ato për shkak të aktiviteteve të tyre (varësisht nga këndvështrimi i komentuesit). Mirëpo, këto ndryshime nuk e reflektojnë aspektin e “lokacionit” të teorisë sonë të firmave multinacionale që nuk dallon dukshëm nga teoria e thjeshtë e tregtisë. Sikur të mos ekzistonin firmat multinacionale, do të vinte deri te ndryshimet e njëjta, por ndoshta jo deri te një efekt i njëjtë kuantitativ. Për këtë fakt ekonomistët ndërkombëtarë i kanë dhënë rëndësi më të vogël rolit të firmave multinacionale

Arsyet e investimit të kapitalit të huaj në Kosovë

Kosova tani më është bërë pjesë e pandashme, e rëndësishme e iniciativave të bashkëpunimit regional përmes të cilave është arritur që të krijohet një treg i përbashkët regional, në kuptimin e eliminimit të tarifave doganore, eliminimin e barrierave tregtare, si dhe hapjen e perspektivave të reja të zhvillimit. Institucionet e Kosovës vazhdojnë të punojnë me hapa të shpejtë në përmbushjen e standardeve të nevojshme për anëtarësimin e saj në bashkimin evropian. Është krijuar një sistem stabil dhe i qëndrueshëm makroekonomik, sistem i akceptueshëm financiar, janë bërë reforma në politikën financiare, në aplikimin e normave të ulëta tatimore dhe lehtësirave të tjera për investimet e huaja.

Nëse bëjmë një krahasim në mes të ligjeve për investime strategjike në Shqipëri dhe Kosovë, atëherë duhet të fokusohemi drejt sektorëve të synuar për investime, kriteret për investime dhe procedura të parapara.

Nëse fokusohemi në pjesën e sektorëve në ligjin për investime strategjike të Kosovës, ka një

numër sektorësh të piketuar, mirëpo ende nuk është e qartë se në cilët sektorë synohet të investohet. Fokusi kryesor është në sektorët e energjisë, turizmit dhe agrikulturës, fusha këto që janë cilësuar me rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik.

Ligji i Shqipërisë piketon fusha të veçanta, si: transporti, energjetika, minierat, bujqësia, turizmi, teknologjia, mirëpo në bazë të ligjit për IHD-të mund të investohet edhe në sektorë që kanë përparësi zhvillimi (Kuvendi i Shqipërisë, 2015). Përveç sektorëve të definuar, Ligji i Kosovës (Ligji nr.05/L-079) emëron disa kriteret që kanë të bëjnë me shumën minimale të investimit dhe vendet e punës që duhet të hapen. Përveç që kërkon prej investitorëve të përmbushin kriteret ambientale të BE-së dhe të mos shkelin traktatet ndërkombëtare, kërkohet edhe garanci prej investitorëve për përmbushje deri në 60% të investimit.

Ligji i Shqipërisë parasheh dy lloje të projekteve që konsiderohen si investime strategjike: investim strategjik - procedurë e asistuar dhe investim strategjik - procedurë e veçantë. Marrja e statusit të procedurës së veçantë do të thotë që mund të krijohen rregulla të veçanta që të përshpejtohet investimi.

Natyrisht, ndikimi i projekteve që marrin statusin e procedurës së veçantë në vend është më i madh se ai i atyre me procedurë të asistuar dhe në rast se investimi bëhet në partneritet me shtetin shqiptar, ky ligj parasheh që investuesi privat duhet të vërtetojë se ka mjete financiare për të garantuar minimalisht 10% të shumës. Kosova njihet si vend për procedura burokratike sa i përket aspektit të të bërit biznes e në këtë rast edhe sa i përket aspektit të IHD-ve dhe qëllimi kryesor i ligjeve për investime strategjike është lehtësimi i procedurave administrative për investitorët potencial. Ligji i Kosovës kërkon që investitori të ketë planin e biznesit dhe atë financiar, mirëpo, ligji i Kosovës nuk kërkon një studim të fizibilitetit për projektet e propozuara.

Objektiv tjetër i zhvillimit është konkurrenca e drejtë dhe konkurrentshmëria edhe brenda vetë tregut relevant, po edhe më gjerë në tregjet e rajonit. Në kuptimin e trajtimit të përgjithshëm me ligj, Republika e Kosovës do t'iu jep investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre trajtim të njëjtë dhe të barabartë me ndonjë investitor vendor dhe investimeve vendore. Po ashtu, u siguron investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre mbrojtje dhe siguri të plotë dhe të vazhdueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2017). Në asnjë rast, trajtimi, mbrojtja ose siguria që kërkohet nga ky paragraf nuk

do të jetë më pak i favorshëm sesa që kërkohet nga normat e përgjithshme të pranuar të së drejtës ndërkombëtare apo ndonjë dispozite të këtij ligji.

Në Kosovë dhe Kroaci këto prona dhe toka u ofrohen investuesve me çmim të vendosur nga një ekspert, pa tender ose prokurim publik. Po ashtu, pronat ose ndërmarrjet shoqërore nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe ato të Agjencisë Pyjore të Kosovës mund t'u jepen për shfrytëzim investitorëve në rast se Kuvendi i Kosovës, me një shumicë të thjeshtë, e miraton këtë. Ndërsa në Kroaci dhe Shqipëri, një vendim të tillë e marrin trupat qeveritar përgjegjës për menaxhim të asaj prone ose këshilli i ministrave.

Infrastruktura, po ashtu, paraqet një pikë progresi të Kosovës, dhe tani më ajo është mirë e lidhur dhe e rrjetëzuar me regjionin, e në këtë rast vlen të përmendet autostrada me Shqipërinë, lidhja edhe me korridorin drejt Serbisë, tani në përfundim e sipër me Maqedoninë, si dhe rrjeti tjetër infrastrukturor brenda vendit. Po ashtu, mbetet në zhvillim e ndërtim vija hekurudhore me Shqipërinë si një domosdoshmëri për lëvizjen e lirë e të lehtë të mallrave në vend, si dhe në vendet e tjera fqinje.

Përpos vështirësive që janë të ditura për investitorët, si korrupsioni, gjyqësori, prokuroria, energjia jo e qëndrueshme e disa probleme që janë në vazhden e zgjedhjeve, Kosova megjithatë paraqet një vend mjaft atraktiv me mundësi investimi për secilin investitor nga sektorë të ndryshëm, si në privatizim ku tash pritet privatizimi dhe dhënia me koncesion edhe e ndërmarrjeve të mëdha publike, siç është Posta dhe Telekom i Kosovës, si dhe investime të tjera në fusha të ndryshme.

Qasja sistemore e investimeve në Kosovë

Investimet paraqesin një hap të ndërlikuar në fushën e afarizmit, andaj edhe si të tilla kërkojnë një qasje sistemore, sepse ato në vete bartin një përgjegjësi të përcjellë me pasiguri dhe rreziqe. Investimet gjithnjë e më shumë po paraqesin edhe ardhmërinë e ndërmarrjeve apo edhe mund të thuhet edhe ardhmërinë e një ekonomie të vendit. Nga ky aspekt vendi duhet ta trajtojë me kujdes të veçantë tërë politikën investuese, si dhe zbrërthimin e çdo vendimi që ka të bëjë me saktësinë dhe seriozitetin e informatave, pra ato të jenë të vërteta, solide, të bazuara në mendime dhe ekspertiza shkencore. Meqë në praktiken afariste ardhmëria asnjëherë nuk mund të thuhet se është e sigurtë ose se është njëqind për qind e

sigurtë, atëherë ekziston mundësia e të bërit gabim dhe gjasa e gabimit të bërë shpeshherë edhe e determinon suksesin e investimit.

Kjo ndodh në botën e biznesit, ndodh edhe me dijen dhe pa dijen tonë. Në rastin e parë mund të mos kemi qenë të sinqertë apo mashtrues dhe në rastin e dytë kur mosnjohja apo mosllogaritja e saktë në lidhje me lëvizjet në treg kanë qenë të gabuara (Blomstrom & Kokko, 2003). E dyta është e pranueshme në kufinj të e parashikimit dhe nuk duhet që të shërbejë në keqësimin e situatave dhe zhvillimeve të mëtutjeshme. Këtu dhe në këto situata në thelb kemi të bëjmë me përcaktimin e një relacioni në mes të rrezikut dhe fitimit të një investimi (Mustafa M. , p. 17)

Qasja sistemore e menaxhimit pse jo edhe shkencore e këtij problemi është e domosdoshme. E gjithë kjo kërkon njohjen e ligjeve dhe parimeve themelore të metodave dhe teknikave bashkëkohore në zbatimin e tyre të qeverisjes, në mënyrë sistemore të gjitha projektet investive. Raportet e përpunuara mirë të çdo projekti duhet të përmbajnë edhe informatat mbi realizimin e investimeve, pastaj të gjitha kërkesat për ndryshimet e nevojshme nën ndikimin edhe të faktorëve të brendshëm, po edhe të jashtëm.

Pozita qendrore gjeografike e Kosovës

Pozita gjeografike e Kosovës, krijon mundësi që banorët e saj të kenë qasje dhe të jenë të sensibilizuar. Është mundësi për të prekur të arriturat e kohës dhe mundësi që të avancohen drejt shijeve të luksit, që kërkojnë të hyra më të larta. Mund të mendohet se firmat do të investojnë drejt vendeve me attribute të tilla, sepse edhe veprimtaria e tyre do të jetë më fitimprurëse. Faktorë me rëndësi përmes së cilëve mund të thithen investimet e huaja janë faktorët infrastrukturorë. Ndërtimi i autostradës që lidh Kosovën me Shqipërinë në një anë dhe me Serbinë, në anën tjetër tregon që Kosova është një port i rëndësishëm në korridorin që lidh Detin Adriatik me Evropën Perëndimore. Sa i përket energjisë elektrike, momentalisht furnizimi me energji elektrike nuk është stabil. Mirëpo planet për rritjen e kapaciteteve elektrike dhe lënda e parë e mjaftueshme janë një determinues që investitorët e jashtëm t'i drejtohen tregut tonë, si dhe një siguri se aktiviteti i tyre prodhues do të ketë funksionalitet.

Aspektet Legjislative si parakusht për tërheqjen e IHD-ve në Kosovë

Investimet e jashtme bëjnë pjesë në kompleksin e transaksioneve juridiko-biznesore të një

shteti me një shtet tjetër apo me shtete të tjera dhe mund të realizohet në forma të ndryshme. Kryesisht kemi format e tregtimit të mallrave, transferimi i teknologjisë, prodhimi i mallrave apo produkteve, në përgjithësi bërja e shërbimeve tekniko-teknologjike dhe çfarëdo pune tjetër e trajtës juridiko-biznesore.

Investimet jashtë vendit implikojnë krijimin e bizneseve të reja, të cilat në vete bartin edhe transferime të kapitalit. Në këto raste etniteti biznesor i një shteti që investon jashtë shtetit të vet, në shtetin që investon, ndër të tjera bëhet pronar apo bashkëpronar i investimeve të jashtme dhe atë varësisht nga forma e biznesit a është ai biznes individual apo biznes aksionar. Rolin më të madh të transaksioneve biznesore në kuptimin e investimeve e bëjnë kompanitë e mëdha multinacionale, të cilat kanë nivel të transaksionit profesional dhe afirmativ për një vend dhe ekonominë e atij vendi.

Në vendet me influencë të madhe ekonomike janë krijuar Unione që lehtësojnë proceset e investimeve nëpër botë, kështu është i njohur Unioni Evropian apo Amerikano-Verior për tregtinë e lirë, pastaj Round-i i GATT-it (General Agreement on Tariffs and Trade Process) të vitit 1993, UNCTAD-i (U.N.Conference on Trade and Development) (MIGA-Fias, 2005)

Është interesante se edhe te investimet ekziston shpeshherë një masë restriktive e cila nganjëherë shkon deri te proteksionizmi për investime e që lidhet me favorizimin e investitorëve vendor me kapital privat në një anë dhe dekurajimit të investitorëve të tjerë që janë me kapital nga jashtë.

Proteksionizmi i tillë aplikohet shpeshherë edhe për shkaqe të ndryshme politike, por edhe për shkaqe të tjera të interesave më madhore. Në rast të mosmarrëveshjes së partnerëve investiv në çështje juridiko-biznesore, praktikohet Paneli për konteste, (Deputes panel) i kompozuar nga lista e secilit shtet në atë relacion.

Gjithsesi procedimit të panelit i paraprin aktiviteti për konsultime dhe negocime, si dhe ai i arbitrimit.

Arbitrimi duhet të aplikohet konform rregullave të UNICITRAL-it, për arbitrazh (The UNICITRAL Arbitration rules) (Smaka, E drejta biznesore, 2007, p. 260). Nëse këto aktivitete të arbitrimit për shkaqe të ndryshme dështojnë në kuptimin e zgjedhjes së problemit, atëherë problemi i procedohet tematikës kontestuese. Trade related Aspectsof Investment Measure,

është një dokument që në masë të madhe ka thjeshtësuar dhe unifikuar rregullat dhe normat juridiko-ndërkombëtare që u referohen investimeve të jashtme dhe referojnë tendencë për kalimin e restriksioneve dhe masave të ndryshme të tregjeve relevante të vendeve që qëllim primar kanë integrimin e ekonomisë në masa të përgjithshme. Ato norma apo rregulla përgjithësisht njihen si “TRIM”, shkurtimisht rregulla të cilat kanë të bëjnë me dispozitat respektive të GATT dhe WTO (Damijan & Knell, 2005). Konform këtyre rregullave, investitorët favorizohen edhe në: investimet e bëra nëpërmjet tregtisë (coundertrade); industrisë kufitare dhe zonave ekonomike; ekonomisë së lirshme, dhe lizingut financiar.

Nga aspekti juridik biznesor, te investimet e jashtme, rëndësi të dorës së parë paraqet zgjedhja e kontesteve, përkatësisht procedura kontestuese. Zakonisht këto konteste dinë të bëhen edhe më të komplikuar në raste kur kemi të bëjmë me shtete federative, që nga brenda kanë sistem ligjor herë-herë dual dhe se aty mosmarrëveshjet janë shpeshherë edhe të vështira për tu zgjidhur. Zakonisht këtu duhet të vlejë klauzola se legjislacioni qendror, federal apo kombëtar duhet të jetë gjithnjë mbi legjislacionin lokal.

Dualizmat dhe heterogjenizmat e rregullave apo ligjeve tejkalohe më lehtë kur legjislacioni lokal, konform me klauzolën kushtetutare respektive ka funksion suplementar apo plotësues të vakumeve të mundshme në sistemin ligjor (Riza, 2007)

Një definim tjetër i mundshëm për investimin është se ai paraqet angazhimin e kapitalit, parasë në ndërtimin e objekteve dhe zgjerimin e prodhimit. Shembuj të tillë kemi tek: kapacitetet industriale, xeheroret, objektet hidroenergjetike, rrugët me rëndësi ndërkombëtare, ndërtesat bankare si dhe objekte të tjera me fitime të pritura. Përgjatë këtyre viteve Qeveria e Kosovës ka përfunduar projekte të mëdha kapitale, duke përfshirë këtu ndërtimin e autostradës që lidh Kosovën me Shqipërinë, si dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës që është padyshim ndër më të mirët në rajon.

Tani që kanë kaluar 16 vite pas intervenimit të NATO-s, Kosova ka arritur të funksionalizojë një ekonomi të tregut të lirë dhe të bëhet partner serioz për rajonin dhe më gjerë. Gjatë kësaj rruge ne kemi arritur të ndërtojmë infrastrukturën rrugore me standarde evropiane, kemi përmirësuar ambientin e biznesit duke ulur taksat, duke siguruar një fuqi punëtore të lirë dhe fleksibile, duke eliminuar barrierat e qasjes në treg dhe duke garantuar me ligj trajtimin ndërkombëtar dhe vendor.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian dhe CEFTA, janë ndër arsyt kryesore që ju mundësojnë investitorëve potencial ta shohin Kosovën jo vetëm si një treg prej 2 milionë konsumatorëve, por si një treg prej nga mund të eksportohet pa doganë në një treg prej 32 milionë konsumatorëve në vendet e CEFTA-s dhe afro 600 milionë konsumatorëve në Bashkimin Evropian, duke mos përfshirë masat preferenciale tregtare me SHBA-të, Japoninë dhe Norvegjinë.

Gjithashtu, Kosova ofron një sistem të taksave më efikas, duke pasur parasysh vlerësimin e zyrtarëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, si sistemin më të mirë në botë pas Zelandës së Re, pasi që është shumë i thjeshtë dhe i lehtë për bizneset. Për më tepër, përveç sistemit efikas të taksave, Kosova ofron tatimet më të ulëta në Evropë, duke ju ofruar investitorëve të huaj vetëm 10% në profit të korporatave, vetëm 5% kontribut të detyruar të pensioneve dhe 0% tatim në dividendë.

Janë edhe më shumë benefite të tjera që ofron Kosova, siç është mbrojtja e investitorëve të huaj, ku i garantohet i gjithë investimi i tyre përmes ligjit mbi investimet e huaja (Dimelis & Louri, 2004). Poashtu, edhe stabiliteti makroekonomik me vetëm 6.2% të GDP-së, si borxh publik, dhe shpirti i ndërmarrësisë, që ekziston në Kosovë, janë faktorë të rëndësishëm për investitorët e huaj. Me qëllim që të stimulojmë dhe inkurajojmë investimet e huaja në Kosovë, ne kemi kaluar ligjin mbi zonat ekonomike gjatë vitit të kaluar, i cili parasheh krijimin e dy zonave të lira ekonomike në territorin e Kosovës. Në promovimin e IHD-ve janë të angazhuar disa akterë: Qeveria, Oda Ekonomike e Kosovës, USAID-KBS, Euro Info Qendra, Swisscontact dhe zyrat përfaqësuese të shteteve të huaja.

Por, aktualisht mungon koordinimi ndërmjet akterëve të ndryshëm, ashtu si mungon organizimi për koordinim dhe strategjia e promovimit. Është e nevojshme të adresohet kjo situatë në të ardhmen e afërt krahas promovimit të përparësive që i ka Kosova, dhe krijimin e një imazhi të mirë për të. Duhet të ndërmerret një fushatë institucionale për t'i theksuar përparësitë e Kosovës në krahasim me destinacionet alternative në Ballkan dhe Evropën Qendrore. Akterët e politikave duhet të luajnë rol më aktiv në krijimin e një ambienti miqësor për IHD-të në Kosovë, duke krijuar praktika të mira dhe koordinuar përpjekjet për adresimin e këtyre çështjeve (Hejazi & Pauly, 2003). Praktikrat dhe përvojat ndërkombëtare duhet të shërbejnë si bazë për krijimin e një rrethine investive më miqësore për ta bërë këtë me sukses,

ndërkaq qeveria dhe UNMIK-u duhet të përqëndrohen në aktivitetet, si vijojnë:

- Përmirësimin sistematik të stabilitetit politik dhe gjendjen e sigurisë, rritjen e vetëdijesimit të komunitetit të biznesit dhe opinionit publik se sa i rëndësishëm është roli i sektorit privat në promovimin e progresit ekonomik dhe krijimin e ekonomisë së tregut;
- Mbrojtjen e konkurrencës lojale duke reduktuar evazionin fiskal dhe intensifikimin e vazhdimësisë së masave sistematike kundër korrupsionit;
- Lehtësitë për eksport përmes krijimit të identitetit tregtar të Kosovës dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me vendet fqinje dhe vendet e tjera për t'i eliminuar pengesat administrative, si p.sh. njohja e certifikatës së origjinës kosovare dhe respektimi i parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet tregtare;
- Ndërmarrjen e të gjitha masave për t'i përmbushur standardet dhe kriteret që kërkohen nga Marrëveshja për Investime në kuadër të Paktit të Stabilitetit me qëllim që të ndërtohet një kornizë stabile, transparente dhe e njësuar për investime në sektorin privat;
- Promovimin e programit të privatizimit të investitorët potencial, zhvillimin dhe publikimin e referencave udhëzuese mbi procedurat e politikës operative dhe ndërtimin e praktikave transparente që lidhen me implementimin e Rregullores mbi AKM-në, e cila do t'i inkurajonte investitorët e vendit dhe të huaj;

Investimet e huaja ndërkombëtare në Kosovë

Studimet ndërkombëtare të ndryshme, tregojnë që investimet e huaja direkte ndikojnë pozitivisht në rritjen e rolit dhe forcimin e shtetit ku realizohen këto investime, sidomos në vendet në zhvillim. Në këtë kuptim, këto lloj investimesh vlerësohen si faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe efektet e tyre janë mjaft pozitive për të gjithë akterët e interesuar. Ato shoqërohen me kulturën e biznesit, profesionalizmin, inovacionin e shërbimeve, por edhe me instalimin e teknologjisë së përparuar.

Pa folur pastaj për kontributin tjetër, i cili ka të bëjë me rritjen e punësimit, shtimin e produktivitetit, zhvillimin e konkurrencës së ndershme që pas vete sjell edhe eliminimin e monopoleve në treg. Këto lloj investimesh sjellin këtu, gjithashtu, përmirësim të aktiviteteve

tregtare dhe prodhuese, si rrjedhojë, jo vetëm të veprimtarive të shoqërive të huaja, por edhe të asaj që quhet Know-how, njohuritë dhe përvoja e një natyre teknike, tregtare, administrative, financiare etj, që aplikohet në aktivitetin e një kompanie apo në ushtrimin e një profesioni.

Në vitin 2007, sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës, investimet e huaja në Kosovë kishin arritur vlerën e 440 milionë eurove, derisa në shtator të vitit 2013, këto të hyra mbërritën shumë e miliona eurove, që është më pak se gjysma e shifrës së vitit 2007.

Pengesat për investime në Kosovë

Përfaqësuesit e ambasadave të shteteve që kanë investuar më shumë në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë, tregojnë se çfarë i mban larg Kosovës afaristët e vendeve të tyre. Bizneset amerikane janë të kujdesshme për shkak të asaj që perceptohet si nivel i lartë i korrupsionit dhe implementim i dobët i sundimit të ligjit, që paraqet sfidë për investim të mëtutjeshëm të huaj në Kosovë. Ndërkohë, sipas bizneseve të Gjermanisë në Kosovë, biznesmenët gjermanë janë të pakënaqur “me përpjekjet që Qeveria e Kosovës ka bërë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Po ashtu kanë vërejtje për prokurimin publik dhe për tenderët zyrtarë (Helpman, 2006).

Një anketë, që ka përfshirë mbi 1600 biznese gjermane, e publikuar vitin e kaluar, e rendit Kosovën në vendin e 18 nga 20 shtete pjesëmarrëse, sa i përket atraktivitetit për të investuar. Nga anketa ku janë pyetur anëtarët e Dhomave Gjermane të Tregtisë në Evropën Qendrore dhe Lindore, del se dobësitë kryesore të Kosovës janë problemet strukturore burokratike, mungesa e politikave dhe strategjive ekonomike, si dhe mungesa e sundimit të ligjit. Po ashtu, bizneset e pyetura kanë rekomanduar që Kosova të përmirësojë sistemin arsimor. Kur punëson njerëz nga këtu, ata nuk kanë përvojë në standardet e pritshme.

Disa investitorë gjermanë është dashur të dërgojnë të punësuarit e tyre në Gjermani për t'i trajnuar, trajnim ky që ka zgjatur disa javë, ose edhe muaj. Viti 2008 e më pas, e ka përfshirë gjithë ekonominë globale në një krizë dhe investimet e huaja duhet të shihen në një kontekst më të gjerë, e jo të shikohen vetëm nga masat që kemi ndërmarrë ne. Gjithë sistemi gjyqësor ka mbetur sfidë për ekonominë e Kosovës.

Politikat monetare dhe roli i tyre në tërheqjen e IHD-ve

Politika monetare është proces me të cilin Qeveria, Banka Qendrore ose autoriteti monetar i vendit kontrollon furnizimin me para, disponueshmërinë e të hollave dhe koston e parasë apo normat e interesit për të arritur objektivat e orientuara drejt rritjes dhe stabilitetit të ekonomisë. Teoria monetare, ofron pasqyrë të instrumenteve të politikës monetare optimale.

Politika monetare mbështetet në marrëdhëniet midis normave të interesit në një ekonomi, që është çmimi me të cilin paratë mund të huazohen dhe furnizimi i përgjithshëm i parave. Politika monetare përdor një shumëllojshmëri të instrumenteve për të kontrolluar njërin ose të dyja këto, për të ndikuar në rezultatet si: rritjen ekonomike, inflacionin, normat e këmbimit me monedhat e tjera dhe papunësia.

Një ekonomi kombëtare konsiderohet e qëndrueshme në përgjithësi, nëse është e aftë të shfrytëzojë burimet dhe kapacitetet e saja njerëzore, financiare dhe kapitale, për rritje të vazhdueshme ekonomike dhe për sigurimin e mirëqenies së gjithë banorëve të saj.

Rëndësia e resurseve (njerëzore, financiare dhe natyrore) është e pakontestueshme, mirëpo vetëm shfrytëzimi efektiv i tyre siguron një rritje të vazhdueshme ekonomike dhe mirëqenie shoqërore. Rritja është esenciale për arritjen e stabilitetit socio-ekonomik dhe zhvillimin politik të një vendi.

Rritja substanciale afatgjate do të siguronte ekonomi të qëndrueshme. Rritja ekonomike paraqet rritjen e produktit real të brendshëm bruto të një vendi dhe ndryshimin në kapacitetet prodhuese të vendit. Rritja nuk shfaqet rastësisht! Ajo, është rezultat i politikave cilësore (produktivitetit, teknologjisë, risive dhe efekteve të jashtme) (RIINVEST, 2005, p. 11).

Ruajtja e stabilitetit financiar është kusht për ruajtjen e stabilitetit ekonomik, social dhe politik. Ky stabilitet arrihet përmes analizave të indikatorëve të rëndësishëm financiar dhe ekonomik duke shfrytëzuar një bazë të gjerë të informacioneve të grumbulluara. Identifikimi me kohë i faktorëve që mund të kenë efekte destabilizimi, paraqet sinjal për marrjen e masave preventive nga autoritetet monetare dhe fiskale në mënyrë që të evitohet rreziku sistemor, duke qenë se si politika monetare ashtu edhe politika fiskale, përbëjnë komponentë të politikës ekonomike shtetërore që shfrytëzohet për qëllime makroekonomike për ta ndikuar

nivelin e produktit, punësimit dhe çmimeve (Buthe & Milner, 2008).

Politika monetare e Kosovës, apo mjedisi financiar nuk janë aspak të favorshme për rritjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla, gjë e cila është parakusht që këto ndërmarrje të zhvillohen dhe të kalojnë në ndërmarrje të mesme. Pronarët dhe menaxherët e ndërmarrjeve perceptojnë se barrierat kryesore për biznesin e tyre janë: konkurrenca jolojale, legjislacioni, korrupsioni, tatimet dhe qasja në burimet e financimit.

Kjo është tipike për rrethina turbulente afariste, gjë që rezulton nga mungesa e kapaciteteve, por edhe angazhimi që kërkohet për zbatimin e ligjeve gjithashtu është pengesë direkte në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla.

Mjedisi financiar i pa favorshëm ka bërë që shumica e pronarëve të bizneseve, sidomos pas krizës së vitit 2008, t'i tërheqin investimet e veta nga Kosova dhe të kërkojnë ambient më të përshtatshëm dhe klimë më të përshtatshme të të bërit biznes në vendet e tjera të rajonit.

Rritja e kapaciteteve dhe përgjegjshmërisë për zbatimin e ligjit duket se paraqet një faktor kritik për përparimet e mëtutjeshme në ndërtimin e rrethinave afariste të favorshme për rritjen ekonomike. Në përgjithësi, politikat dhe mjedisi institucional duket se janë të papërshtatshme për eliminimin e deformimeve në treg dhe për përkrahjen e qëndrueshmërisë makroekonomike. Mirëpo, në të njëjtën kohë, është e nevojshme që të analizohet më thellë dhe më konkretisht se sa këto politika janë të papërshtatshme për një ekonomi në zhvillim e sipër, e në veçanti për aktivitetet e reja prodhuese dhe eksportuese, si dhe për krijimin e vendeve të punës nëpërmjet gjenerimit të rritjes ekonomike (RIINVEST, 2005)

Rritja e IHD-ve, drejt sektorëve produktivë, do t'i ndihmonte ekonomisë së Kosovës për të mbuluar mungesat e financimit dhe për të siguruar transferimin e teknologjisë dhe aftësive. Kjo nga ana tjetër do të ndihmonte në procesin e rivitalizimit të sektorit industrial të Kosovës dhe zvogëlimin e deficitit tregtar. Rritja e investimeve të diasporës do ta kthejë atë në motor të rritjes së orientuar kah eksportet, rritjes së aftësive të fuqisë punëtore dhe lidhjes me zinxhirët globalë të vlerave. Një qasje e fokusuar mund ta shndërrojë rolin e diasporës nga ajo e një shpëtimtareje financiare që mbështet nevojat themelore të konsumit, në një shtyllë të zhvillimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm. (STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM 2016-2021 (SKZH), 2016).

Në bazë të raportit të Qeverisë së Kosovës mbi planin për zhvillim të qëndrueshëm në mes të tjerave theksohet se SKZH, do të stimulojë rritjen e investimeve të huaja direkte duke forcuar kapacitetet e KIESA-s, duke e ndryshuar kulturën e shërbimit si dhe duke ofruar stimuj për investitorët strategjikë. Në anën tjetër, do të zhvillohet një skemë për stimulimin e investimeve të diasporës, në formën e granteve korrespondente.

Aktivitetet konkrete të masës numërojnë: (STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM 2016-2021 (SKZH), 2016):

□ Fuqizimi i kapaciteteve të KIESA-s dhe riorganizimi. Krijimi i një ekipe me përvojë të gjerë në sektorin privat për zhvillim të produkteve, paketim, para-kualifikim, prezantim, shitje, kujdes pas shitjes, dhe menaxhim të klientëve.

Hartimi i strategjisë së re për IHD-të, e cila ofron pako të diferencuara të stimulimit. KIESA gjithashtu do të vendosë përfaqësues tregtarë në ambasadat e Kosovës dhe do të krijojë skema të bonuseve të orientuara drejt shërbimeve që tërheqin investitorët e huaj;

- Mbështetja e investimeve të investitorëve strategjik përmes stimujve dhe negociimit të drejtpërdrejtë, të ofruar përmes Ligjit për Investime Strategjike;
- Krijimi i skemave të granteve korrespondente për diasporën. Përmes kësaj skeme pjesëtarët e diasporës që bëjnë investime kapitale në një biznes të ri apo ekzistues (me plan të mirëfilltë biznesi) do t'u mbulohet pjesa tjetër e investimit përmes grantit. Skema do të fillojë me pilot projekt në sektorin e bujqësisë dhe të shërbimeve në fushën e IT-së;
- Aktivizimi dhe zgjerimi i rrjeteve të bizneseve të diasporës në funksion të rritjes së investimeve nga diaspora në Kosovë;
- Bashkëpunimi në mes të rrjeteve të bizneseve të diasporës si dhe institucioneve të vendit (MTI, MeD, KIESA, Odat Ekonomike) në funksion të plasimit të produkteve të Kosovës në tregun evropian dhe atë botëror dhe duke u bazuar fillimisht në diasporën tonë si konsumatorin e parë, si mënyrë për të promovuar eksportet e Kosovës.

Roli i Bankës Qendrore mbetet i pazëvendësueshëm brenda strukturës së sistemit financiar, meqë ajo kryen funksione specifike dhe mban përgjegjësi të madhe lidhur me ecuritë e përgjithshme ekonomike dhe financiare në vend. Ajo menaxhon masën monetare përmes

instrumenteve të politikës monetare dhe vëzhgimit të rregullt të agregatëve monetarë, kujdeset për kreditimin e bankave komerciale, përcaktimin dhe mbajtjen e kursit të këmbimit, emetimin e parasë, shërben si bankë e bankave dhe kryen shërbime për qeverinë.

Në efikasitetin e përdorimit të instrumenteve të politikës monetare - kreditore dhe të politikës së këmbimeve valutore, rëndësi të veçantë ka shkalla e pavarësisë së Bankës Qendrore nga pushteti. Sa më e pavarur të jetë ajo në kryerjen e funksioneve dhe detyrave, aq më vital dhe efikas do të jetë sistemi financiar dhe ekonomia e vendit.

Përgjegjësitë e mëdha lidhur me ecuritë e përgjithshme ekonomike, detyrojnë Bankën Qendrore që të bëjë përpjekje më të mëdha, me qëllim që t'i arrijë objektivat e përcaktuara me politikën monetare të shpallur, dhe në të njëjtën kohë të ruajë qëndrueshmërinë dhe kredibilitetin

Ndërhyrja e qeverisë në rrjedha ekonomike, arsyetohet me masat që ajo ndërmerr në kornizat e politikës fiskale për të mënjanuar dukuritë që pengojnë ruajtjen e mirëqenies së shoqërisë. Preferencat dhe prioritetet në lidhje me objektivat makroekonomike shpesh bëhen faktorë përçarës ndërmjet autoriteteve monetare dhe fiskale. Çështja e deficitit buxhetor dhe mbulimi i tij, përbën problem të veçantë, meqë lidhet drejtpërdrejt me inflacionin si dukuri me efekte negative në ekonomi dhe me nivelin e kursimit të popullsisë i cili është i domosdoshëm për investime në të ardhmen.

Në anën tjetër, politika monetare shtrënguese, megjithëse e orientuar në ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik, prodhon efekte kontradiktore të cilat rëndojnë mbi politikën fiskale e që ndikon direkt në afarizmin e ndërmarrjeve të vogla dhe në anën tjetër shkakton rritje të deficitit buxhetor, derisa efektet anësore eliminohen në kushte të tilla

Rregullat e vëna për variablat e zgjedhura si objektiva, bashkë me rregullat për instrumente që mundësojnë arritjen e tyre, shkalla e grumbullimit dhe cilësia e informacioneve të marra nga tregu, kontrollimi dhe llogaritja e saktë e multiplikatorit dhe parashikimet e drejta, janë faktorë që në masë të madhe kushtëzojnë rezultatet përfundimtare nga procesi i implementimit të politikës monetare dhe fiskale. Mirëpo, dështimi në arritjen e objektivave monetare dhe fiskale në masë më të madhe lidhet me paaftësinë dhe jogatishmërinë e autoriteteve për koordinim, proces i cili nënkupton bashkëpunim institucional duke ndarë

detyrat dhe përgjegjësitë për (jo)rezultate.

Koordinimi i politikës monetare dhe politikës fiskale siguron qëndrueshmëri dhe efikasitet në procesin e implementimit të tyre dhe shpie më lehtë deri te objektivat e caktuara. Një rëndësi të madhe në këtë proces ka fuqia e vetëvendosjes së Bankës Qendrore në fushën monetare dhe niveli i reputacionit të thesarit për kompetencë dhe disiplinë financiare.

Mbajtja e kontakteve të rregullta lidhur me ndarjen e informacioneve, analizën dhe mbikëqyrjen e ecurive ekonomike dhe informimin e rregullt dhe transparent të publikut lidhur me drejtimin e politikave dhe rezultatet e arritura, janë parakushte për arritje të suksesit në procesin e koordinimit konsekuent të politikës monetare dhe fiskale (Banka Qendrore e Kosovës, 2007)

Ekonomitë në tranzicion dhe zonat e vogla të hapura, në të cilat nuk ka kufizime të lëvizjes së monedhës, paraqesin dy karakteristika. Së pari, ciklet e biznesit zakonisht janë shumë të vogla në zonat e thella të vendit dhe janë më të volitshme sesa ato në ekonomitë e vendeve të zhvilluara.

Së dyti, të dy tipet e vendeve kanë një pjesë të madhe të likuiditetit të tyre në valutë të huaj. Politikat e zgjedhura të përziera monetare dhe fiskale në disa raste mund të mos jenë konsistente me preferencat e publikut lidhur me objektivat. Prandaj, një qasje më e drejtë për të siguruar konsistencë ndërmjet këtyre politikave është ndarja e funksionit të preferencave me publikun e gjithmbarshëm. Ky proces, nënkupton konsensus lidhur me preferencat mbi politikat ekonomike duke përfshirë opinionet e liderëve, autoriteteve dhe grupeve të tjera të organizuara institucionalisht. Vetëm në këtë formë do të gjejnë vend interesat e përgjithshme shoqërore për rritjen e mirëqenies së gjithmbarshme.

Qeveria e Kosovës duhet të shqyrtojë mundësinë e nxjerrjes së një monedhe të saj. Madje, besoj se një kalim i përkohshëm në një monedhë vendore do të sillte benificione të shumta për zhvillimin e ndërmarrjeve dhe zhvillimit ekonomik të vendit në përgjithësi, pra është një risk që vlen të ndërmerret, apo që, në këtë fazë të paktën të shqyrtohet dhe studiohet me seriozitet, pavarësisht fatit të euros. Le të themi se Kosova do ta nxirrte një monedhë të vetën (cili do qoftë emërtimi i saj), përfitimi i ndërmarrjeve të vogla dhe i Kosovës në përgjithësi, do të ishte në të paktën tri forma. E para, shtetit kosovar do t'i krijohet arma tepër e vlefshme

e politikës monetare. Mungesa e politikës monetare nga BQK-ja po i kushton ekonomisë kosovare në disa mënyra. BQK, nuk ka mundësi që të kontrollojë sasinë e parave në qarkullim, që do t'i mundësonte asaj që të ndikojë në shkallën e inflacionit, kjo shihet edhe nga shifrat. I gjithë rajoni i ballkanit ashtu si gjithë ekonomia botërore po përjeton një ngritje të shkallës së inflacionit. Mirëpo, dallimet janë tepër evidente.

Kosova ka shkallën më të lartë të inflacionit nga të gjitha vendet e rajonit dhe kjo ka bërë që NVM-të të stagnojnë në zhvillimin e tyre. Kjo shpjegohet pjesërisht nga fakti se Kosova ka varshmëri më të lartë ndaj importeve. Mirëpo një shpjegim tjetër është se shtetit të Kosovës i mungon instrumenti i politikës monetare për të zbutur efektet e inflacionit, duke shtuar likuiditetin e ekonomisë (me rritjen e sasisë së parave). Një situatë e ngjashme është në Mal të Zi, i cili gjithashtu përdor euron, ku presioni i inflacionit tejkalon mesataren e vendeve të tjera të ballkanit. Në Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi, p.sh, shkalla e inflacionit megjithatë është mbajtur nën kontroll.

Politika monetare do t'i jepte mundësi BQK-së që gjithashtu të ndikojë në normat e interesit bankar që është jetik për zhvillimin e NVM-ve, pasi që marrja e kredive shpesh është më e madhe sesa fitimi real i NVM-ve, dhe kjo e rëndon edhe më tepër zhvillimin dhe ndryshimin e profilit të këtyre ndërmarrjeve. Përveç se kemi inflacionin më të lartë në rajon, bankat kosovare kanë gjithashtu disa nga kamatat më të larta në rajon dhe në Evropë. Kjo është pengesë e jashtëzakonshme për nxitjen e investimeve dhe për zhvillimin ekonomik. Në kohën kur ekonomitë evropiane, amerikane por edhe ajo kineze, po stimulohen me uljen e normave të interesit, kreditë e shtrenjta në Kosovë e vështirësojnë praninë e likuiditetit që do të nxiste investimet private në biznese, në patundshmëri dhe në konsum. Duke marrë kontrollin e politikës monetare, BQK do të mund të kishte ndikim më të fuqishëm në uljen e normave të interesit dhe stimulimin e investimeve (Banka Qendrore e Kosovës, 2007)

Përveç, mundësisë që politika monetare të vihet në funksion të zhvillimit ekonomik, kalimi nga euroja në një monedhë vendore ka një beneficion të dytë. Kjo do të ishte mundësia që, përmes konvertimit të euros në monedhën e re, Kosova do të krijojë një bazë të mirë të rezervave devizore, që do të ishin kryesisht në euro.

Aktualisht në Kosovë qarkullojnë rreth katër miliardë euro në vit. Nëse vetëm 20 përqind e kësaj shume do të konvertohej në monedhën e re vendore, ndërkohë që do të mund të

konvertoheshin më shumë, Kosova do të mund të gjeneronte rreth 800 milionë euro në rezervat e veta.

Të hyrat nga remitancat, që janë kryesisht në euro, përmes konvertimit gjithashtu do të kontribuonin në ndërtimin e rezervave devizore. Këto rezerva gradualisht mund të konvertohen në ari dhe në instrumente të tjera financiare, duke forcuar gradualisht bazën dhe besueshmërinë e monedhës së re dhe në forcimin e dukshëm të kapaciteteve financiare të shtetit kosovar.

Monedha kosovare do të ishte relativisht e devaluuar. Kjo nuk është diçka medoemos e keqe, në fakt për një ekonomi të varfër, është pozitive. Në qoftë se këmbimet në vend do të bëheshin me valutën e lirë kosovare (cilido qoftë emërtimi i saj) në vend të valutës së shtrenjtë euro, kjo do të nënkuptonte zbritjen e çmimeve të shumë elementeve bazë të konsumit dhe kjo do t'i ndihmonte NVM- të, që të zhvillohen.

Pra, do të rritej qarkullimi total i tyre, gjë që do të largoheshin edhe nga kanalet informale të të bërit biznes. Efekti, gjithashtu do të ishte në lehtësimin e presioneve të inflacionit në paga. Niveli i pagave të shpërblyera me valutën kosovare, me vlerë të ulët si monedhë por me fuqi më të lartë blerëse brenda Kosovës se sa euroja, do të kishte efekt në rritjen e standardit të jetesës. Kjo është një nga arsyet pse shtetet fqinje si Shqipëria, Maqedonia dhe Serbia me monedhat e tyre të lira kanë kosto më të lirë të jetesës (dhe rrjedhimisht edhe shkallë më të vogël të varfërisë) sesa Kosova që përdor euron. Aq më tepër që një valutë e devaluuar shkon drejtpërsëdrejti në funksion të stimulimit të eksporteve (Banka Qendrore e Kosovës, 2007)

Mësimi për vlerën e devalvimit vjen nga shembulli i Argjentinës. Për shumë vite, vlera e konvertueshme e pesos argjentinase ishte e fiksuar me dollarin. Në vitin 2001, Argjentina pësoi një krizë financiare që ia bëri të papërballueshëm nivelin e borxheve të jashtme, pikërisht për shkak të lidhjes së pesos me dollarin, duke shkaktuar një krizë të thellë ekonomike në vend. Zgjidhja ishte shkëputja e vlerës së pesos nga dollari, që u vendos nga Qeveria e Argjentinës më 2002. Me devalvimin e pesos, jo vetëm që u zbuten efektet e krizës, por edhe u krijuan kushtet për një rimëkëmbje të fuqishme.

Argjentina sot është një nga shtetet me rritjen ekonomike më të madhe në Amerikën latine, diçka që nuk do të arrihej sikur Argjentina të përpiqej me çdo kusht që ta ruante paritetin e

pesos me dollarin.

Me fjalë të tjera, beneficionet e nxjerrjes së një monedhe vendore janë të shumta. Në anën tjetër, janë edhe rreziqet. Një nga problemet e një ekonomie që varet nga importi si Kosova, është se pagesat do të vazhdojnë të kryhen në euro. Bizneset e jashtme nuk do të pranojnë pagesa në monedhën kosovare, duke detyruar bizneset kosovare që importet të vazhdojnë t'i blejnë me euro. Kjo do të thoshte se Kosova do të vazhdonte të ishte vend i dy valutave paralele: monedhës kosovare dhe euros.

Mirëpo, shtrenjtimi relativ i euros karshi monedhës kosovare do të ndikonte gjithashtu që kosovarët të jenë më të matur rreth urisë së tyre të pangopur për importe, duke stimuluar uljen e importeve dhe kujdesit të shtuar ndaj përkrahjes dhe zhvillimit të ndërmarrjeve kosovare, gjegjësisht ndaj industrive vendore.

Rrezikut të monedhës së re do tii kontribuonte gjithashtu edhe fakti se shumë kosovarë mund të mos kenë besim, sidomos në fillim, në vlerën dhe qëndrueshmërinë e monedhës së re. Për këtë arsye, shumë kosovarë mund të hezitojnë ta përdornin valutën e re, duke preferuar që kursimet t'i mbajnë në euro apo që pagesat e caktuara t'i bëjnë vetëm në euro (si në periudhën e viteve 1990 në Shqipëri, kur pagesat preferoheshin në dollarë në vend të lekut).

Për këtë arsye, tranzicioni në monedhën e re do të duhej të ishte gradual dhe i mirë organizuar. P.sh, monedha e re mund të fillonte me një vlerë të fiksuar kundrejt euros, për një periudhë të caktuar p.sh 2 për 1. Mirëpo duhet mbajtur në mend se kryesi më i madh i pagesave në Kosovë është shteti i Kosovës. Në momentin që shteti i Kosovës do t'i kthente pagat në monedhën kosovare, efekti i monedhës së re do të ishte i menjëhershëm, sepse ato para do të derdheshin përnjëherë në konsum dhe në qarkullim të gjerë.

Kosova ka potencial të konsiderueshëm për të ecur drejt rritjes së shpejtë dhe të qëndrueshme të drejtuar nga sektori privat dhe krijimit të vendeve të punës nëse mund të trajtojë pengesat ekzistuese ndaj investimeve. Siç është theksuar në Memorandumin Ekonomik të Shtetit (MESH) të Bankës për 2010, vendi gëzon disa përparësi relative që janë të rëndësishme për krijimin e një sektori të lulëzuar të eksportit, si dhe për tërheqjen e investimeve vendore dhe të huaja në sektorët e tregtueshëm.

Në fakt, Kosova është e pasur me pasuri të ndryshme kryesore, pra, burime të bollshme

natyrore, një fuqi punëtore të re dhe në rritje (megjithëse të pashfrytëzuar), tokë bujqësore të cilësisë së mirë, si dhe qasje praktikisht të lirë për në tregjet rajonale dhe të BE-së. Në disa aspekte, mjedisi i politikave është gjithashtu i favorshëm, duke përfshirë, një sistem tatimor që është i thjeshtë dhe ka norma të ulëta, një treg të punës që është më fleksibil se sa në vendet fqinje dhe paga relativisht të ulëta për punëtorë (gjysmë) të kualifikuar. Megjithatë, ka një numër të pengesave serioze ndaj investimeve të cilat duhet të trajtohen nëse Kosova do të realizojë potencialin e saj si një destinacion tërheqës për investimet vendore dhe të huaja private.

Klima e biznesit në Kosovë në disa fusha është më e mirë se në vendet fqinje (ose edhe në BE10 +1), mirëpo si sfidat kryesore përfshijnë mangësi të rënda infrastrukturore, mangësi në sundimin e ligjit, mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar përshtatshëm, qasje të kufizuar në financa dhe procedurat e vështira rregullatore për hyrje në biznes dhe punë. Sfidat dhe strategjitë e qeverisë në secilën nga këto fusha janë përshkruar më poshtë.

Me qëllim të zhvillimit ekonomik të vendit në një sërë sektorësh në nivelin qendror dhe lokal, Kosova ka shumë donatorë shumëpalësh dhe dypalësh që japin përkrahje dhe ndonjëherë të harmonizuar me operacionet e bankës. BE-ja dhe USAID-i janë donatorët më të rëndësishëm, me mbi 300 projekte në nivel kombëtar dhe lokal. Për vitet 2011-2012, BE-ja ka ndarë 140 milionë € për Kosovën nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA), i cili financon aktivitete përgatitore për projektet e investimeve. Kosova ka gjithashtu të drejtë të marrë fonde nga fondi i investimeve i BE-së, për ballkanin perëndimor (KIBP) për përgatitje të projekteve.

Partnerët e tjerë të rëndësishëm janë: Austria, Republikën Çeke, Danimarka, Gjermania, Italia, Holanda, Norvegjia, Suedia, Zvicra dhe Turqia si dhe institucionet e Bretton Woods dhe sistemin e OKB-së.

KAPITULLI VII

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

7.1 Konkluzione

Ky studim doktorial trajton rëndësinë e legjislacionit të Kosovës mbi Investimet e Huaja Direkte në komapracion me legjislacionin e Bashkimit Europian. Studimi gjithashtu ngërthen në vete dy fushat më të rëndësishme të bashkëveprimit ndërmjet fushës ekonomike dhe asaj juridike, në fokus investimet e huaja direkte. Kosova është një shtet i ri i cili ka përballuar jo vetëm reformat e tranzicionit ekonomik por edhe atë politik, si një shtet i dalur nga lufta. Kosova si një shtet me shumë sfida ka hapëruar me rritëm të shpejtë dhe pozitiv të rritjes ekonomike, reformave në drejtësi, legjislacionin në përgjithësi dhe në veçanti mbi investimet dhe investimet e huaja direkte si edhe zbatimin e gjyqësorit, luftën kundrejt korrupsionit dhe terrorizmit. Shikuar nga prizmi i rëndësisë së investimeve të huaja direkte për zhvillimin ekonomik të një shteti është e pakuptimtë të mos diskutohet ligji, sundimi i ligjit dhe gjyqësori. Në këtë drejtim edhe Kosova si shtet ka realizuar një mori reformash të rrafshit ekonomik dhe në legjislacionin e vendit me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja direkte. Në mes tjerash, Kosova, tashmë është pjesë e shumë organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare që mbështesin Investimet e Huaja Direkte.

Konkluzionet nga ky studim do t'i adresojmë në disa shtylla kryesore përfshirë përmbledhje mbi legjislacionin e IHD-ve, klimën investuese në Kosovë, trendin e IHD-ve ndër vite, remitencat dhe përmbledhje mbi sfidat dhe mundësitë e shtetit të Kosovës drejt tërheqjes së IHD-ve;

1. Legjislacioni i Kosovës mbi IHD-të, për thithjen e Investimeve të Huaja Direkte falë përfitimeve të shumta si në aspekt të transferimit të njohurive ose know-how, teknologjisë, rritjes së konkurrencës dhe në përgjithësi të rritjes ekonomike, është e domosdoshme një kornizë ligjore mirë e konceptuar me qëllim që investitorët e huaj të jenë të sigurtë në

mjedisin investues. Në këtë drejtim edhe qeveria e Kosovës ka ndryshuar dhe plotësuar legjislacionin mbi IHD - të konform rregullativave ligjore të BE-së me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme për investitorët e huaj dhe ato vendor. Së fundmi, me qëllim të plotësimit të boshllëqeve të ligjeve paraprake është ndryshuar edhe ligji Ligji nr.04 / L -220 mbi investimet, ligji aktual që rregullon Investimet e Huaja Direkte në Kosovë është Ligji Nr. 05/L - 079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës i cili rregullon me nene përkatëse procedurat për vlerësimin, përzgjedhjen dhe realizimin e projekteve strategjike; Poashtu rregullon përgjegjësitë e komisionit ndërministror për Investime Strategjike; të agjencisë për investime dhe për përkrahjen e ndërmarrjeve konkretisht, marrëveshjen për zbatimin e projektit strategjik, përdorimin e pasurisë së paluajtshme të Kosovës gjatë implementimit të projekteve strategjike, listën e projekteve të përgatitura nga autoritetet publike, transferimin e të drejtës për të përdorur ndërmarrjen në pronësi publike, pronën ndaj subjektit investues dhe dispozitave të tjera të rëndësishme ligjore.

Ligje të tjera të rëndësishme që ndërlidhen me rregullimin dhe mbështetjen e Investime të Huaja Direkte në Kosovë janë: LIGJI Nr. 06/L -016 për shoqëritë tregtare; Ligji Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike Ligjin nr. 02/L-75 - Ligjin për Arbitrazhin; Ligji për Standardizim (Rregullorja Nr. 2004/12); Ligji Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/l-139 për procedurën përmbartimore; Ligji nr. 05/l-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Të gjitha ligjet e lartëcekura burojnë nga strategjia qeveritare me qëllim të plotësimit të boshllëqeve që kanë ekzistuar në ligje. Me qëllim që kuadri ligjor në Kosovë mbi Investimet e Huaja Direkte të jetë i plotë në kuptim të harmonizimit me praktikën ndërkombëtare është imponuar nevoja dhe domosdoshmëria e ligjeve plotësuese për të rregulluar mbarëvajtjen e IHD-ve. Për sa i përket procedurave në lidhje me zbatimin e kontratave meret për bazë ligji për procedurën kontestimore si edhe ligji për ekzekutim.

Vlen të theksojmë se sistemi legal i Kosovës është rikonstruktuar që të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së. Edhe në kuadër të Bashkimit Evropian, me 21 mars 2019, u miratua Rregullorja (BE) 2019/452 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 mars 2019, për krijimin e një kornize për shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte në Union ("Rregullorja e FDI") që u botua në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Rregullorja e IHD-ve hyn në

fuqi më 10 prill 2019 dhe zbatohet për transaksionet nga 11 tetori i vitit 2020.

Të gjitha ligjet dhe rregulloret në Kosovë janë në dispozicion në internet në gjuhën angleze duke bërë sistemin legjislativ të Kosovës ndër më transparentët në rajon. Prandaj, duke u bazuar në garancitë legjislative dhe më qëllim të promovimit për mbrojtjen e investimeve, Kosova ka hartuar dhe ka nënshkruar dhjetë marrëveshje bilaterale, me SHBA-në (OPIC), Austrinë, Turqinë, Shqipërinë, Malin e Zi, Kuvajtin dhe Katarin, Belgjikën dhe Luksemburgun, Maqedoninë dhe Kroacinë.

2 Klima e investimeve në Kosovë: Bazuar në elementet kryesore të klimës së investimeve duke përfshirë stabilitetin makroekonomik, mjedisin biznesor dhe infrastrukturën, vlen të theksojmë se Kosova ka hapëruar pozitivisht në këto drejtime. Kosova shfrytëzon euron nga viti 2002, dhe me këtë ka ulur dukshëm kostot e transaksionit duke bërë më të favorshme investimet nga shtetet e Bashkimit Evropian, ka disiplinë fiskale, norma të ulëta tatimore konkretisht normën në fitim të korporatave prej 10% që është një masë stimuluese për bizneset, ka liberalizuar tregtinë, ka hartuar një politikë të mirë investuese megjithëse ka hapësirë për plotësime në drejtim të rritjes së atraksionit për IHD-të në drejtim të të drejtave pronësore dhe procesit të privatizimit.

Për sa u përket faktorëve të mjedisit biznesor, Kosova ka hartuar dhe modifikuar një mori ligjesh mbi IHD-të, të drejtën e pronës, sundimin e ligjit, ku është rritur edhe tranparenca, dhe janë zvogëluar pengesat administrative, megjithatë marrja e lejes për biznes duhet të kalojë nëpër disa insitucione, gjë që akoma qëndron si pengesë drejt tërheqjes së IHD-ve. Kështu cilësohet edhe nga raporti i Odës Ekonomike në Kosovë. Konkretisht sipas publikimit nga dilemë tjetër që parashtrohet nga Oda Ekonomike e Kosovës është edhe ajo se investitorët duhet të ballafaqohen me një numër të madh të insitucioneve, dhe ndonjëherë procedurat e tejzgjatura burokratike (siç është marrja e lejeve dhe licencave) bëhen të papërballueshme.

Për sa i përket infrastrukturës përfshirë atë fizike, teknologjike dhe sociale, Kosova duhet të investojë në përmirësim të furnizimit me energji elektrike, ujësjellsin, transportin, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, shëndetësi dhe arsim.

Sipas hulumtimeve të shumta të natyrës teorike dhe empirike, në këtë studim, mes të tjerave konkludojmë se sektorët më me rëndësi për investim në Kosovë dhe që mbeten atraktiv nga

investitorët e huaj numërojnë: Sektorin e teknologjisë së informimit dhe telekomunikimit; sektori i industrisë, ai i xehetarisë dhe përpunimit të drurit, tekstilit, produkteve ushqimore etj. Me këtë, Kosova do të rrisë eksportin dhe do të ulë nevojën për import, që njëherit do ketë efekte pozitive në ritjen ekonomike të vendit. Që të arrihen investimet në sektorët e lartpërmendur, të cilësuar si potencialq dhe fitmiprurës, është më se i nevojshëm stabiliteti politik në vend, zbatimi i ligjit dhe funksionimi i mirëfilltë i gjyqësorit. Destabilitetin politik ndër vite, dhe sundimin e ligjit, e cilësojmë si faktorë kryesor të cilët kanë ndikuar në uljen e IHD-ve në vitet e fundit në rastin e Kosovës. Përskaj tendencave për integrim të Kosovës në BE, krijimin e një numri të madh organizatash për mbështetjen e IHD-ve dhe antarësimin në qendra të ndryshme dhe insitucione ndërkombëtare, për investitorët e huaj është më se i rëndësishëm stabiliteti politik. Në raportin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ndër të tjera theksohet se investitorët e huaj nuk janë më vetëm të interesuar në aspektet teknike të marrjes së lejes së ndërtimit apo operimit në ndonjë shtet. Ajo që në baraspeshë ndikon tek investitorët e huaj është faktori politik në shtet apo rëndësia e stabilitetit politik, funksionimi i mirëfilltë i gjyqësorit dhe dhomave ekonomike, popullata e shkolluar për të ju përshtatur nevojave të tregut. (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 2018, p. 30).

Pra, vlen të theksojmë se pavaësisht normës pozitive të rritjes ekonomike dhe potencialit që ka Kosova për tërheqjen e IHD-ve, ky potencial është i kufizuar si pasojë e destabilitetit politik, funksionimit jo të mirëfilltë të gjyqësorit, korrupsionit; një furnizim jo i mirë i energjisë; informaliteti; vështirësi në krijimin e të drejtave pronësore, dhe sundimin e paqartë të ligjit, dhe një skepticizëm në zbatimin e kontratës. Faktorë tjerë shumë të rëndësishëm që Kosova si shtet duhet t'i marrë në konsideratë për të përmirësuar rritjen e IHD-ve në vitet në vijim, janë mbështetja financiare ndërkombëtare dhe remitancat, zbatimi i ligjit, popullata e shkolluar dhe e aftë, e përgatitur kundrejt nevojave të tregut të punës.

Klima e biznesit në Republikën e Kosovës është në fazën e përpjekjeve për tu bërë një ndër vendet konkurruese në rajon. Përparësitë e krijuara, janë në rrugëtim të një sistemi të shkëlqyeshëm të taksave, burimet e bollshme natyrore, regjistrimi i shpejtë dhe i lehtë i bizneseve, ligjet transparente mbi investimet e huaja si dhe benificionet e tjera, po e bëjnë Kosovën, një mjedis mjaft atraktiv për thithjen e investimeve të huaja. Investitorët (Kompanitë), të cilët janë në kërkim të një vendi me klimë të përshtatshme për të investuar, me shpenzime të vogla e me qasje të lehtë në BE, në Evropën Qendrore dhe në tregjet e

Ballkanit,

Disa nga përfitimet e listuara për të investuar në Kosovë, sipas Ministrisë së Integritimit Evropian janë : (Ministria e Integritimit Evropian në Kosovë, 2020)

- Taksa të ulëta, resurse të pasura dhe ambient përkrahës të biznesit;
- Taksat në Kosovë janë shumë të ulëta krahasuar me shtete fqinje.
- Sistemi tatimor është mbajtur jashtëzakonisht i thjeshtë.
- Popullata – e re dhe e motivuar, 70% nën moshën 35vjeçare;
- Një fuqi të re dhe të motivuar punëtore me shpirt dhe aftësi të forta ndërmarrëse dhe gjithashtu njohuri të përgjithshme të shumicës së gjuhëve evropiane;
- Resurset e lakmueshme natyrore: linjiti, zinku, plumbi, ferro-nikeli dhe toka pjellore bujqësore;
- Qasje të lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe tregjet fqinje;
- Institucione moderne në përkrahjen e bizneseve;
- Procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë për regjistrimin e bizneseve (brenda 3ditëve);
- Sistem të sigurtë bankar;
- Strukturë moderne ligjore dhe në pajtim me BE-në dhe;
- Monedha zyrtare në Kosovë është Euro, që eliminon rrezikun e Euro-zonave.

2. Investimet e Huaja direkte në Kosovë dhe Rajon në krahasim me PBB-në për kokë banori:

3. Trendi i IHD-ve në Kosovë shënon trend luhatës konkretisht një trend pozitiv dhe rritës deri në vitin 2007, për të pasuar me ulje të vazhdueshme deri në vitin 2018. Në Kosovë IHD-të në vitin 2004 kanë qenë 1.50 dhe shënojnë një trend rritës të shpejtë ku në vitin 2007 arrin në 12.97, që njëherit paraqet nivelin më të lartë të IHD-ve, në rastin e Kosovës. Nga viti 2007 deri në vitin 2018, IHD-të shënojnë trend në ulje, në vitin 2018 arrijnë në 4,01. Marrë për bazë vitin 2018, në analizën e IHD-ve, mbi vendet e Ballkanit Perëndimor, në rrugën drejt tërheqjes së IHD-vë vërrejmë se Mali i Zi është vendi me IHD – të më të larta pasuar me Serbinë, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe në fund Bosnjën dhe Hercegovinën. Nga kjo rradhitje konstatojmë se Kosova në kuadër të

vendeve të Ballkanit Perëndimor është vendi i parafundit për sa i përket normës së IHD-ve si përqindje e PBB-së.

Për sa i përket produktit të brendshëm bruto, për kokë banori, në rastin e Kosovës kemi një ulje drastike, nga viti 2001, ku norma ka qenë 26.88 (si rezultat i luftës), në vitin 2002 ulet në (0.76), në vitin 2003 trendi është rritës dhe pozitiv ku norma e PBB-së, arrin në vlerën 5.90. Një rritje e theksuar shënohet edhe në vitin 2005, ku norma e PBB-së për kokë banori në Kosovë arrin 5.96, pastaj në vitin 2006 ulet në 3.66, derisa në vitin 2007, norma arrin në 6.42 dhe në vitet në vijim trendi është luhatës, në përgjithësi ulës, ku në vitin 2018 arrin në normën 2.99. Në përgjithësi, Kosova edhe pse shtet i ri shënon një rritje pozitive në mesatare prej 4 përqind ndër vite. Kjo rritje ekonomike i adresohet fluksit të remitencave dhe konsumit privat.

4. Trendi i Remitencave në Kosovë: Remitencat në Kosovë në vitin 2004 bazuar në indikatorët e Bankës Botërore kanë qenë 17.49. Në vitet vijuese norma e remitencave rritet, konkretisht në vitin 2006 arrin në normën 20.5. Nga viti 2006 remitencat në Kosovë shënojnë një trend në ulje graduale, konkretisht në vitin 2018 arrin në 15.57. Analizuar remitencat në rastin e Kosovës, krahasuar me vendet e tjera të ballkanit perëndimor vërejmë se Kosova është vendi me normën më të lartë të remitencave në rajon. Këtu vinë në shprehje kultura, lidhja me familjen, atdhedashësia dhe faktorë të shumtë të cilët ndikojnë që diaspora mos t'a harojë Kosovën dhe familjarët e tyre. Poashtu vlen të theksohet se remitencat në Kosovë janë një burim shumë i rëndësishëm i rritjes ekonomike në përgjithësi dhe ndikojnë në rritjen e konsumit për familjet dhe përmirësimin e standardit jetësor dhe mirëqenies sociale.

Konkluzione

Hulumtime të shumta dhe analiza teorike e empirike iu kushtohen faktorëve influencues të IHD-ve, përfshirë këtu analizën e kornizës ligjore mbi investimet e huaja, funksionimin e gjyqësorit, zbatimin e ligjit, politikën fiskale në përgjithësi përfshirë atë të tatimeve dhe taksave në veçanti, politikën monetare, zhvillimin e sektorit financiar përfshirë këtu tregjet financiare, pra janë faktorë influencues mbi tërheqjen e IHD-ve. Vlen të theksohet se shtetet në zhvillim e sipër me tranzicion të tejzgjatur dhe me ngecje në zbatim të reformave hasin në vështirësi në tërheqjen e IHD-ve, megjithëse shpresë e vetme për vendet e Ballkanit

Perëndimor, në veçanti rasti i Kosovës, për tërheqjen e IHD-ve, mbetet fuqia punëtore që paraqet një shtyllë kryesore për hir të moshës së re dhe niveli i pagave mesatare në sektorin privat që janë shumë të ulëta krahasuar me ato të BE-së. Sidoqoftë, rritja e mungesës së punës dhe plakja e parashikuar e fuqisë punëtore / popullsisë, mund të ndikojnë në vendimet e investitorëve për investime të reja karakteristike për vendet e BE-së. Sidoqoftë, kjo potencialisht mund të tregojë rënie të interesit për investim të ri.

Përderisa më shumë vende luftojnë për prodhimin e efikasitetit të IHD-ve dhe rritjen e pagave në këto vende, sukcesi i vazhdueshëm në modelin e rritjes të drejtuar nga IHD-të, në këtë grup do të varet nga aftësia e tyre për të ngritur lart shkallët e teknologjisë. Sidoqoftë këtu mund të theksojmë se edhe përkundër faktit të një tranzicioni të tejzgjatur dhe një periudhë e gjatë e pritjes për t'iu bashkuar familjes së madhe evropiane, shtetet e ballkanit perëndimor, veçanërisht Kosova, ka fuqi punëtore të moshës së re, që është në favor kundrejt vendeve të tjera. Vlen të theksojmë se, Kosova është shtet i ri, me një ekonomi të brishtë, të dalë nga lufta. Menjëherë pas luftës dhe hyrjes së forcave të KFOR-it, në të njëjtën kohë, Kosova hyri drejtpërdrejtë në fazë të tranzicionit. Një nga faktorët esencial për një proces të suksesshëm të ristrukturimit ekonomik të Kosovës, si një vend i Ballkanit Perëndimor është padyshim forcimi i gjyqësorit, zbatimi i ligjit, reformat ekonomike dhe qëndrueshmëria politike me të vetmin qëllim të hapjes së ekonomisë drejt investitorëve të huaj. Vështirësitë me të cilat është ballafaquar Kosova në fushën ekonomike, politike dhe zbatimin e ligjit janë të mëdha. Vetëm me një politikë të mirëfilltë ekonomike, shoqëruar me rregullativat juridike të hartuara, konform rregullativave të BE-së dhe zbatimin e ligjit, shtetet me ekonomi në zhvillim mund të pretendojnë tërheqjen e investimeve të huaja në sektorë produktiv që do të orientojnë vendin drejt një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Marrë në përgjithësi, Investimet e Huaja Direkte në Kosovë, shënojnë trend të qëndrueshëm dhe pozitiv krahasuar me vendet e tjera të ballkanit perëndimor dhe disa shteteve anëtare të BE-së. Kosova ka miratuar ligje të reja duke shfuqizuar ose plotësuar ligjet e mëparshme për shkaqe të adaptimit me kornizat dhe rregullativat ligjore të Bashkimit Evropian. Kosova është një shtet që ka një normë të lartë të të diplomuarve universitarë dhe konkretisht moshës së re që paraqet një forcë punëtore të shkathhtë dhe të aftë, që në një dimension është përparësi e Kosovës, kundrejt shteteve të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të Bashkimit Evropian të cilat ballafaqohen nga dita në ditë me normë të lartë të popullatës së moshuar dhe

mungesë të forcës punëtore.

Legjislacioni kosovar nuk kërkon që IHD –të, të kontrollohen, rishikohen, ose aprovohen, dhe ligjet kombëtare nuk bëjnë diskriminim ndaj investitorëve të huaj. Sidoqoftë, investitorët e huaj dekurajohen, ndër të tjera nga: nivelet e larta të korrupsionit, procedurat e ngadalta gjyqësore, mungesa e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, konkurrenca nga shitësit e palicencuar dhe parregullsitë në procedurat e prokurimit publik.

Sidoqoftë, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë të qëndrueshëm që akoma inkurajojnë IHD-të në Kosovë përfshirë këtu: qëndrimin pro-afarist të qeverisë kosovare, vendndodhjen strategjike të vendit, burimet e pasura natyrore, fuqinë punëtore të arsimuar, një shkallë e sheshtë 10% e taksave të korporatave dhe përjashtimet e përkohshme të pagesave të taksës së shtuar (TVSH) për eksportuesit e rinj.

Rekomandime

Një sfidë e re për Kosovën është monedha e shtetit të Kosovës që nuk do të ishte siç mund të pohojë ndonjëri, shmangie nga BE-ja, dhe ikje nga integrimi. Monedha kosovare, do të kishte një mision të vetëm: të reduktojë hendekun e madh midis saj dhe shteteve evropiane në zhvillimin dhe specializimin e ndërmarrjeve të vogla, të cilat përfshijnë numrin më të madh të të punësuarve e të cilat janë bartës kryesore të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Rreziqet e euros për shtetet më të varfra tashmë janë evidente, siç është mungesa e politikës monetare dhe një ikje e përkohshme nuk do t'i bënte dëm Kosovës. Tek e fundit, Kosova nuk është anëtare e eurozonës, por përdorë euron në mënyrë vullnetare. Kosova do t'i ribashkohej eurozonës atëherë kur do të mund të bëhej anëtare fuqiptotë e saj.

Ligji për investime strategjike e sjellë Kosovën në një pozitë më garuese me vendet e rajonit që kanë politika të veçanta për tërheqjen e investitorëve potencialë. Me lehtësirat e krijuara, investitorët kanë më shumë arsye për ta konsideruar Kosovën si vend potencial për investim. Megjithatë, edhe me këtë ligj, Kosova nuk ofron lirime në taksë për punëtorë, e as heqje të tatimit të doganës për lëndën e parë, siç bëjnë Serbia dhe Maqedonia. Prandaj, edhe me një ligj të tillë, suksesi në tërheqjen e investimeve nuk është i garantuar.

Gjendja në Kosovë nuk është ideale për zbatimin e këtij ligji. Hapësira dhe kompetencat që ju ofrohen institucioneve të caktuara janë shqetësuese. Ligji duhet të ofrojë balanc në mes të

nevojës për shkurtrim të procedurave dhe respektim të procedurave tenderuese të cilat minimizojnë shanset për korrupsion. Ligji po ashtu duhet të shërbejë si mbrojtje për asetet dhe resurset e Kosovës edhe në rast se investitorët largohen.

Përveç lehtësirave në procedura dhe stimujve financiarë, Kosova ka ambient më pak të përshtatshëm të të bërit biznes, krahasuar me të gjitha vendet e rajonit. Për të pasur sukses në nxitjen e investimeve, ligje të tilla duhet të mbështeten edhe me reforma substanciale sa i përket ambientit të të bërit biznes dhe edukimit cilësor të fuqisë punëtore.

Kjo ngase përveç lehtësive teknike, shkurtrimit të procedurave burokratike dhe incentivave financiare, investitorët kanë kërkesa edhe për siguri politike, ligjore, fuqi punëtore të aftë dhe në përgjithësi ambient të përshtatshëm të biznes-bërjes. Këto reforma është më e vështirë të arrihen, ngase kërkohen reforma më të thella, kohë, vullnet politik dhe burime financiare.

Rekomandime e tjera sa i përket aspektit të tërheqjes së IHD-ve në Kosovë janë:

- Krijimi i zonave të lira ekonomike për sektorë të ndryshëm,
- subvencionimi i pagave të punëtorëve,
- pushime nga tatimi në fitim,
- ulje të tatimit në të hyra,
- subvencionim të kontributeve për punëtorë,
- lirim të lëndës së parë nga tatimi në import,
- lirime nga tarifat lokale për ndërtim apo leje të ndryshme,
- grante për mbulim të pjesshëm të kostos së ndërtimit të objekteve nga investitori.

Financimi (subvencionimi) dhe mbështetja e trajnimeve të punëtorëve për ta garantuar transferimin e dijes prej investitorit tek punëtorët, krijimi i institucioneve të veçanta neutrale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me investimet, për të krijuar siguri të investitorëve, rritja e bashkëpunimit me odat ndërkombëtare të bizneseve në Kosovë, për projekte investuese si dhe rritja e numrit të odave të huaja ekonomike këtu.

Sistemi modern fiskal dhe i tatimeve janë duke u ndërtuar! Megjithatë, vërejtjet kryesore të ndërmarrjeve janë drejtuar kundër tarifave dhe TVSH-së për mallrat prodhuese, që janë bërë pengesë për shpejtimin e investimeve. Evazioni fiskal është pengesë për politikën moderne të

tatimeve dhe konkurrencën lojale. Një pjesë e konsiderueshme e ligjeve komerciale të aprovuara dhe rregullorja mbi Investimet e Huaja, i plotësojnë standardet e ekonomisë së tregut.

Mirëpo, pakoja e ligjeve komerciale dhe ligjeve të tjera ende nuk është kompletuar dhe për pasojë nuk janë implementuar. Prandaj, mungesa e efekteve sinergjike ende nuk është duke i vërejtur sa duhet përparësitë e sistemit ligjor të Kosovës. Në promovimin e IHD-ve akterët përfshirë: Qeveria, Oda ekonomike e Kosovës, USAID-KBS, Euro Info Qendra, Swisscontact dhe zyrat përfaqësuese të shteteve të huaja është e nevojshme të risin nivelin e bashkëpunimit dhe angazhimin drejt rritjes së një promovimi më të denjë të Investimeve të Huaja Direkte në rastin e Kosovës. Por, aktualisht mungon koordinimi ndërmjet akterëve të ndryshëm, mungon organizimi për koordinim dhe strategjia e promovimit.

Është e nevojshme të adresohet kjo situatë në të ardhmen e afërt, krahas promovimit të përparësive që i ka Kosova dhe krijimin e një imazhi të mirë për të. Mund të konkludojmë se investimet e jashtme direkte përbëjnë një aks me rëndësi në rrugën e hapërimit të vendit. Kalimi nga një sistem në tjetrin dhe ballafaqimi me mangësi të shumta në njërën anë, si dhe imperativi për rendet moderne zhvillimore, nevojën e të qenit më kompetitiv, në anën tjetër, përbën një domosdo të thithjes së investimeve të jashtme direkte të mirëfillta, në periudhën në të cilën gjendet vendi.

Zhvillimi më i madh dhe i qëndrueshëm, si dhe konvergjenca me nivelet regjionale të të ardhurave janë të mundshme vetëm me rritjen e angazhimit të sektorit privat. Një ambient afarist më i përshtatshëm për zhvillim të udhëhequr nga sektori privat, kërkon një varg të gjerë reformash. Kosova tashmë ka disa përparësi në konkurrencë, siç është regjimi i thjeshtë tatimor me norma të ulëta të tatimit dhe me legjislacion fleksibil të punës. Gjithashtu, resurset e linjtit në vend mund të eliminojnë mungesën e sotme të energjisë elektrike dhe tu japin një shtytje të hyrave fiskale dhe mundësisht edhe eksportit në planin afatmesëm dhe afatgjatë. Megjithatë, firmat vendore dhe investorët e huaj përballen me disa pengesa serioze që e kufizojnë aktivitetin e tyre ekonomik dhe potencialin për zhvillim.

Disa çështje edhe pse janë shumë të rëndësishme për promovimin e zhvillimit të sektorit privat, për shembull, sektori financiar në Kosovë është vlerësuar mjaft dobët nga firmat, në veçanti sa i përket kostos së financave.

Edhe pse normat e interesit nuk mund të zvogëlohen duke nxjerrë një ligj, autoritetet mund të promovojnë thellimin e sektorit financiar përmes, për shembull, modernizimit të regjistrimit të pengut dhe zhvillimit të sistemit të informatave kreditore. Rritja e formalitetit, përmirësimi i zbatimit të kontratave dhe forcimi i të drejtave pronësore do të jepnin gjithashtu më shumë besim për bankat që të japin kredi për sektorin privat.

Kosova është e pajisur mirë me burime natyrore dhe toka bujqësore. Sektori i bujqësisë, ushqimit, përpunimit të drurit, ndërtimit, tekstilit, IT, komponentava automobilistike, energji, miniera, ofrojnë mundësi të mëdha për investitorët e huaj. Marrë parasysh ambientin e qëndrueshëm makroekonomik dhe mundësitë e shkëlqyera të cekura më lartë, Kosova gjithnjë e më shumë do të duhej të ishte një vend tërheqës i të bërit biznes.

Mirëpo janë një varg faktorësh se pse Kosova radhitet ndër vendet me shkallën më të ulët në rajon për thithjen e investimeve të jashtme direkte. Ndër ta përmendet shkalla e lartë e korrupsionit prevalent, proceset e stërzgjatura të privatizimit, imazh jo i mirë në botë, problemet me energji, etj. Parakusht për rritje ekonomike dhe tërheqje të investimeve të jashtme direkte, është qeverisja efektive me prioritet në sferat e stabilitetit politik, sundimit të rendit dhe ligjit, politika të reformuara ekonomike etj (Nelson, 2000)

Paraqitja e parë e Kosovës në raportin, si të bësh biznes, një provë në hije është bërë në vitin 2009, që mundëson të matet progresi (Carabaugh, 2002), fatkeqësisht rangimi i Kosovës është përkeqësuar në të gjitha indekset, përveç në mbylljen e biznesit ku ka mbetur pa ndryshuar.

Duke qenë kështu propozohen këto rekomandime kryesore të politikave:

- ❖ Përforcimi i gjyqësorit ligjit, sidomos luftën kundër korrupsionit dhe krimit.
- ❖ Zbatimi i masave për zvogëlim të kohës dhe kostove për inicimin e biznesit
- ❖ Rritja e efektivitetit të procedurave dhe forcimi i kapacitetit administrativ

Pasiguria me të cilën ballafaqohen investitorët dhe ekonomia e Kosovës mbeten ende në nivel shumë të lartë.

Rreziqet më të mëdha të rritjes ekonomike burojnë prej varësisë së Kosovës në sektorët e jashtëm dhe publikë, klima e dobët e investimeve që pengon zhvillimin e bazës aktuale të prodhimit vendor, që ende është i kufizuar, dhe fondet e ulëta të kapitalit njerëzor. Për shkak

të politikave monetare të dobëta dhe të normës së këmbimit që ndodhen aktualisht, politika fiskale mbetet instrumenti i vetëm i politikave në dispozicion për të zbutur ciklin ekonomik, ku shkallët tatimore janë më të ulëtat në rajon.

Në këtë kontekst, dhe në pamundësi për të dhënë borxhe ndërkombëtare, Kosova duhet të mbajë një politikë fiskale të besueshme dhe të matur. Të hyrat e mbivlerësuara buxhetore 2015, bashkë me paraqitjen e një pakoje të bollshme për pagat publike dhe transferet aktuale, dhe zotimi i vazhdueshëm për projekte të infrastrukturës, paraqesin rreziqe fiskale afatshkurtra. Pjesëmarrësit kërkuar zhvillimin dhe implementimin e masave të konsolidimit për të sjellë deficitin buxhetor në 2% të pragut të bruto-produktit vendor, që është detyruar nga rregulli fiskal i Kosovës, i cili nuk duhet të konsiderohet si një synim operacional, mirëpo si një tavan maksimal.

Këtu vlen të përmendet se Kosova ballafaqohet me një numër barrierash strukturore në konkurrencë dhe rritje afatgjatë. Kosova duhet të krijojë kushte që të fuqizojë konkurrencën duke përmirësuar produktivitetin e saj dhe duke tërhequr Investimet e Huaja Direkte të drejtuara më shumë në sektorët e prodhimit të mallrave të tregtueshme. Investimi më i madh duhej të orientohet në sektorët që zëvendësojnë importin dhe kjo do ta ndihmonte Kosovën që të zvogëlonte deficitin e saj tregtar. Kjo duhet të përfshijë fillimisht produktet bujqësore dhe energjinë. Investimet në kapitalin fizik dhe njerëzor janë të rëndësishme për arritjen e kësaj, ashtu siç janë përpjekjet për të fuqizuar kapacitetet për eksport si dhe integrimin e bizneseve kosovare në zinxhirin e furnizimit global, i cili është veçanërisht i vështirë për Kosovën për shkak të rrethanave të saj politike, dhe në tregun e vetëm të BE-së.

Politikat e tregut të punës duhet të plotësohen me shpenzime më të larta dhe të planifikuara për arsim, duke u fokusuar si në përmirësimin e cilësisë ashtu edhe në zvogëlimin e boshllëkut të kuadrove dhe mospërputhjes në mes të ofertës dhe kërkesës për punë.

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e bizneseve dhe tërheqjen e investimeve të huaja direkte, në fokus të këtij hulumtimi kanë qenë edhe masat që duhen marrë në favor të mbështetjes, krijimit dhe zhvillimit të një politike adekuate që do të mundësonte tërheqjen e sa më shumë investitorëve. Rrjedhimisht, është tentuar që të analizohet opinioni i përfaqësuesve të institucioneve për promovimin e Investimeve të huaja dhe për masat të cilat do të ndikonin pozitivisht për përmirësimin e ambientit afarist dhe të

bërjes së biznesit. Rezultatet nga hulumtimi, na bëjnë me dije se ulja e taksave dhe thjeshtimi i sistemit fiskal, është prioriteti kryesor i Qeverisë së Kosovës, por që duhet të përcillet me një politikë më adekuate sa i përket tërheqjes së investitorëve të huaj.

Investimet e planifikuara në sektorin e transportit dhe të energjisë kanë potencial për të çuar në rritje më të fuqishme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Në këtë kontekst, prioritizimi i rritjes së lidhjes së energjisë rajonale dhe sigurisë së energjisë konsiderohet një hap i duhur. Megjithatë, mungesa e një indikacioni të definuar mirë të implikimeve buxhetore lidhur me shumicën e masave që ndërlihen me transportin është një risk i madh për disiplinën fiskale.

Rekomandimi im është, që këto biznese të stimulohen nga ana e qeverisë duke aplikuar reforma rrënjësore. Pra, duke aplikuar politika fiskale favorizuese për bizneset, duke krijuar një klimë stabile dhe konkurrencë lojale, duke rregulluar politikat monetare ashtu që biznesi të ketë mundësi që të merr kredi me normë më të ultë interesi dhe me periudhë afatgjatë të kthimit e të mos ngarkohet me norma më të larta të kamatave sesa që është fitimi real i tyre.

Qeveria gjithashtu, duhet të hartojë politika monetare dhe fiskale që do t'i kontribuojnë zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, pasi që këto ndërmarrje kanë numrin më të madh të të punësuarve dhe janë gjeneratori kryesor i vendeve të reja të punës dhe i zhvillimit ekonomik të Kosovës në tërësi. Ndërmarrësit, janë ata të cilët kanë rrezikuar kapitalin dhe ekzistencën e familjeve të tyre vetëm e vetëm që ata me kapacitetin e tyre të kontribuojnë dhe të japin atributet e tyre në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Së këndejmi, duke njohur progresin, është evidente se ka hapësirë për përmirësim të mëtutjeshëm të konkurrencës dhe mjedisit afarist.

Numri i tepërt i alternativave të propozuara nuk jep një pasqyrë të qartë të prioritetëve reale dhe rekomandimet janë që ky numër duhet të zvogëlohet, dhe me një analizë të ndikimit potencial në konkurrencë, më shumë detaje të jepen në kuptimin e burimeve financuese. Rëndësia e përmirësimit të mëtejshëm në sundimin e dobët të ligjit, zvogëlimin e çështjeve ende të pazgjidhura në gjykatat civile, përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave, derisa në mënyrë efektive të luftohet korrupsioni dhe të vazhdohet me zvogëlimin e ekonomisë joformale.

Bibliografia

- Grupi i Bankës Botërore. (2013). *Inventari i incentivave (nxitësve) të investimeve që ofrohen në Kosovë, Projekti i Klimës së Investimeve NT Kosovë*. Grupi i Bankës Botërore.
- Instituti Demokracia për Zhvillim . (2017). *Investimet e huaja direkte dhe eksportet: Kosova dhe Ballkani Perndimor*. Prishtinë: Instituti Demokracia për Zhvillim.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2015). *Ligji për Investime Strategjike në Republikën e Shqipërisë*,. Tiranë: Kuvendi i Shqipërisë.
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik. (2018). *Raporti i indikatorëve makroekonomik të*. Prishtinë: Departamenti i Integritit European, Koordinimit të Politikave dhe Zhvillimit Ekonomik.
- Administrata Tatimore e Kosovës. (2020). Gjetur në <http://www.atk-ks.org/portfolio/informata-te-pergjithshme-per-tatimet-ne-kosove/>
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. (2020). Gjetur në <https://www.allaboutalbania.eu/agjencia-shqiptare-e-zhvillimit-t.-investimeve.aida./3/36/88.xhtml>
- AKP. (2012). Gjetur në <https://www.rks-gov.net/AL/f149/investimet-ne-kosove/privatizimi>
- Albanian Council on Foreign Relations. (2014). *bashkëpunimin rajonal si forcë shtytëse për rritje ekonomike dhe stabilitet*. Gjetur në <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/11323.pdf>
- Alfar, L. (2003). Foreign Direct Investment and Growth: Does the Sector Matter. *Harvard Business School*.
- Andersen, M. R., Kett, B., & Uexkull, E. (2017). *Corporate Tax Incentives and FDI in Developing Countries*. World Bank, Global Investment Competitiveness Report 2017/2018 Foreign Investor Perspectives and Policy Implications,.
- Armand, K. (2012). *Drejta Biznesore*. Prishtinës: Universiteti I Prishtinës.
- ATK, Ligji nr. 05/L -028 mbi Tatimin në të Ardhura Personale. (2015). *PËR TATIMIN NË TË*

- ARDHURAT PERSONALE. Prishtinë: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).
- ATK, Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. (2015). *LIGJI Nr. 05/L -037*. Kosovë: ATK.
- Bajrami, A. (2011). *Sistemi kushtetues i Kosovës*,.
- Bajrami, A. (2012). *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*. Prishtinë.
- Baker, J. C. (1999). *Foreign Direct Investment in Less Developed Countries*, . Westport, Connecticut, London: The Role of ICSID and MIGA, Quorum Books.
- Banka Qendrore e Kosovës. (2007). *Raporti vjetor BQK*. Prishtinë: BQK.
- Bateman, M. (1997). *Business Cultures in Central & Eastern Europe*. Butterworth-Heinemann.
- Berisha, S. (2002). *Ekonomia ndërkombëtare*. Universiteti i Prishtinës.
- Bhus, I. , & Rahman, J. (2018). *Foreign Direct Investment in New Member States of the EU and Western Balkans: Taking Stock and Assessing Prospects*. IMF Working Papers. Gjetur në <https://www.imf.org/en/Publications/WP/Issues/2018/08/21/Foreign-Direct-Investment-in-New-Member-State-of-the-EU-and-Western-Balkans-Taking-Stock-and-46152>
- Blaine, H. G. (2009). *Foreign Direct Investment*. Nova Science Publishers, 2009 - 200 pagina's. Gjetur në https://books.google.be/books?id=imwnAQAAIAAJ&q=Foreign+Direct+Investment&dq=Foreign+Direct+Investment&redir_esc=y
- Blomstrom, M., & Kokko, A. (2003). Human Capital and Inward FD. *working paper 167*.
- BQK. (2005). *Projektimet e strukturës indikative investuese për periudhën 2005-2015* . Gjetur në <https://www.bqk-kos.org/>
- Buthe, T., & Milner, H. V. (2008). The politics of Foreign Direct Investment into Developing Countries: Increasing FDI through International Trade Agreements?., *American Journal of Political Science, Midwest Political Science Association*, 52(4).
- Calderoni, F. (2014). *Organized Crime Legislation in the European Union*. Milano.
- Carabaugh, R. J. (2002). *International Economics*,.
- Çollaku, P. (2018). *Kosovo's problem with foreign direct investment*. The Viena Institute for International Economic Studies. Gjetur në <https://wiiw.ac.at/kosovo-s-problem-with-foreign-direct-investment-n-339.html>
- Cushman, D. O. (1985). "Real Exchange Rate Risk, Expectations and the Level of Direct Investment. *Review of Economics and Statistics*, 67 (2), 297-308.
- Damijan, J. P., & Knell, M. (2005). How Important Is Trade and Foreign Ownership in Closing the Technology Gap? Evidence from Estonia and Slovenia, . *Review of World Economics/ Weltwirtschaftliches Archiv, Springer*, 141(2).
- Dedaj, B., & Carabregu, M. (2012). Challenges on setting-up the research and development tools and capacities in a transitional country (Kosovo). *CRIS Konferenca e XI, "e-Infrastructures for Research and Innovation Linking Information Systems to Improve Scientific Knowledge*

Production. Prague.

- Denisia, V. (2010). Foreign Direct Investment Theories: An Overview of the Main FDI Theories. *European Journal of Interdisciplinary Studies*, 55. Gjetur në : <http://ssrn.com/abstract=1804514>
- Dimelis, S., & Louri, H. (2004). Foreign Direct Investment and technology Spillovers: Which Firms Really Benefit? *140*(2).
- Domniku, S. (2012). Investimet e Jashtme Direkte (IJD) dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të Kosovës. *Revista për kërkime shkencore dhe akademike EMPIRIKUS*.
- Drabek, Z., & Payne, W. (2002). The Impact of Empirical investigation of the impact of Transparency on Foreign Direct Investment. *Journal of Economic Integration*, 777-810.
- Duning, J., & Narula, R. (1996). Foreign Direct Investment and Governments. doi:ISBN 0-203-98153-7
- Dunning, J. H. (1988). The Eclectic Paradigm of International Production: A restatement and some possible extension. *Journal of International Business Studies*.
- Easterly, W. (2002). The Elusive Quest for Growth-Economists' Adventures and Misadventures in the Tropic.
- Estrin, S., & Uvalic, M. (2016). *Foreign direct investment in the Western Balkans: what role has it played during transition? Comparative Economic Studies*. doi:DOI: 10.1057/ces.2016.10 ISSN 0888-7233
- EUR-Lex. (2004). *Council Regulation (EC) No 139/2004*. Access to European Union LAE. Gjetur në <http://data.europa.eu/eli/reg/2004/139/oj>
- Farrell, R. (2008). *Japanese Investment in the World Economy*. Edward Elgar Publishing, Book number 1943.
- Fedderke, J., & Romm, A. (2006). Growth impact and determinants of foreign direct investment into South Africa 1956-2003. *23*(5), 738-760.
- Fondi Kosovare për Garanci Kreditore. (a.d.). Gjetur në <https://fondikgk.org/en/kosovo-credit-guarantee-fund>
- Gashi, B. Z., Ajeti, S., & Beqiri, G. (2019). *Investimet e Huaja Direkte në Kosovë - Klima e Investimeve, potenciaili dhe barrierat*. Prishtinë: Institui për Ekonomi të Tregut të Lirë.
- Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian. (2019). *Regulation (EU) 2019/452 of the European Parliament and of the Council of 19 March 2019 establishing a framework for the screening of foreign direct investments into the Union*. THE EUROPEAN PARLIAMENT AND THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION. EUR-Lex. Gjetur në <http://data.europa.eu/eli/reg/2019/452/oj>
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9 / 24. (2018). *LIGJI Nr. 06/L -016 PËR SHOQËRITË TREGTARE*. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës.
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 15. (2017). *Ligji Nr. 05/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE*. Prishtinë:

Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 . (2016). *Ligji nr. 05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore* . Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 . (2018). *LIGJI Nr. 06/L-019 PËR STANDARDIZIM*. Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2014). *LIGJI NR. 04/L-220 PËR INVESTIMET E HUAJA*. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2015). *Ligji mbi tatimin në të ardhurat e Korporatave, LIGJI Nr. 05/L -029*. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2017). *Ligji Nr. 05?L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës*. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13319>

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 6 / 12. (2013). *LIGJI Nr. 04/L-159 PËR ZONAT EKONOMIKE*. Prishtinë: Kuvendi i Republikës së Kosovës. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>

Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr. 37 . (2008). *LIGJI NR. 02/L-75 Ligji për Arbitrazhin. PRISHTINË::* KUVendi i Republikës së Kosovës. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2579>

Haaland, J. I., & Wooton, I. (1999). International Competition for Multinational Investment. *The Scandinavian Journal of Economics*, 101(4).

Harms, P., & Ursprung, H. (2002). Do civil and political repression really boost foreign direct investments? *Econ Papers*, 40(4), 651–663. Gjetur në <https://econpapers.repec.org/article/oupecinqu/>

Hejazi, W., & Pauly, P. (2003). Motivation for FDI and domestic capital formation. *Journal of International Business Studies*.

Helpman, E. (2006). FDI and the Organization of the Firms. *Journal of economic Literature*, 44(3).

Hetemi, M. (2005). *Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut*. Prishtinë.

Hetemi, M. (2005). *Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut*. Prishtinë: Universiteti I Prishtinës.

ICSID. (2006). *ICSID Convention, Regulations and Rules*. ICSID.

ICSID. (2020). *Republic of Kosovo Membership*. Gjetur në <https://icsid.worldbank.org/en/Pages/ICSIDSearch.aspx?k=kosovo#k=kosovo>

ICSID Annual Report. (2019). *Excellence in Investment Dispute Resolution*. Gjetur në <https://icsid.worldbank.org>

Indeksi i Lirisë Ekonomike. (2016). Gjetur në <http://herit.ag/1Npbdiw>

Jones Day White Paper. (2019). *Screening of Foreign Direct Investments in the EU Under the New*

FDI Regulation. One Frim Worldwide. Gjetur në <https://www.jonesday.com/en/insights/2019/04/screening-of-foreign-direct-investments>

Këshili i Shqipërisë për Investimet. (2018). *KUADRI LIGJOR PËR INVESTIMET, DEBATET DHE SFIDAT*.

Komisioni Evropian - Raporti mbi Kosovën. (2019). *COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Kosovo* 2019 Report Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the 2019 Communication on EU Enlargement Policy*. Gjetur në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

Komisioni Evropian. (2017). *RREGULLORJA E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT për krijimin e një kuadri për shfaqjen e investimeve të huaja direkte në Bashkimin Evropian*. Brussel: Komisioni Evropian.

Komisioni Evropian. (2019). *Investimet e HUaja Direkte në Bashkimin Evropian Në vijim të Komunikimit të Komisionit Mirëseardhja e investimeve të huaja direkte ndërsa mbron interesat thelbësore"ë 13 shtatorit 2017*. Brussel: Komisioni Evropian. Gjetur në <https://trade.ec.europa.eu/doclib/html/157724.htm>

Krasniqi, A. (2012). *E Drejta Biznesore*. Prishtinë.

Krugman, P. R. (2010). *Ekonomia ndërkombëtare, Teoria dhe politika ekonomike*. Prishtinë: Princeton University & Maurice Obstfeld University of California, Berkeley ,Kolegji universitar "Victory.

Krugman, P., & Obstfeld, M. (2010). *Ekonomia Ndërkombëtare, Teoria dhe Politika Ekonomike*. Prishtinë: Kolegji Victory & Instituti i Hulumtimeve Shkencore Victory.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. (2012). *Kapitulli IX i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Marrëdhëniet Ekonomike, Neni 119*. Prishtinë: Gazeta zyrtre e Republikës së Kosovës. Gjetur në https://wikisource.org/wiki/Kushtetuta_e_Kosov%C3%ABs/Kapitulli_IX

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012). *LIGJ PËR FONDET PENSIONALE TË KOSOVËS*. Kosovë: ATK. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/default.aspx>

Larrain, F., Calava, L. F., & Clare, A. R. (2000). A case Study of Foreign Direct Investment in Central America. *Working Paper No. 58*.

Lars de Bruin. (2020). <https://www.business-to-you.com/about/>. Gjetur në <https://www.business-to-you.com/about/>

Levitt, M., & Botts, B. (2020). Foreign Direct Investment Regimes 2020. doi:ISBN978-1-83918-010-1

Ligji 04/L-220 . (2014). *Ligji mbi Investimet e Huaja Direkte*. Prishtine: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

Ligji Nr 02/L-33. (2006). *Ligji për Investimet e Huaja*. Prishtinë: Kuvendi i Kosovës.

Ligji nr.05/L-079. (a.d.). Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Gjetur në https://mzheks.net/repository/docs/LAW_NO._05_L-079___ON_STRATEGIC_INVESTMENTS_IN_THE_REPUBLIC_OF_KOSOVO.pdf

- Mehdi, H. J. (2005). *Disa tema aktuale te tregut*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
- Meier, G. M., & Rauch, J. E. (2000). *Leading Issues in Economic Development*. Oxford University Press,.
- Mello, L. d. (1999). Foreign Direct Investment-Led Growth: Evidence from Time Series and Panel Data. *Oxford Economic Papers*.
doi:https://www.researchgate.net/deref/http%3A%2F%2Fdx.doi.org%2F10.1093%2Foeq%2F51.1.133?_sg%5B0%5D=H75vmRyXWPSOaLKH43BQuinwpr3-90sCmIeBOdu4uxkWAf7la9ATIQdeQCZRY2dmFwUF77IsgieEPJ1YT6JvyTNKsg.1YxGlsRM23TpqdWU9JcRa3GVIG7uXZSiEsxuy5zzfbwVVfhmV5TxGC09N9yhijKMaRk
- Meyer, K. E. (2005). Foreign Direct Investment in Emerging Economies', Policy Discussion Paper, Templeton College Oxford, *Policy Discussion Paper*, 1-33.
- MIGA-Fias. (2005). *Competing for FDI, Inside the operations of four national investment promotion agencies*. World Bank Group. Gjetur në <http://documents.worldbank.org/curated/en/422491468760233671/Competing-for-FDI-inside-the-operations-of-four-national-investment-promotion-agencies>
- Ministria e Integritimit Evropian në Kosovë. (2020). Kosovë: Ministria e Integritimit Evropian . Gjetur në <https://www.mei-ks.net/sq/kosova/investimet-ne-kosove>
- Ministria e Integritimit Evropian në Kosovë. (2020). *Përafrimi i legjislacionit vendor me Acquis-në*. Gjetur 2020, nga <http://mei-ks.net/sq/korniza-ligjore-pr-prafrim>
- Mirkusic, Z. (2008). *Medjunarodne financije*. Zagreb.
- Mitic, B., & Ivić, M. (2016). The Impact of Foreign Direct Investment on Export Performance: Case of European Transition Economies. *Independent Journal of Management & Production*, 7(3), 771-785.
- Mottaleba, K., & Kalirajan, K. (2010). *Determinants of Foreign Direct Investment in Developing Countries: A Comparative Analysis*. ASARC Working Paper.
- Mustafa, I. (2008). *Menaxhmenti financiar*. Prishtinë: Instituti Riinvest Prishtinë.
- Mustafa, M. (a.d.). *Menaxhimi i investimeve*. Prishtinë: Rinvest.
- Nelson, R. R. (2000). *The Sources of Economic Growth*. Harvard University Press Paperback edition.
- Nunnenkamp, P. (2004). To what extent can foreign direct investment help achieve international development goals? *The World Economy*, 657-677. .
- OECD. (2008). *Benchmark Definition of Foreign Direct Investment*. OECD. Gjetur në <https://www.oecd.org/daf/inv/investmentstatisticsandanalysis/40193734.pdf>
- Olofsdotter, K. (1998). Foreign Direct Investment, Country Capabilities and Economic Growth. *Weltwirtschaftliches Archiv*, Springer.
- OSCE. (2006). *Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë pozitive për biznesin dhe investimet*. OSCE.

- OSCE. (2006). *Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë pozitive për biznesin dhe investimet*. OSCE.
- OSCE. (2018). *Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë pozitive për biznesin dhe investimet*.
- OSCE. (2006). *Udhëzuesi i praktikave më të mira për një klimë pozitive për biznesin dhe investimet*. Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE); www.osce.org.
- Paul, R. K. (2010). *Ekonomia ndërkombëtare, Teoria dhe politika ekonomike*. Prishtinë: Princeton University & Maurice Obstfeld University of California, Berkeley Kolegji universitar "Victory.
- Polovina, S., & Mediq, G. S. (2002). *Bazat e ekonomisë*. Zagreb.
- Pula, E., Loxha, A., & Elshani, D. (2017). *How 'friendly' is Kosovo for Foreign Direct Investments: A Policy Review of Gaps from a Regional Market Perspective*. Prishtina: Prishtina Institute for Political Studies and Group for Legal and Political Studies.
- Qeveria e Republikës së Kosovës. (2018). *Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së StabilizimAsociimit (PKZMSA) 2018 – 2022*. Prishtinë: Republika e Kosovës.
- Rashid, M. B. (2017). *Maximizing Potencial Benefits of FDI for Competitiveness and Sustainable Development*. World Bank Group Report on Investment Policy and Promotion Diagnostics and Tools.
- RI-Invest. (2002). *Investimet e jashtme direkte në Kosovë", Politika Ekonomike, Rrethina dhe Strategjia e Promovimit*. Prishtinë: Instituti Riinvest.
- RIINVEST. (2005). *Qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës (Sfidat, politikat dhe mundësitë)*. Instituti për hulumtime zhvillimore, Riinvest,.
- RIINVEST. (2005). *Qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës (Sfidat, politikat dhe mundësitë), I Pr*. Prishtinë: nstituti për hulumtime zhvillimore, Riinvest,.
- Riza, S. (2007). *E drejta biznesore*. Prishtinë: Universiteti mbretëror Iliria.
- Saggi, K. (2002). Trade, Foreign Direct Investment, and International Technology Transfer: a Survey. *17(2)*.
- Santander Trade Markets. (2020). KOSOVO: FOREIGN INVESTMENT. Gjetur July 15, 2020, nga <https://santandertrade.com/en/portal/establish-overseas/kosovo/investing-3>
- Selimi, N., Sadiku, L., & Reçi, K. (2016). The Impact of Foreign Direct Investment on the Export Performance: Empirical Evidence for Western Balkan Countries. *ILIRIA International Review*, 6(1), 57-66.
- Smaka, R. (2007). *E drejta biznesore*. Prishtinë.
- Smaka, R. (2007). *E drejta biznesore*. Prishtinë: Universiteti mbretëror Iliria.
- STA LAW Firm. (2019). *European Union: FDI And The EU Regulation 2019/425*. STA LAW Firm. Gjetur në https://www.mondaq.com/Home/Redirect/1481028?mode=author&article_id=864728

Stiftung, K. A. (2019). *Foreign Direct Investment in Kosovo - The Investment Climate, Potential and Barriers*. Kosovo: Institute for Free Market Economy. Gjetur në <https://www.kas.de/documents/286052/0/19-12-24+Foreign+Direct+Investment+in+Kosovo>

(2016). *Strategjia e zhvillimit të NVM-ve 2012 – 2016, Prishtinë, 2011, fq. 14 – 55.*

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM 2016-2021 (SKZH). (2016). Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

UNDP. (2011). *Raporti vjetor mbi investimet e huaja në Shqipëri.*

UNMIK. (2001). *Rregulloren Nr.2001/3 Mbi investimet e Huaja në Kosovë.* UNMIK.

USAID. (2007). *Foreign Direct Investment Putting it to work in developing countries.* USAID Prepared by NATHAN ASSOCIATES INC. Gjetur në https://www.investmentmap.org/docs/FDI_Putting-it-to-Work-in-Developing-Countries.pdf

Winder, G. M. (2012). Webs of Enterprise 1850-1914: Applying a Broad Definition of FDI. *Annals of the Association of American Geographers, Routledge,.*

SHTOJCA

JANË PAJTUAR SI NË VIJIM:

KAPITULLI I: KUSHTET E PËRGJITHSHME 305

Për qëllime të kësaj marrëveshjeje:

NENI 1

Përkufizimet

“investitori i “një pale kontraktuese” nënkupton:

personin fizik që mban shtetësinë dominuese të palës kontraktuese në përputhje me ligjin në fuqi dhe;

ndërmarrjen që është themeluar apo organizuar sipas ligjit në fuqi të palës kontraktuese, që

investon apo që ka investuar në territorin e palës tjetër kontraktuese.

“investimi nga investitori apo pala kontraktuese” nënkupton çdo lloj aseti në territorin e njërës palë kontraktuese, i cili është në pronësi apo kontrollohet, direkt a indirekt, nga investitori i palës tjetër kontraktuese, investimet konsiderohen se kanë veçori specifike, siç është zotimi i kapitalit apo burimeve të tjera, të priturat e fitimit a profitit, apo supozimi i rrezikut, dhe këto përfshijnë:

ndërmarrjen siç përcaktohet në paragrafin (3);

aksionet, fondet dhe format e tjera të ekuitetit që bëjnë pjesë në ndërmarrjen e cila përmendet në nën paragrafin (a), dhe të drejtat që dalin nga ai paragraf;

obligacionet, dëftesa e borxhit, huamarrjet dhe format e tjera të borxheve dhe të drejtave që dalin nga kjo;

çfarëdo e drejte apo pohimi për para apo performancë që jepet sipas ligjit apo kontratës, duke përfshirë ndërtimin nga fillimi deri në mbarim, menaxhimin apo shpërndarjen e kontratave, koncesioneve, licencave, autorizimeve apo lejeve për të ndërmarr një aktivitet ekonomik;

asetet e patrupëzuara dhe asetet e paprekshme që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë të drejtat origjinale, të drejtën e autorit, markat, paketimin e produktit;

patentat, indikacionet gjeografike, dizajnet industriale dhe proceset teknike, fshehtësitë e kompanisë, aftësitë dhe vullnetin;

çfarëdo prone tjetër e prekshme apo e paprekshme, e luajtshme apo e paluajtshme, apo ndonjë e drejtë tjetër e pronës, siç janë qiradhëniet, hipotekat, garancitë, zotimet apo uzufuktet (e drejta e përdorimit të pronës së huaj).

“ndërmarrje” nënkupton secilin entitet që së paku ka në pronësi person të pjesshëm juridik, i themeluar apo organizuar sipas ligjit në fuqi të Palës Kontraktuese, pa marrë parasyshw a është apo jo profitabil, dhe qoftë në pronësi apo nën kontroll privat apo qeveritar, p.sh. një korporatë, shoqëri, shoqëri aksionare apo ndonjë shoqëri tjetër, si edhe trust, pronësi e veçantë apo ndonjë filial që gjendet në territorin e palës kontraktuese dhe e cila zhvillon biznes të pavarur aty.

“të ardhurat” nënkuptojnë shumat që janë fituar nga investimi dhe në veçanti, fitimet, interesat, fitimet kapitale, dividendët, pagesat, tarifatat për licenca, tarifatat asistencë teknike dhe tarifatat e tjera.

„pa vonesë” nënkupton një periudhë që normalisht kërkohet për të përfunduar formalitetet e nevojshme për shpagimin e kompensimeve apo për transferin e pagesave. Kjo periudhë do të fillojë me shpagimin e kompensimeve në ditën e shpronësimit, kurse për transferin e pagesave në ditën kur është paraqitur kërkesa për transfer. Në asnjë mënyrë nuk do të tejkalohet periudha prej një muaji.

“territor” për sa i përket secilës palë Kontraktuese nënkupton, territorin e tokës, ujërave të brendshme, bregdetin dhe hapësirën ajrore nën sovranitetin e tij, duke përfshirë në mënyrë të veçantë zonën ekonomike dhe pjesën kontinentale të bregut të detit, aty ku Pala Kontraktuese ushtron autoritetin, në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

“masë” nënkupton një veprim rregullues dhe përfshin ligjin, rregulloren, vendimin, procedurën, kërkesën apo praktikën³⁰⁶.

NENI 2307

Promovimi dhe lejimi i investimeve

Secila palë Kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe rregullat, do t’i promovojë dhe lejojë investimet nga investitori i Palës tjetër Kontraktuese.

Çfarëdo ndryshimi në formë, në të cilën asetet edhe janë investuar apo ri-investuar, nuk do të prek karakterin e tyre si investim, me kusht që një ndryshim i tillë është në përputhje me ligjet dhe rregulloret e palës kontraktuese në territorin e së cilës është investuar.

NENI 3308

Trajtimi i investimeve

Secila palë kontraktuese do të japë pëlqimin për trajtim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtje dhe siguri të plotë dhe konstante për investimet nga investitori i palës tjetër kontraktuese.

Pala kontraktuese nuk do të dëmtojë padrejtësisht apo në mënyrë të njëanshme menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen, përdorimin, ushtrimin e së drejtës, shitjen dhe likuidimin e një

investimi nga investitorët e palës tjetër kontraktuese.

Secila palë kontraktuese do t'i jap pëlqimin investitorëve të palës tjetër kontraktuese dhe investimeve të tyre apo të ardhurave, trajtim jo më pak të favorshëm se atë që ia jep investitorëve apo investimeve të veta, apo investitorëve të ndonjë shteti të tretë dhe investimeve të tyre sa i përket menaxhimit, operimit, mirëmbajtjes, përdorimit, ushtrimit të së drejtës, shitjes dhe likuidimit, si edhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes së investimeve të tyre apo të ardhurave, cilido që është më i favorshëm për investitorin.

Asnjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje nuk do të interpretohet në mënyrë që të:

parandalojë palën kontraktuese për të ndërmarrë ndonjë veprim gjatë kryerjes së obligimeve të saj sipas Statutit të Kombeve të Bashkuara për mbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, dhe;

parandaloj Palën Kontraktuese nga përmbushja e obligimeve të saj si anëtare e marrëveshjes së integritetit ekonomik, siç është zona e tregtisë së lirë, unioni i doganave, tregu i përbashkët, komuniteti ekonomik, unioni monetar, p.sh. Bashkimi Evropian, apo të obligojë palën kontraktuese t'u zgjasë investitorëve të palës tjetër kontraktuese dhe investimeve të tyre apo të ardhurave fitimin e tashëm apo të ardhshëm për çfarëdo trajtimi, preferencë apo privilegj duke u mbështetur në anëtarësinë e saj në asnjë lloj marrëveshjeje apo në çfarëdo marrëveshjeje multilaterale në investim, apo;

obligojë palën kontraktuese që t'u zgjasë investitorëve të palës tjetër kontraktuese dhe investimeve të tyre apo të ardhurave fitimin e tashëm apo të ardhshëm për ndonjë trajtim, preferencë apo privilegj që rezulton nga obligimet e palës kontraktuese sipas marrëveshjes ndërkombëtare, rregullimit ndërkombëtar apo legjislacionit vendor në lidhje me tatimin.

NENI 4309

Investimi dhe Mjedisi

Pala kontraktuese pranon që është i papranueshëm inkurajimi i një investimi duke i dobësuar ligjet vendore mbi mjedisin.

NENI 5310

Investimi dhe Puna

Palët Kontraktuese pranojnë që është i papranueshëm inkurajimi i një investimi duke i dobësuar ligjet vendore mbi punën.

Për qëllime të këtij neni, “ligjet e punës” nënkuptojnë statutet apo rregulloret e secilës palë kontraktuese, që direkt kanë lidhje me të drejtat e punës të pranuar ndërkombëtarisht: të drejtën për shoqëri; të drejtën për të organizuar dhe për të bërë tregti në mënyrë kolektive; ndalesën mbi përdorimin e ndonjë forme të punë së shtrënguar apo të detyruar; mbrojtjet nga puna për fëmijë dhe të rinj, duke përfshirë moshën minimale për punësimin e fëmijëve dhe ndalimin apo eliminimin e formave më të shëmtuara të punës së fëmijëve; kushtet e pranueshme për punë në lidhje me moshën minimale, orët e punës dhe siguria e shëndeti në profesion; eliminimi i diskriminimit në punësim dhe profesion.

NENI 6311

Transparenca

Secila palë kontraktuese do të publikojë menjëherë, apo në ndonjë mënyrë do t’i vë në dispozicion, ligjet, rregulloret, procedurat dhe marrëveshjet e saj të cilat mund të dëmtojnë operimin e kësaj marrëveshjeje.

Secila palë kontraktuese menjëherë do t’i përgjigjet pyetjeve specifike dhe do t’i ofrojë, me kërkesë informata, palës tjetër kontraktuese për ndonjë masë apo çështje që është përmendur në paragrafin (1).

Nga asnjë palë kontraktuese nuk do të kërkohet që të jap apo t’i lejojë qasje në informata sa i përket investitorëve apo investimeve të veçanta, shpalosja e të cilave do të pengonte zbatimin e ligjit apo do të ishte në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret e saj të cilat mbrojnë konfidencialitetin.

NENI 7

Shpronësimi dhe Kompensimi

Pala Kontraktuese nuk do të shpronësojë apo nacionalizojë direkt apo indirekt një investim të

një investitori të palës tjetër kontraktuese, apo nuk do të ndërmerr ndonjë masë që ka efekt të njëjtë (këtu e më tutje referuar si shpronësim) përveç:

për qëllime që është në interes publik,

në baza jo-diskriminuese,

në përputhje me procesin e duhur ligjor,

nëse shoqërohet me pagesë mbi kompensimin e menjëhershëm, adekuat dhe efektive në përputhje me paragrafët (2) dhe (3), më poshtë.

Kompensimi do të:

paguhet pa vonesë. Në rast të ndonjë vonese, çdo humbje e normës së shkëmbimit që rezulton nga kjo vonesë do të paguhet nga shteti nikoqir.

jetë ekuivalente me vlerën e saktë të tregut të një investimi të shpronësuar para se të ketë ndodhur shpronësimi. Vlera e saktë e tregut nuk do të pasqyrojë kurrfarë ndryshimi të ndodhur në vlerë, sepse shpronësimi është bërë i ditur në mënyrë publike më herët, paguhet dhe do t'i transferohet lirshëm shtetit të përcaktuar nga pretenduesit në fjalë dhe në valutën e shtetit, shtetas të së cilit janë pretenduesit apo në ndonjë valutë që këmbëhet lehtë e që pranohet nga pretenduesit.

përfshijnë interesin në normën komerciale që është e vendosur në bazë të tregut për valutën e pagesës nga dita e shpronësimit e deri në datën kur bëhet pagesa.

Investitori i palës kontraktuese që pohon se është prekur nga shpronësimi i palës tjetër kontraktuese do të ketë të drejtën e rishikimit të menjëhershëm të rastit të tij, duke përfshirë vlerësimin e investimit të tij dhe shpagimin e kompensimit në përputhje me dispozitat e këtij neni, nga autoriteti gjyqësor apo nga ndonjë autoritet tjetër kompetent dhe i pavarur i palës së fundit kontraktuese.

Përveç në raste të rralla, atëherë kur një masë apo një sërë masash janë aq të rrepta për shkak të qëllimit të tyre e që nuk mund të rishikohen në mënyrë të arsyeshme pasi që janë adoptuar dhe aplikuar në mirëbesim, masat jo diskriminuese të një pale kontraktuese që janë të dizajnuara dhe zbatuara për të mbrojtur objektivat legjitime të mirëqenies publike, siç është shëndeti, siguria dhe mjedisi, nuk përbëjnë shpronësim indirekt.

NENI 8312

Kompensimi i humbjeve

Investitorit të një pale kontraktuese i cili ka pësuar humbje në lidhje me investimin e tij në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për shkak të luftës apo të ndonjë konflikti tjetër të armatosur, gjendjes së jashtëzakonshme, revolucionit, rebelimit, trazirave civile, apo ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme, apo veprimet e zotit apo forcës madhore, në territorin e palës së fundit kontraktuese, do t'i akordohet nga pala e fundit kontraktuese, në lidhje me dëmshpërblimin, zhdëmtimin, kompensimin apo ndonjë zgjidhje tjetër, një tretman jo më pak i favorshëm se ai tretman që kjo ia akordon investitorëve të vet apo investitorëve të një shteti të tretë, cilido që është më i favorshmi për investitorin.

Investitori i palës kontraktuese i cili në ndonjë ngjarje të cilat u referuan në paragrafin (1) pëson humbje e që rezulton nga:

rekuizimi i investimit të saj apo i një pjese nga kjo, nga autoritetet e forcave që veprojnë në territorin e palës kontraktuese, apo;

shkatërrimi i investimit apo i një pjesë të saj nga forcat apo autoritetet e palës tjetër kontraktuese, gjë që nuk është dashur duke marrë parasysh situatën, në secilin rast nga pala e fundit kontraktuese do të akordohet dëmshpërblim apo kompensim e që në secilin rast do të jetë i shpejt, adekuat dhe efektiv, dhe sa i përket kompensimit, do të jetë në përputhje me nenin 7, paragrafin (2) dhe (3).

NENI 9

Transferet

Secila palë kontraktuese do të garantojë se të gjitha pagesat në lidhje me investimin nga investitori i palës tjetër kontraktuese në mënyrë të lirshme mund të transferohen brenda dhe jashtë territorit pa vonesa. Në veçanti, transferet e tilla do të përshijnë:

kapitalin fillestar dhe shumat shtesë për të mbajtur dhe rritur një investim;
të ardhurat;

pagesat që janë bërë sipas kontratës duke përfshirë marrëveshjen për huadhënie;

shumat nga shitja apo likuidimi i të gjitha apo i ndonjë pjese të investimit;

pagesat e kompensimit sipas Neneve 7 dhe 8;

pagesat që dalin nga zgjidhja e një mosmarrëveshjeje;

fitimet dhe pagesat e tjera të personelit që është i angazhuar jashtë vendit në lidhje me

investimin.

Secila palë kontraktuese do të garantojë edhe më tej që transferet e tilla mund të bëhen në një valutë që është lehtë e konvertueshme në normën e shkëmbimit në treg, që ekziston në ditën e transferit në territorin e palës kontraktuese nga ku është bërë transferi. Tarifat e bankës do të jenë të drejta dhe të paanshme.

Në mungesë të një tregu për këmbime të huaja, norma e cila do të përdoret do të jetë norma e këmbimit që është përdorur në kohën e fundit për konvertimin e valutave në asetet rezervë të FMN-së.

Pa marrë parasysh paragrafët (1) deri në (3) dhe pa paragjykuar masat që janë adoptuar nga pala kontraktuese duke u mbështetur në obligimet e saj ndërkombëtare, siç është përmendur në Nenin 3 (4), pala kontraktuese mund gjithashtu të parandalojë një transfer përmes zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve të paanshme, jo-diskriminuese dhe në mirëbesim, mbi falimentimin, insolvencën apo mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve, lëshimit, tregtimit dhe trajtimit me letra në vlerë, mallrave, mundësisë së blerjes dhe investimit të prejardhur, mbi raportet dhe regjistrat e transferimit, mbi parandalimin e larjes së parasë apo financimit terrorist, apo në lidhje me shkeljet penale dhe urdhrat apo aktgjykimet në procedurat administrative dhe vendimmarrëse me kusht që ato masa dhe zbatimi i atyre masave nuk do të përdoren si mjet për t'i shmangur zotimet dhe obligimet e palës kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje.

NENI 11314

Obligimet tjera

Secila palë kontraktuese do të respektojë secilin obligim të cilin mund ta ketë nënshkruar për sa i përket investimeve specifike nga investitorit e palës tjetër kontraktuese. Kjo do të thotë, në mes të tjerash, se shkelja e kontratës në mes të investitorit dhe shtetit nikoqir apo një nga entitetet e saj do të çojë në prishjen e marrëveshjes.

Nëse ligjet e secilës palë kontraktuese apo obligimet sipas të drejtës ekzistuese ndërkombëtare apo këtu e tutje e nënshkruar në mes të palëve kontraktuese, përveç kësaj marrëveshjeje përmbajnë rregulla, qofshin ato të përgjithshme apo specifike, që i japin të drejtën investimeve nga vendorët apo ndërmarrjet e palës tjetër kontraktuese për një tretman më të favorshëm se nga ai i cili është dhënë në këtë marrëveshje, rregullat e tilla do të

mbizotërojnë mbi këtë marrëveshje deri në atë masë që të jenë më të favorshme.

NENI 12315

Refuzimi i fitimeve

Pala kontraktuese mund t'i refuzojë investitorit të palës tjetër kontraktuese dhe investimeve të tij, fitimet e kësaj marrëveshjeje, nëse investitorët e palës jo-kontraktuese kanë në zotërim apo kontrollojnë investitorin e parë të përmendur dhe nëse investitori nuk ka aktivitet të pavarur afarist në territorin e palës kontraktuese sipas ligjit të së cilit kjo është themeluar apo organizuar.

Më poshtë do të jetë e paraqitur pjesa ku tregon zgjedhjen e mosmarrëveshjeve

KAPITULLI II:

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJES316

PJESA I:

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJES NË MES INVESTITORIT DHE PALËS KONTRAKTUESE

NENI 13317

Fushëveprimi dhe pozita

Kjo pjesë aplikohet nëpër mosmarrëveshje në mes të palës kontraktuese dhe investitorit të palës kontraktuese sa i përket shkeljes së pohuar të një obligimi të së parës sipas kësaj marrëveshjeje, gjë që investitorit apo investimit të tij i shkakton humbje dhe dëmtim.

NENI 14318

Mjetet e zgjidhjes, periudhat kohore

Një mosmarrëveshje në mes palës kontraktuese dhe investitorit të palës tjetër kontraktuese nëse është e mundshme do të zgjidhet përmes negociatave apo konsultimeve. Nëse kjo nuk zgjidhet kështu, atëherë investitori mund të paraqes këtë për vendim:

nga gjykatat kompetente apo gjykatat administrative të palës kontraktuese, palës në mosmarrëveshje;

në përputhje me ndonjë procedurë në fuqi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që më herët janë

pajtuar për këtë; apo

në përputhje me këtë nen:

(i) Qendra ndërkombëtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimit (“Qendra”), që është themeluar sipas Konventës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimit në mes të Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve tjera, që është nënshkruar në Washington më 18 mars 1965 (“Konventa KNZMI”),

NENI 15319

Pëlqimi i palës kontraktuese

Në këtë mënyrë secila palë kontraktuese e jep pëlqimin e saj të pakusht për t’i parashtruar arbitrimin ndërkombëtar mosmarrëveshjen në përputhje me këtë pjesë. Megjithatë, një mosmarrëveshje mund të mos i parashtrohet arbitrimin ndërkombëtar nëse gjykata në shkallën e parë i ka dhënë vendimin e vet sipas meritës ndonjë pale kontraktuese.

Pëlqimi i cili referohet në paragrafin (1) lë të kuptohet mospranimin e kërkesës që mjetet e brendshme ligjore administrative dhe juridike duhet të shteren.

NENI 16320

Vendi i Arbitrimin

Secili arbitrim, sipas kësaj pjese, me kërkesë të secilës palë në mosmarrëveshje, do të mbahet në shtetin i cili është palë e Konventës mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve arbitrore të huaja që është nënshkruar në New York, më 10 qershor 1958. Kërkesat që parashtrohen për arbitrim sipas kësaj pjese do të merren parasysh se kanë dal nga një marrëdhënie apo transaksion tregtar për qëllime të nenit 1 të Konventës së New York-ut.

NENI 17321

Zhdëmtimi

Pala kontraktuese nuk do të pohojë si justifikim, kundërkërkesë, e drejtë e kërkesës apo për ndonjë arsye tjetër, se zhdëmtimi apo ndonjë kompensim tjetër në tërësi apo në pjesë për dëmtimet e pohuara është pranuar sipas zhdëmtimit, garancisë apo kontratës së sigurimi.

NENI 18322

Ligji në fuqi

Gjykata që është themeluar sipas kësaj pjese do të vendosë për mosmarrëveshjen në përputhje me këtë marrëveshje dhe me rregullat e parimet në fuqi të së drejtës ndërkombëtare.

Çështjet në mosmarrëveshje sipas nenit 11, do të vendosen, në mungesë të marrëveshjes tjetër, në përputhje me ligjin e palës kontraktuese, palës në mosmarrëveshje, ligjit i cili

qeveris autorizimin dhe marrëveshjen dhe rregullat e tilla të së drejtës ndërkombëtare që mund të jenë në fuqi.

NENI 19

Vendimet dhe zbatimi

Vendimet e arbitrit, të cilat përfshijnë një vendim interesi, do të jetë përfundimtare dhe detyruese për palët në mosmarrëveshje dhe mund të ofrojnë format e lehtësimit si në vijim: një deklaratë se pala kontraktuese ka dështuar për t'iu përmbajtur obligimeve të veta sipas kësaj marrëveshjeje;

kompensim në para, që do të përfshijë interesin që nga koha kur humbja apo dëmtimi ka ndodhur e deri në kohën e kryerjes së pagesës;

dëmshpërblim në mallra në raste të përshtatshme, me kusht që pala kontraktuese mund të kryejë kompensim në para në vend të kësaj ku dëmshpërblimi nuk është i zbatueshëm, dhe; në marrëveshje me palët në mosmarrëveshje, çfarëdo forme tjetër të lehtësimit.

Secila palë kontraktuese do të ofrojë për zbatim sa më efektiv të vendimeve të marra sipas këtij neni dhe do të zbatojë pa vonesë çfarëdo vendimi të tillë që është dhënë nga procedura pjesë e së cilës është pala.

PJESA II

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE NË MES TË PALËVE

KONTRAKTUESE

NENI 20

Fushëveprimi, konsultimet, ndërmjetësimi dhe pajtimi

Mosmarrëveshjet në mes të palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje për aq sa është e mundur do të zgjidhen miqësisht apo përmes konsultimeve, ndërmjetësimit apo pajtimit.

NENI 21

Inicimi i procedurave

Me kërkesë të secilës palë kontraktuese, një mosmarrëveshje që ka të bëjë me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje mund t'i parashtrohet një gjykatë arbitrimi për të marrë vendim jo më herët se 60 ditë pasi që një kërkesë e tillë t'i jetë kumtuar palës tjetër

kontraktuese.

Pala kontraktuese mund të mos i inicioj procedurat sipas kësaj pjese, për një mosmarrëveshje në lidhje me shkeljen e të drejtave të një investitori e i cili investitor ka parashtruar për arbitrim sipas pjesës së I-rë, të kapitullit të II-të, të kësaj marrëveshje, përveç nëse pala tjetër kontraktuese ka dështuar t'i përmbahet dhe të respektojë vendimin e dhënë në atë mosmarrëveshje apo ato procedura janë anuluar pa vendim nga një gjykatë arbitrimi me kërkesën e investitorit.

NENI 22326

Themelimi i Gjykatës

Gjykata e arbitrimit do të themelohet ad hoc si në vijim:

Secila palë kontraktuese do të emërojë një anëtar dhe këta dy anëtarë do të merren vesh për një shtetas nga Shteti i tretë si kryesues të tyre. Anëtarët do të emërohen brenda dy muajve nga data kur njëra palë kontraktuese ta ketë informuar palën tjetër për qëllimin e saj për të parashtruar mosmarrëveshjen në gjykatën e arbitrimit, kryesuesi i së cilës do të emërohet brenda dy muajve në vazhdim.

Nëse periudha kohore e specifikuar në paragrafin (1) të këtij neni nuk respektohet, secila palë kontraktuese në mungesë të një aranzhimi relevant mund të ftojë Presidentin e Gjykatës Ndërkombëtare për Drejtësi që të rregullojë aranzhimet e duhura. Nëse presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare për Drejtësi është shtetas i ndonjë pale kontraktuese apo ai/ajo parandalohet në ushtrimin e detyrës së përmendur, Zëvendës Presidenti apo në rast të pamundësisë së tij/saj, anëtari i Gjykatës Ndërkombëtare për drejtësi që është me rang të njëjtë me radhë duhet të ftohet sipas të njëjtave kondita për të rregulluar takimet e nevojshme.

Anëtarët e gjykatës së arbitrimit do të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

NENI 23327

Ligji në fuqi, Rregullat e zëvendësueshme

Gjykata e arbitrimit do të vendosë për mosmarrëveshjet në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me rregullat e parimet në fuqi të së drejtës ndërkombëtare.

Përveç nëse palët në mosmarrëveshje vendosin ndryshe, Gjykata e përhershme e Rregullave Opsionale të Arbitrimit për Arbitrimin e Mosmarrëveshjeve do t'i konsiderojë çështjet që nuk

qeverisen nga dispozitat e tjera të kësaj pjese.

NENI 24

Vendimet

Gjykata në vendimin e saj do t'i paraqes të gjeturat e saj me ligj e me fakte, së bashku me arsye, dhe me kërkesë të Palës Kontraktuese, mund të ofrojë këto forma të lehtësimit: një deklaratë se veprimi i Palës Kontraktuese është në mospërputhje me obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje;

një rekomandim që Pala Kontraktuese t'i ushtrojë veprimet e saj në pajtim me obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

kompensim në para për ndonjë humbje apo dëmtim me kërkesën e investitorit të Palës Kontraktuese apo investimit të saj, apo;

çfarëdo forme të lehtësimit me të cilën pala kontraktuese pajtohet e kundër së cilës është marrë vendimi, duke përfshirë edhe dëmshpërblimin në mallra për investitorin.

Vendimi i arbitrimit do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët në mosmarrëveshje.

NENI 25328

Kostot

Secila palë kontraktuese do t'i paguajë kostot e përfaqësimit të tyre në procedura (seanca). Kostot e gjykatës do të paguhen barabartë nga palët kontraktuese përveç nëse gjykata i udhëzon që ato të paguhen ndryshe.

NENI 26 329

Zbatimi

Vendimet në të holla e të cilat nuk janë respektuar brenda një viti nga data e vendimit, mund të zbatohen në gjykatën e secilës palë kontraktuese që ka autoritet mbi asetet e palës tjetër të dështuar.

KAPITULLI III

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

NENI 27

Fushëveprimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje

Kjo marrëveshje do të vlejë për investimet e bëra në territorin e secilës palë kontraktuese në përputhje me legjislacionin e saj nga investitorët e palës tjetër kontraktuese para dhe pasi që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi.

Kjo marrëveshje nuk do të vlejë për ato kërkesa që nuk janë zgjidhur, apo për ato procedura në përputhje me nenin 14 (1) (c) e të cilat janë iniciuar para se kjo të ketë hyrë në fuqi.

NENI 28330

Konsultimet

Secila palë kontraktuese mund t'i propozojë palës tjetër kontraktuese konsultime për çfarëdo çështje në lidhje me këtë marrëveshje. Këto konsultime do të mbahen në vendin dhe kohën për të cilat do të merren vesh përmes kanaleve diplomatike.

NENI 29331

HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA

Kjo marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit dhe do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë që e pason muajin gjatë të cilit muaj janë shkëmbyer instrumentet e ratifikimit.

Kjo marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë dhjetë vjeçare dhe pas kësaj periudhe kjo do të zgjatet për një periudhë të pacaktuar dhe mund të shpallet e pavlefshme me shkrim përmes kanaleve diplomatike nga cilado palë kontraktuese duke dhënë njoftim prej dymbëdhjetë muajsh.

Sa i përket investimeve të bëra para datës së mbarimit të kësaj marrëveshjeje, nenet 1 deri 29 të kësaj marrëveshjeje do të mbeten në fuqi edhe për një periudhë prej dhjetë vitesh nga data e mbarimit të saj.

MARRËVESHJA u shumëzua në Prishtinë, më 22 janar 2010, në gjuhën gjermane, gjuhën shqipe, gjuhën serbe dhe gjuhën angleze, dhe i tërë teksti është barabartë autentik. Në rast se

ka dallim në interpretim, atëherë do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e Për Qeverinë e

Republikës së Austrisë

Reinhold Lopatka Ahmet Shala

Republikës së Kosovës

BIBLIOGRAFIA PLOTËSUESE

Në vazhdim, prezantohet lista e bibliografisë shtesë krahas referencimit në tekst dhe listës automatike të bibliografisë për të mbështetur konstatimet, qëndrimet dhe mendimet e si vijon:

1. Acocella Nicola, “L’impresa Multinazionale: Prospettive per una Teoria”, LINT, Trieste, It., 1994.
2. Buckley Peter & Casson Mark, “The Economic Theory of Multinational Enterprise”, London, 1985.
3. But Dedaj, Mjellma Carabregu, “Challenges on setting-up the research and development tools and capacities in a transitional country (Kosovo), CRIS Konferenca e XI, “e- Infrastructures for Research and Innovation: Linking Information Systems to Improve Scientific Knowledge Production, Pragë, qershor 2012.
4. Competing for FDI, Inside the operations of four national investment promotion agencies, A MIGA-FIAS research project, Multilateral Investment Guarantee Agency, 2005.
5. Bajrami Arsim - Prof.dr. Sistemi Kushtetutës i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2012. Falco, Ricardo, “Storia Economica, Dalla Rivoluzione alla Globalizzazione”, 2012.
6. Ferraro Guido “I Fondamenti di Teoria Sociosemiotica. La visione neoclassica”, 2012.
7. David S. Landes, The Wealth and Poverty of Nations; why some are soo rich and some so poor, W.W. Norton & Company, New York, 1999.

8. Douglas Woodward, Douglas Nigh, *Foreign Ownership and the Consequences in Direct Investment in the United States: Beyond Us and Them*, Quorum Books, London.
9. Frank McDonald & Stephen Dearden, *European Economic Integration*, Financial Times, Prentice Hall, Third Edition, 1999.
10. Gerald M. Meier, James E. Rauch, *Leading Issues in Economic Development*, Oxford University Press, Seventh Edition, 2000.
11. Hicks, J.R. (1937). Neoclassical synthesis was developed and popularised by Samuelson (1955)
12. Tim Buthe, Helen V. Milner, *The politics of Foreign Direct Investment into Developing Countries: Increasing FDI through International Trade Agreements?*, *American Journal of Political Science*, Midwest Political Science Association, Vol. 52, No. 4., Oct. 2008.
13. Vasilika Kume, “Marrja e Vendimeve Manaxheriale”, Pegi Tiranë, Tiranë 2010.
14. Walid Hejazi and P Pauly, “Motivation for FDI and domestic capital formation”, *Journal of International Business Studies*, 2003.
15. Walid Hejazi and A. Edëard Safarian, *Trade, Foreign Direct Investment, and R&D Spillovers*, Palgrave Macmillan Journals, *Journal of International Business Studies*, Vol. 30, No. 3., 3rd Qtr., 1999.
16. Beqaj.B., *Sy më Sy*, intervistë në RTV21.
17. *Foreign Direct Investment: A Lead Driver for Sustainable Development*, Toëard Earth Summit, 2002.
18. Gorenac, V., *Gospodarsko pravo*, Zagreb, 2001.
19. Hetemi, M., *Disa Tema Aktuale të Ekonomise se Tregut*, Prishtinë, 2005.
20. Horvat.Gj., Tintor.Z., *Ndërmarrësia.*, Kolegji universitar VICTORY & Instituti i hulumtimeve shkencore VICTORY, Prishtinë, 2008.

21. Kristo, I., Biznesi Ndërkombëtar, Tiranë, 2002.
22. Armand Krasniqi, E drejta biznesore, Universiteti i Prishtinës, 2012. Muhamet Mustafa, Menaxhimi i investimeve, Rinvest.
23. Polovina.S.Mediq.Sh., Bazat e ekonomisë, Kolegji universitar “Victory”, Prishtinë, 2006.
24. Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Reforma e Shërbimeve Publike, Raport Hulumtues, Riinvest, 2002
25. Road (the) to Stability and Prosperity in SEE – Regional Strategy Paper, World Bank, 2002.
26. Knight (1921) distinguished between risks, which he said is often meant to refer to quantities that are measurable, and uncertainty, which is not measurable.
27. James C. Baker, Foreign Direct Investment in Less Developed Countries, The Role of ICSID and MIGA, Quorum Books, Westport, Connecticut, London, 1999.
28. Joseph E. Stiglitz, Free Fall, America, Free Markets, and the Sinking of the of the World Economy, E.E. Norton & Company, New York, London, 2010.
29. Joseph Stiglitz, Globalization and its Discontents, Penguin Books, E.E. Norton & Company, New York, 2002.
30. Joseph Stiglitz, Making Globalization Work, Penguin Books, W.W. Norton & Company, New York, 2007.
31. John Duning, Rajneesh Narula, Foreign Direct Investment and Governments, ISBN 0-203- 98153-7.
32. Lee Kuan Yee, From Third World to First, the Singapore Story: 1965-2000, HarperCollins Publishers Inc., New York, 2000.
33. Martin Griffiths, Terry O’Callaghan and Steven C. Roach, The Key Concepts, Second Edition, Routledge, Taylor & Francis Group, London and New York, 2002.

34. Milford Bateman, *Business Cultures in Central & Eastern Europe*, Butterworth-Heinemann, Oxford, 1997.
35. Paul R. Krugman, Maurice Obstfeld, *International Economics, Theory and Policy*, Addison-Wesley, New York, Fifth Edition, 2000.
36. Paul Krugman-Maurice Obstfeld, *Ekonomia Ndërkombëtare, Teoria dhe Politika Ekonomike*, Kolegji Victory & Instituti i Hulumtimeve Shkencore Victory, Prishtinë, 2010.
37. Paul Krugman, *The Conscience of a Liberal*, E.E. Norton & Company, New York, 2007. Paul Krugman, *Pop Internationalism*, Massachusetts Institute of Technology, 1998.
38. The World Bank, *The East Asian Miracle, Economic Growth and Public Policy*, Oxford University Press, 1993.
39. Theodore H. Moran, *Foreign Direct Investment and Development: The New Policy Agenda for Developing Countries and Economies in Transition*, Institute for International Economics, Washington DC, 1998.
40. Timothy J Yeager, *Institutions, Transition, Economies, and Economic Development*, Westview Press, Oxford 1999.
41. Bedri Selmani., *Globalizimi, Tranzicionet dhe Integrimet*, Albanica dhe Zenith, Lubjanë- Prishtinë, 2006.
42. Laura Alfaro, *Foreign Direct Investment and Growth: Does the Sector Matter?*, Harvard Business School, April 2003,
43. Eun Mee Kim, Jai S. Mah. *Patterns of South Korea's Foreign Direct Investment Flows into China*, University of California Press, vol. 46, No. 6, Nov-Dec., 2006.
44. Francesco Calderoni, *Organized Crime Legislation in the European Union*, Milano.
45. Felipe Larrain B., Luis F. Lopez-Calava, and Andreas Rodriguez-Clare, *Intel: A case Study of Foreign Direct Investment in Central America*, Center for International Development at Harvard University, Working Paper No. 58, December 2000.

46. Frank Barry & John Bradley, The Irish Host-Country Experience, The Economic Journal, Blackwell Publishing, Vol. 107, No. 445. Nov., 1997.
47. Garrick Blalock, Daniel H. Simon, Do all firms benefit equally from downstream FDI? The moderating effect of local suppliers' capabilities on productivity gains, Journal of International Business studies (2009) 40, Vol. 40, No. 7, Sep. 2009.
48. Gordon M. Ender, "Eeds of Enterprise 1850-1914: Applying a Broad Definition of FDI", Annals of the Association of American Geographers, Routledge, August 2012.
49. Jan I. Haaland and Ian Eooton, International Competition for Multinational Investment, The Scandinavian Journal of Economics, Vol. 101, No. 4, industrial Policy in Open Economies., Dec., 1999.
50. Joze P. Damijan and Mark Knell, How Important Is Trade and Foreign Ownership in Closing the Technology Gap? Evidence from Estonia and Slovenia, Review of World Economics/ Weltwirtschaftliches Archiv, Springer, Vol. 141, No. 2., Jul. 2005.
51. Kamal Saggi, Trade, Foreign Direct Investment, and International Technology Transfer: a Survey, The World Bank Research Observer, Oxford University Press, Vol. 17, No. 2., Autumn, 2002.
52. Karin Olofsdotter, Foreign Direct Investment, Country Capabilities and Economic Growth, Weltwirtschaftliches Archiv, Springer, Bd. 134, H.3., 1998.
53. Magnus Blomstrom & Ari Kokko, Human Capital and Inward FDI, Working paper 167, January 2003.
54. Magnus Blomstrom, Ari Kokko, Mario Zejan, Host Country Competition, Labour Skills and Technology Transfer by Multinationals, Weltwirtschaftliches Archiv, Springer, Bd. 130, H. 3., 1994.
55. Magnus Blomstrom, Ari Kokko, The Impact of Foreign Investment on Host Countries: A review of the Empirical Evidence, Stockholm School of Economics, December 1996.
56. Magnus Blomstrom, Gunnar Fors, Robert E. Lipsey, Foreign direct Investment and

Employment: Home Country Experience in the United States and Sweden, *The Economic Journal*, Vol. 107, No. 445., Nov.1997.

57. Michael Muller-Camen, Phil Almond, Patric Gunnigle, Javier Quintanilla and Anne Tempel, *Between home and host country: Multinationals and employment relations in Europe*, *Industrial Relations Journal*, Blackwell Publisher Ltd. 2001.

58. Nigel Driffield and James H. Love, *Linking FDI Motivation and Host Economy Productivity Effects: Conceptual and Empirical Analysis*, *Journal of International Business Studies*, Vol.38, No. 3, May 2007.

59. Pitelis, Christos; Roger Sugden (2000). *The nature of the transnational firm*. Caves (1971). Routledge. p. 74.

60. Moosa Imaad A. "FDI, Theory, evidence and practice", Palgrave 2002.

61. 61.

62. Ramkishan S. Rajan, *Measures to Attract FDI: Investment Promotion, Incentives and Policy Intervention*, *Economic and Political Weekly*, Vol. 39, No-1, Jan. 3-9, 2004.

63. Robert E. Lipsey, *Foreign Direct Investment in the United States and the U.S. Trade*, *Annals of the American Academy of Political and Social Science*, Vol. 516, July 1991.

64. Sezer, H. (2006) "Foreign Direct Investment", in Piggott, J. and Cook, M. *International Business Economics: A European Perspective*.

65. Sophia Dimelis and Helen Louri, *Foreign Direct Investment and technology Spillovers: Which Firms Really Benefit?*, *Review of World Economics/Weltwirtschaftliches Archiv*, Vol. 140, No. 2., 2004.

66. Susan E. Feinberg and Sumit K. Majumdar, *Technology Spillovers from Foreign Direct Investment in the Indian Pharmaceutical Industry*, *Palgrave Macmillan Journals, Journal of International Business Studies*, Vol. 32, No. 3.

67. Svetislav Polovina – Gjurio Sh. Mediq / *Bazat e ekonomisë*, Zagreb, 2002.

68. Raporti i Investimeve të Huaja Direkte, të përgatitura nga ekonomistë të institucioneve publike kryesore të ekonomisë, statistikave dhe financave të vendit, si dhe Raportet e Bankës Botërore.
69. Berisha Skender, Prof.dr. Ekonomia ndërkombëtare, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2002.
70. Skender Berisha, Financat ndërkombëtare, Prishtinë, 2000.
71. Zarko Mirkusic, Medjunarodne financije. Informator, Zagreb,2008.
72. Zhvillimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Kosovë, Raport nga Anketuesit, Riinvest, 2002.
73. <http://shqiptarja.com/neës.php?IDNotizia=230562#sthash.ZFIoE3SU.dpuf>.
<http://www.kurumdemir.com.tr/al/kurumdemir.htm>.
74. <http://www.mfa-ks.net/?page=1,119>.
75. <http://documents.tips/documents/02-teorite-e-tregetise-dhe-investimeve.html>.
<http://www.evropaelire.org/content/article/1970563.html>.
<http://www.unmikonline.org/archives/euinkosovo/upload/Nxitja%20e%20Rritjes%20Ekonomike%20to%20Kosoves.pdf>.
76. www.ita.doc.gov/legak/modelbot.html. ëëë.preamble.org/mai/interëeb.html
77. Qëndrueshmëria ekonomike e Kosovës (Sfidat, politikat dhe mundësitë), Instituti për hulumtime zhvillimore, Riinvest, Prishtinë, 2005.
78. Strategjia e zhvillimit të NVM-ve 2012 – 2016, Prishtinë, 2011. Raporti vjetor BQK, Prishtinë, 2007.
79. Raporti i Fondit Monetar Ndërkombëtar, nëntor 2013.
80. Shih Shoqata ndërkombëtare për zhvillim, korporata ndërkombëtare finnaciare dhe Agjencia për garantim të investimeve, strategji e partneritetit me shtetin për Republikën e Kosovës për periudhën VF12–VF15 1 maj 2012.

Materiale të tjera:

81. Dedaj But, "Roli i shkencës dhe i teknologjisë në zhvillimin ekonomik", punim magjistrate, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1998.
82. Diaspora as a Driving Force for Development in Kosovo: Myth or Reality, Forumi për Iniciativë Demokratike, Prishtinë, qershor 2009.
83. Institute for Advance Studies, GAP, Policy Brief, „Kosovo in CEFTA: In or Out?“, March, 2011.
84. Investor Guide Investing in Kosovo, Investment Promotion Agency-IPAK, May 2011.
85. James C. W. Ahiakpor, Multinational Corporations in the Third Eorld: Predators or Allies in Economic Development?
86. Stockholm School of Economics, Stockholm, Sëeden, National Bureau of Economic Research, Cambridge, MA 02138, USA
87. Ligji për dhënien e lejes për punë dhe për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, Nr. 03/L-136, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Prishtinë: Viti IV /Nr. 58/10 gusht 2009.
88. Lexology, Croatia adopts the Strategic Investments Act , qasur më:12.12.2015, <http://bit.ly/1nlB0DL>.
89. Panorama.al, qasur më: 12.12.2015, Burimi: <http://bit.ly/1Nkc83D>.
90. Ligji për investimet e huaja Nr. 02/L-33, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë /Prishtinë: Viti I/nr. 8/ 15 dhjetor 2006.
91. Ligji për tregti me jashtë, Nr. 04/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Prishtinë: Viti IV /Nr. 28/16 dhjetor 2011.

92. Market Entry Guide-United Arab Emirates (UAE), the Government of the Grand Duchy of Luxemburg, Ministry of the Economy and Foreign Trade, dhjetor 2011.
93. MTL me UNMIK-Kosovo (Ligji Nr. 9122, datë 29.07.2003, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 73). Ka hyrë në fuqi në tetor 2003.
94. Raporti Vjetor 2011, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë, qershor 2011. Regional Trade Agreements in a Multilateral Trade Regime: An Overview.
95. Tax Incentives and Foreign Direct Investment, A Global Survey, United Nations, Neë York and Genova, 2000.
96. Eëorld Investment Report 2010, Investing in a Low-Carbon Economy, United Nations, Neë York and Geneva, 2010.
97. Xuepeng Liu, Trade Agreements and Economic Groëth, March 09, 2012.

Tekste ligjore:

Ligji (i Kosovës) Nr.02/L-33 për Investimet e Huaja. Ligji për Tatim mbi Vlerën e Shtuar.

Ligji mbi TVSH-në., Nr.04/L-108, Republika e Kosovës, 03.05.2012. Ligji për Tatim në të Ardhura Individuale.

Ligji për Shoqëritë Tregtare. Ligji për të Huajt.

Ligji për Kodin Doganor dhe Akcizat.

Ligji për Tatim në të Ardhura të Korporatave.

Ligji për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë. Ligji për Aktivitetet e Tregtisë me Jashtë.

Ligji për Markat Tregtare. Ligji për Patentin.

Ligji për Standardizim.

Ligji për investimet e huaja, Nr. 04/L-220.

Rregullorja Nr. 2005/48 Mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve Rregullorja Nr.

2001/27 Mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.

Dokumente:

SHTOJCAT TEKSTUALE

Nevoja për plotësimin e dokumentacionit përgjithësisht dikton përfshirjen e anekseve të duhura në propozime. Pjesë përbërëse e këtyre anekseve mund të jenë udhëzimet e detajuara, pyetësorët e përdorur, leja nga institucioni kompetent për kryerjen e një studimi specifik etj.

1. Dispozita përkatëse ligjore:

Dispozita përkatëse të Ligjit të Kosovës Nr.02/L-33 për Investimet e Huaja;

Dispozita përkatëse të Ligjit për Tatim mbi Vlerën e Shtuar;

Dispozita përkatëse të Ligjit për Tatim në të Ardhura Individuale;

Dispozita përkatëse të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;

Dispozita përkatëse të Ligjit për të Huajt;

Dispozita përkatëse të Ligjit për Kodin Doganor dhe Akcizat;

Dispozita përkatëse të Ligjit për Tatim në të Ardhura të Korporatave;

Dispozita përkatëse të ligjit për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovë;

Dispozita përkatëse të Ligjit për Aktivitetet e Tregtisë me Jashtë;

Dispozita përkatëse të Ligjit për Markat Tregtare;

Dispozita përkatëse të Ligjit për Patentin;

Dispozita përkatëse të Ligjit për Standardizim;

Dispozita përkatëse të Rregullores Nr. 2005/48 Mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve;

Dispozita përkatëse të Rregullores Nr. 2001/27 Mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë;

2. Projekt (Draft)-Kontrata për Investime të Huaj

